




Hëna e Re

Viti XXXV | Nr.366 | Mars 2022 | Rexheb - Shaban 1443 | Çmimi 50 den

Ramazani, mëshurë për ne



Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu:
MESAZH KUNDËR LUFTËS

Rijaseti mbajti Mbledhjen





MESAZH KUNDËR LUFTËS

Lufta është ajo që shkreteton, që merr jetën e të pafajshmëve, që lë plagë të pashlyera te njerëzit, që formon psikologji të dhunës, të urrejtjes, të vrasjes e të mbytjes. Andaj, zhvilloni në zemrat tuaja ndjenjën e respektit, të afrimit ndaj njëri-tjetrit, të shërbimit ndaj njerëzve, të paqes e të solidaritetit në vepër. Kështu do të jemi më fuqishëm afër dashurisë së Zotit të Gjithëdijshëm.

*Reis'ul-Ulema i BFI të RMV,
h. hfz. Shaqir ef. Fetahu*

Вojната е она што уништува, ги одзема животите на невините, остава незалечени рани на луѓето, ја формира психологијата на насилство, омраза и убиство. Затоа, развијте во вашите срца чувство на почит, блискост еден кон друг, служење на луѓето, мир и солидарност на дело. Така ќе бидеме посилно и поблиску до љубовта на Семокниот Алах.

*Reis'ul-Ulema на ИВЗ на РСМ,
х. хфз. Шакир еф. Фетаху*

Savaş; her tarafı yıkıp yok etmekte, masumların canını almakta, insanlarda kapanmayan yaralar bırakmakta, şiddet, nefret ve cinayet psikolojisini meydana getirmektedir.

Bu nedenle kalplerinizde saygı, birbirine yakınlık, insanlara hizmet, barış ve dayanışma duygusu geliştirin. Böylece daha güçlü ve Yüce Allah'ın sevgisine daha yakın olacağız.

*KMC İDB Reis'ul-Uleması,
h. hfz. Şakir ef. Fetahu*

War is what devastates, takes the lives of the innocent, leaves unhealed wounds on people, forms the psychology of violence, hatred, murder and drowning.

Therefore, develop in your hearts a sense of respect, closeness to one another, service to people, peace and solidarity in action. Thus we will be more strongly close to the love of the All-Knowing God.

*Reis'ul-Ulema of IRC of RNM,
h. hfz. Shaqir ef. Fetahu*

(17.03.2022)

AGRESION RUS, ANTINJERËZOR DHE RREZIK PËR PAQEN NË BOTË



Reis'ul-ulemaja dhe Ambasadori i BE dënuan agresionin e Rusisë në Ukrainë: Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 28 shkurt, 2022, i shoqëruar nga Drejtori i Sektorit për Marrëdhënie me Jashtë z. Mustafa Dauti, pati takim zyrtar në selinë e Bashkimit Evropian në Shkup, ku u pritën nga Shkëlqesia e Tij Ambasadori z. David Gir, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në këtë takim, Reis'ul Ulemaja falënderoi Ambasadorin për takimin dhe pritjen e ngrohtë dhe, në të njëjtën kohë, në emër të Bashkësisë Fetare Islame shprehën shqetësimin e madh për agresionin e Rusisë kundër Ukrainës, me shumë viktima në njerëz dhe me shkatërrime të shumta, dhe bashkë dënuan thellë këtë agresion antinjerëzor që po rrezikon paqen jo vetëm në rajon, por edhe në tërë globin.

Po ashtu, kreu i BFI përshëndeti unitetin e BE dhe SHBA në përpjekjet e tyre maksimale për ta ndaluar këtë agresion që po rrezikon jetën njerëzore.

Më pas, të dyja palët u dakorduan që të vazhdojnë kontributin në evitim e pandemisë me covid-19, si dhe realizimin sa më të lartë të vaksinimit të popullatës, që është e vetmja rrugë për imunizimin e shoqërisë dhe asgjësim të kësaj të keqe që po shqetëson botën.

Reis'ul-Ulemaja edhe një herë deklaroi se kultivimi i paqes në vend dhe në rajon është prioritet i institucionit fetar islam BFI, andaj kërkoi nga besimtarët dhe nëpunësit fetarë që të kenë kujdes në deklarata dhe qëndrime që dëmtojnë paqen dhe në të njëjtën kohë u kërkua kontributi i tyre në këtë drejtim, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Të njëjtën ditë, në faqen e vet në Facebook, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu kishte shkruar: "Agresion rus në Ukrainë, antinjerëzor dhe rrezik për paqen në botë. Kultivimi i paqes në vend dhe në rajon është detyrë parësore e institucionit tonë fetar islam, BFI-së, andaj kërkohet kujdes në deklarata dhe të mos ketë qëndrime që dëmtojnë paqen. Të gjithë ne duhet të japim kontributin tonë në këtë drejtim."

RAMAZANI, MËSHIRË PËR NE

Elhamdulillah, sërish po e përjetojmë atmosferën e muajit të nëntë hixhri – të Ramazanit, po i përjetojmë begatitë e shumta të këtij muaji në të cilin u shpall Kurani famëlartë, udhërrëfyesi i vërtetë i njeriut dhe sqaruesi i saktë i veprimeve të dobishme dhe të dëmshme; po i përjetojmë kënaqësinë e ibadetit të quajtur agjërim, përmes të cilit besnikëria dhe sinqeriteti ynë ndaj Krijuesit tonë, Allahut (xh. sh.), vihen në sprovë...

Muaji i bekuar i Ramazanit është muaji më i vlefshëm i vitit në kalendarin islam, sepse atë e karakterizojnë shumë ngjarje madhështore dhe specifike, të cilat nuk mund t'i hasim në muajt tjerë. Pra, ky muaj veçohet me Shpalljen, respektivisht me zbritjen e Kuranit famëlartë, me ardhjen e Muhamedit (a. s.) si pejgamber, me agjërimin në këtë muaj si adhurim dhe ibadet, me ngjarjet historike si: Luftën e Bedrit, Çlirimin e Mekës, më pastaj Natën e Kadrit, Itikafin, institucionin e Sadekatul-Fitrit etj.

Duke marrë parasysh vlerat e mëdha që ka ky muaj, ai për çdo besimtar është dhuratë e çmuar; para se të gjithash, është dhuratë për ata që dinë t'i shfrytëzojnë begatitë e këtij muaj, gjatë të cilit mëshira e Allahut është më afër njeriut dhe krijesave të tjera.

Muaji i Ramazanit, njëherësh, është edhe rast i mirë për të bërë kthesë kah e mira, duke u larguar nga e keqja; kthesë kah paqja, duke i lënë zënkat; kthesë kah humaniteti, duke u ikur egoizmave; kthesë kah dashuria, duke u larguar nga konfliktet dhe urrejtjet. Është rast i mirë për t'u zgjuar nga gjumi dhe "gafleti" të gjithë ata që janë të zhytur në punët e kota dhe në mashtrimet e kësaj jete, e që janë të pakujdesshëm, para se të gjithash, për vetveten, për familjet e tyre dhe për shoqërinë në përgjithësi.

Po ashtu, muaji i Ramazanit është një rast i mirë për të zgatur dorën e pajtimimit, dorën e mirësisë, dorën e njerëzisë dhe të humanitetit, për të bërë të mundur që edhe i brengosuri ta përjetojë lumturinë, që edhe i varfri ta shijojë pasurinë, që edhe i sëmuri të marrë shërimin etj. Pra, ky është një rast ideal për disiplinimin e shpirtit, për intensifikimin e devotshmërisë, për përforcimin e modestisë, të vetëmohimit, të maturisë, bujarisë, çiltërsisë, fisnikërisë dhe humanitetit. Të mos e humbasim këtë rast pa e shfrytëzuar. Andaj, gjatë këtij muaji të bëjmë një vetëkontroll, duke filluar nga vetvetja, nga familjet tona, nga të afërmit tanë e kështu me radhë. Në përpjekjet tona për të ndryshuar gjendjen për një lumturi dhe begati më të madhe për të gjithë njerëzit, me siguri edhe ndihma e Allahut (xh. sh.) nuk do të mungojë.

Bashkësia Fetare Islame e RMV, si organizuese, zhvilluese dhe kultivuese e jetës dhe e vlerave fetare islame, ka hartuar programin ekskluziv për pritjen dhe realizimin e gjithë asaj që e lidh besimtarin mysliman me këtë muaj të bekuar. Pikërisht për këtë, në këtë Program janë paraparë organizimi i shumë aktiviteteve fetare që do të mbahen në tërë territorin e vendit tonë. Kjo, nga shkak se BFI e ka obligim kushtetutar të organizojë, të zhvillojë dhe të bëjë përmirësimin e jetës fetare në tërësi të myslimanëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të bashkatdhetarëve tanë në diasporë. BFI me këtë rast konsideron se është e nevojshme që të gjithë nëpunësit fetarë: imamët, hatibët, myderrizët dhe vaizët, si dhe të punësuarit tjerë në institucionet e BFI-së, të bëjnë punën e tyre sa më mirë, gjithnjë në interes të jetës fetare-islame dhe të besimtarëve.

Na qoftë me bereqet muaji i Ramazanit!

Q. Osmani

Botues:
Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame të RMV

Kryeredaktor:
Nazif Zejnullahu

Redaksia:
Qufli Osmani,
dr. Qenan Ismaili,
prof. dr. Qani Nesimi,
prof. dr. Shaban Sulejmani,
Ibrahim Idrizi,
prof. dr. Musa Musai,
Jusuf Zimeri,
dr. Selver Xhemali,
dr. Abdylqerim Iseni,
Agron Vojnika,
mr. Rejhan Neziri,
Usam Halimi

Redaktimi gjuhësor:
Ali Mashkulli

Redaktor teknik:
Halil Berisha

Telefonat e Redaksisë:
02/31 17 410;
02/ 31 17 412

Adresa:
rr. Çair nr. 52, NMK-1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Numri amë/BFI.RMV: 4069676;
numri tatimor: 4030998340480;
xhirologaria në denarë:
270040696760488, Halkbank Shkup;
xhirologaria devizore:
SWIFT code-EXPCMK22,
Halkbank AD Skopje,
IBAN code-MK0727072200027525;
parapagimi për një vit: 740 denarë për RMV (+ptt), përkatësisht 18 euro për Evropë (+ptt).

Ueb-faqja:
www.bfi.mk
e-mail: henaerebfi20@gmail.com
rijaseti.bfi@gmail.com

Shtyp:
Shtypshkronja AJ-GRAF matbaa, Shkup, rr. Atanas Babata nr. 26;
HËNA E RE, tirazhi: 2.000 copë (27 Mars 2022)

Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen.



RIJASETI MBAJTI MBLEDHJEN



Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame të RMV mbajti më 23 mars, 2022, Mbledhjen e vet të rregullt në përbërje të plotë, të konvokuar dhe të kryesuar nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili, sipas rendit të ditës të miratuar, iu drejtua Rijasetit me informatë rezymuese mbi aktivitetet e organit Reis'ul-Ulema, të realizuara mes dy mbledhjeve, thuhet në informatën e Shërbimit për Informim të BFI.

Rijaseti i BFI-së, gjithnjë sipas rendit të ditës, debatoi dhe shqyrtoi Raportet e punës për vitin 2021, Planprogramet për vitin 2022, Pasqyrat financiare përfundimtare për vitin 2021 dhe Planetin financiar për vitin 2022 të Myftinive të BFI-së.

Me të përfunduar diskutimet rreth kësaj pike, Rijaseti i BFI-së e vlerësoi lart punën dhe kontributin e Myftinive për vitin 2021 dhe unanimisht i miratoi raportet dhe planet e lartpërmendura.

Sipas pikave të rendit të ditës, Rijaseti i BFI-së debatoi dhe shqyrtoi Raportin vjetor të punës për vitin 2021 të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, respektivisht punën e të gjithë organizmave të BFI-së, e cila u vlerësua si mjaft e suksesshme dhe voluminoze. Po ashtu, në vijim, u debatua dhe u shqyrtua Pasqyra financiare për vitin 2021 dhe Plani financiar i Rijasetit për vitin 2022.


Sipas Pasqyrës financiare për vitin 2021, krahasuar me vitin paraprak, 2020, puna financiare e Rijasetit të BFI-së ka një rritje prej 63%, që është fakt i cili tregon punën serioze dhe menaxhimin e suksesshëm me mjetet financiare të BFI-së.

Në fund të diskutimeve, aktet e lartpërmendura unanimisht u miratuan dhe të njëjtat, në përputhje me Kushtetutën e BFI-së, i dërgohen Kuvendit të BFI-së për miratim.

Në vazhdim Rijaseti i BFI-së diskutoi për organizimin e jetës fetare në muajin Ramazan, për Haxhin dhe për kurbanet, numri i të cilave, sipas Raportit për vitin 2021, u tejkalua për tre mijë kurbane nga ai i planifikuar – e tërë kjo si rezultat i një qasjeje më serioze dhe të përgatitjeve të bëra me kohë.

Lidhur me çështjet e lartpërmendura, Rijaseti i BFI-së miratoi këto konkluzione:

1. Informojmë besimtarët dhe opinionin e gjerë se Ramazani sipas takvimit për vitin 2022/1443-1444 H fillon më 2 prill (e shtunë).
2. Duke pasur parasysh krizën si pasojë e pandemisë me Covid-19 dhe luftës aktuale (në Ukrainë), kategoria e Sadekatul-fitrit mbetet e njëjtë, pra kategoria e parë: 150,00 den; kategoria e dytë: 200,00 den; kategoria e tretë 300,00 den dhe kategoria e katërt 400,00 den.
3. Obligohet Shërbimi Fetar-Arsimor që të përgatit Tabelën e Zeqatit.
4. Lidhur me kurbanet të formohet Komisioni që do të merret me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kurbanet për vitin 2022.
5. Rijaseti i BFI-së, lidhur me Haxhin informon besimtarët e vendit se sipas informatave nga autoritetet e Mbretërisë së Arabisë Saudite, sivjet do të organizohet udhëtimi për kryerjen e Haxhit. Informata të tjera rreth Haxhit në mënyrë plotësuese do të jepen pasi të nënshkruhet Mahdari me Ministrinë e Haxhit të MAS. Me këtë rast, edhe një herë ia bëjmë me dije opinionit se i vetmi organizator legjitim dhe kompetent i Haxhit në vendin tonë është Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, thuhet në informatën e Shërbimit për Informim të BFI.



MBLEDHJE E MYFTINISË SË SHKUPIT



Myftinija e Shkupit më 19 mars, 2022, realizoi me sukses mbledhjen e rregullt me nëpunësit e të gjitha rajoneve të Shkupit, si dhe me mytevelinjët e Këshillave të xhamive përkatëse, për t'i njoftuar rreth aktiviteteve që janë realizuar deri më tani dhe, në veçanti, rreth organizimit të Ramazanit që vjen (2022/1443), thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Në këtë mbledhje morën pjesë: Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, anëtarët e Myftinisë së Shkupit, hatibët, imamët, mualimët e mualimet, si dhe mytevelinjët që veprojnë nëpër të gjitha xhamitë tona.

Mbledhja filloi me ashere, të lexuar nga hfz. Xhemal ef. Nuhiju, përgjegjës i Institutit të Hifzit "Ismail Efendi". Mr. Nexhmi ef. Ferati, sekretar i Myftinisë së Shkupit, bëri hapjen dhe moderimin e kësaj mbledhje dhe paraqiti pikat e saj. Myftiu i Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, paraqiti para të pranishmëve Raportin e përgjithshëm të vitit 2021, duke dhënë një papyrë mbi aktivitetet që janë realizuar, për sfidat në vitin që përcollëm, si dhe për arritjet dhe sukseset e përbashkëta. Pastaj, paraqiti me radhë aktivitetet e planifikuara për muajin e bekuar të Ramazanit, mbi vendimet

Vendimet për Ramazan

1. Dita e parë e agjërimit për vitin 2022 është më 2.04.2022 (e shtunë).
2. Çdo vaiz bën listën e temave mujore të Ramazanit dhe kohën e ligjërimit dhe të njëjtën e vendos në tabelën (derën) e xhamisë.
3. Ezani i sabahut thirret 30 minuta pas imsakut.
4. Namazi i teravisë falet me 20 reqatë në kohën e vet (me namazin e jacisë).
5. Namazi i teravisë me hatme falet në xhaminë "Murat Pasha" në Çarshinë e Shkupit.
6. Të lexohet Kuran (mukabele) në xhami para kohës së namazeve.
7. Të bëhet kërkesë me shkrim në zyrat e Myftinisë për çdo tribunë apo aktivitet tjetër me mysafir që nuk është nëpunës fetar i Myftinisë së Shkupit.
8. Nuk lejohet aktiviteti paralel i xhamisë me atë të Myftinisë në të njëjtën kohë.
9. Nuk lejohet ngrënia e iftarit apo e syfirit brenda xhamisë; ndërsa oborri mund të shfrytëzohet për të njëjtën.
10. Obligohen xhamitë që planifikojnë të kenë namaz nate, të njëjtën ta paraqesin në Myftini 10 ditë para fillimit të Ramazanit.
11. Të bëhet kërkesë me shkrim në Myftini për vaizet (gra) që do të angazhohen në xhami (Këshilli i xhamisë bën kërkesën në Myftini 10 ditë para fillimit të Ramazanit dhe kujdeset për pagesën e tyre).
12. Preferohet këmbimi i ligjëruesve të xhamive mes vete.
13. Të angazhohemi bashkërisht, si amanet i ynë, në tubimin e Zeqatit dhe të Sadekatul-Fitrit për institucionet arsimore fetare: Medresenë dhe Fakultetin e Shkencave Islame.
14. Të respektojmë studentët dhe medresantët e angazhuar nëpër xhami. (21.03.2022)

që janë marrë në mbledhjen e mbajtur me anëtarët e Myftinisë së Shkupit; mbi mënyrën e organizimit të Ramazanit në të gjitha xhamitë e territorit të qytetit të Shkupit.

Më pas, Myftiu në emër të Myftinisë së Shkupit dekoroi me Mirënjohje të Veçantë ish-anëtarët e Myftinisë së Shkupit dhe ish-anëtarët e angazhuar nëpër Komisionet e Myftinisë së Shkupit, në shenjë falendërimi dhe respekti për kontributin e tyre gjatë mandatit 2017-2021. Mirënjohje morën: Nevzat ef. Ameti, Ferid ef. Selimi, hfz. Sabit ef. Emin, hfz. Sahdudin ef. Murati, Nimet ef. Ameti, Adnan ef. Kadriu, Ramadan Arifi, Kenan Abdulla (të gjithë anëtarë të Myftinisë së Shkupit); hfz. Shafi ef. Osmani, Kryetar i Komisionit të Hifzit, Shkup; hfz. Sheval ef. Azizi, anëtar i Komisionit të Hifzit, Shkup; Zeqirja ef. Tairi, anëtar i Komisionit Fetar-Arsimor të Myftinisë së Shkupit.

Në fund u bë shpërndarja e ID-kartelave për hoxhallarët, me vlefshmëri deri në vitin 2025, si dhe e vendimeve të Ramazanit 2022; në shqip, maqedonisht dhe turqisht, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

IMSAKIJE

RAMAZAN 1443 H / 2022

NIJET: NEVEJTU EN ESUME GADEN LIL-LAHI TEALA.		NIJET: NEVEJTU EN ESUME GADEN LIL-LAHI TEALA.		NIJET: NEVEJTU EN ESUME GADEN LIL-LAHI TEALA.	
DUAJA E IFTARIT: Allahumme leke...		IFTAR DUASI: Allahumme leke...		IFTAR DOVA: Allahumme leke...	
Lounge bar & Restaurant AKTIVA					
Bashkësia Fetare Islame e RMV - Shkup - Shoqata ILMUJE					
VENI RE					
SHUKAT I					
SHUKAT II					
SHUKAT III					
SHUKAT IV					
SHUKAT V					
SHUKAT VI					
SHUKAT VII					
SHUKAT VIII					
SHUKAT IX					
SHUKAT X					
SHUKAT XI					
SHUKAT XII					
SHUKAT XIII					
SHUKAT XIV					
SHUKAT XV					
SHUKAT XVI					
SHUKAT XVII					
SHUKAT XVIII					
SHUKAT XIX					
SHUKAT XX					
SHUKAT XXI					
SHUKAT XXII					
SHUKAT XXIII					
SHUKAT XXIV					
SHUKAT XXV					
SHUKAT XXVI					
SHUKAT XXVII					
SHUKAT XXVIII					
SHUKAT XXIX					
SHUKAT XXX					

BFI KA NXJERRË IMSAKIJEN

Në prag të muajit të bekuar të agjërimit, Bashkësia Fetare Islame e RMV, si çdo vit, ka nxjerrë Imsakijen për Ramazanin 1443 (2022). Imsakija është botuar nëpërmjet Shoqatës së Ulemave të BFI, me të gjitha kohët e namazeve për të gjitha qytetet e Maqedonisë së Veriut. Ajo jepet falas. Allahu ju bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI. (21.03.2022)

BFI GJITHMONË E PËRÇON ZËRIN E PAQES



Më 10 mars, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në selinë e Rijasetit Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup, Shkëlqesinë e Saj znj. Kejt M. Bërns (Kate M. Byrnes), thuhet në njoftimin e BFI-së.

Fillimisht, Reis'ul-Ulemaja e përshëndeti dhe i dëshiroi mirëseardhje Ambasadores së SHBA-ve në BFI, institucion i cili përfaqëson të gjithë myslimanët e Maqedonisë së Veriut, si dhe e njoftoi me funksionimin dhe me sfidat në organizimin e jetës fetare në vendin tonë dhe jashtë.

Ambasadorja Bërns e vlerësoi lart funksionimin e BFI-së, sidomos në promovimin e tolerancës dhe të bashkëjete-

sës në Maqedoninë e Veriut.

Më pas, të dy bashkëbiseduesit folën për ngjarjet aktuale - agresionin rus ndaj Ukrainës dhe e dënuan sulmin e paprovokuar të një populli dhe shteti sovran në zemër të Evropës, konflikt i cili, u tha, rrezikon tërë Evropën dhe është me potencial për ta implikuar tërë botën.

Reis'ul-Ulemaja ia bëri me dije Shkëlqesisë së Saj qëndrimin e BFI-së për sa i përket këtij konflikti, duke respektuar gjithmonë parimet islame që mbajnë anën e paqes, të jetës dhe të tolerancës mes popujve.

Reis'ul-Ulemanë në këtë takim e shoqëronin Sekretari i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi, Drejtori i Sektorit për Punë të Jashtme mr. Mustafa ef. Dauti dhe Shefi i

Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Me zonzjën Kejt Bërns shprehëm shqetësimet tona të thella për popullin e pafajshëm të Ukrainës me rastin e agresionit të paarsyeshëm rus, agresion ky që rrezikon paqen në botë, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook të njëjtën ditë.

Bashkësia Fetare Islame gjithmonë e përçon zërin e paqes mes popujve dhe deklaron se paqja është e pazëvendësueshme. Mbetëm me shpresë se SHBA me aleatët e saj do të gjejnë rrugën e vërtetë për përfundimin sa më të shpejtë të këtij agresioni të rrezikshëm dhe tragjik, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

AMBASADORJA E GJERMANISË QËNDROI NË BFI



Më 7 mars, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në selinë e Rijasetit Ambasadorin e Gjermanisë në Shkup, Shkëlqesinë e Saj znj. Anke Holstajn (Anke Holstein), thuhet në njoftimin e BFI. Fillimisht, Reis'ul-Ulemaja i dëshiroi mirëseardhje Ambasadores së Gjermanisë në institucionin e Bashkësisë Fetare Islame, që përfaqëson të gjithë myslimanët e Maqedonisë së Veriut. Ai e njoftoi mysafirin me funksionimin e BFI dhe organizimin e jetës fetare në vendin tonë dhe jashtë, nëpërmjet Qendrave Islame që veprojnë në Perëndim, posaçërisht në Gjermani, ku kemi një mërgatë të organizuar mirë në të gjitha aspektet.

Ambasadorja Holstajn e vlerësoi lart veprimtarinë e BFI, sidomos në organizimin e jetës fetare dhe promovimin e tole-

rancës dhe të bashkëjetesës si në Maqedoninë e Veriut, ashtu dhe jashtë kufijve, ku mërgata myslimane e këtij vendi është shembullore në zbatimin e këtyre parimeve fetare dhe demokratike, sidomos në Gjermani. Më pas, të dy bashkëbiseduesit u ndalën dhe ndanë mendime për ngjarjet aktuale që po ndodhin në lindje të Evropës, për agresionin rus ndaj Ukrainës dhe ndanë shqetësimet për faktin se luftërat asnjëherë nuk kanë sjellë asgjë pozitive për njerëzimin. Ata e dënuan ashpër përdorimin e forcës për të nënshtuar një popull të lirë dhe sovran. Bashkërisht e dënuan këtë agresion, i cili me "flakët" e tij po rrezikon ta "djegë" tërë Evropën.

Reis'ul-Ulemanë në këtë takim e shoqëronin Sekretari i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi, Drejtori i Sektorit për Punë të Jashtme mr. Mustafa ef. Dauti dhe Shefi i

Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni.

Ambasadorja Anke Holstajn - thuhet në njoftimin e BFI-së - është mbështetëse e madhe e vendit tonë në aspiratat evropiane dhe ajo erdhi si ambasadore karriere me moton: "Si Ambasadore e Gjermanisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për mua është e rëndësishme që t'i afrojmë vendet tona dhe popujt tanë dhe Maqedoninë e Veriut në formën më të mirë ta përkrahim në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian."

Të njëjtën ditë, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook ka shkruar: "Takim me Ambasadorin Gjermane - paqe në botë mbi të gjitha. Në shenjë respekti Ambasadores i ndamë emblemën e BFI të RMV me porosinë në gjuhën gjermane 'Ikre' - 'Lexo'. Ishte një nder i veçantë."

PRITJE DHE DREKË ZYRTARE PËR AMBASADORIN FRANCEZ

Më 25 shkurt, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Shefi i Kabinetit z. Abdylqerim Iseni dhe Drejtori për Marrëdhënie me Jashtë z. Mustafa Dauti, pritën në mënyrë solemne në një takim të ri substancial (thelbësor), në selinë e BFI-së në Shkup, delegacionin e Ambasadës së Francës, të kryesuar nga Shkëlqesia e Tij, Ambasadori i Francës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, z. Siril Bomgartner (Cyrille Baumgartner), përkthyesi z. Ardian Ramadani, si dhe anëtarja e stafit, znj. Kami Ibos (Camille Iboss), pasuar me një drekë zyrtare, ofruar për mysafirët solemnisht nga Reis'ul-Ulemaja, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Gjatë takimit u bisedua për shumë çë-



shtje që ndërlidhen me dialogun ndërfaqet, paqen dhe tolerancën, si dhe për misionin dhe synimet e Bashkësisë Fetare Islame në mozaikun e brendshëm të shtetit, në hapërimin drejt integriteteve evropiane.

Bashkëpunimi i frytshëm mes BFI-së dhe Ambasadës së Francës ngelet në nivele të shkëlqyera, ndërkaq palët u zotuan për takime të tjera të radhës në të ardhmen, thuhet në njoftimin e BFI-së.

SHQETËSIM PËR AGRESIONIN RUS NË UKRAINË

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 10 mars, 2022, në selinë e Rijasetit priti Shkëlqesinë e Tij, Ambasadorin e Republikës së Sllovenisë në Shkup, z. Millan Predan, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në këtë takim, Reis'ul-Ulemaja e njoftoi Ambasadorin slloven me funksionimin dhe veprimtarinë e BFI-së në organizimin e jetës fetare në vend dhe jashtë, me ç'rast theksi u vu rreth mërgatës sonë që jeton dhe që veprojnë në Republikën e Sllovenisë. Ambasadori Predan e vlerësoi me nota të larta organizimin dhe sjelljen shembullore të mërgatës sonë në Slloveni.

Po ashtu u bisedua edhe rreth Ligjit për Bashkësitë Fetare në Republikën e Sllovenisë, i cili është një nga ligjet më respektabile në rajon për sa i përket respektimit të të drejtave dhe lirive fetare të banorëve të Sllovenisë.

Më pas, që të dy bashkëbiseduesit



ndanë shqetësimin e përbashkët për sa i përket agresionit rus në Ukrainë dhe bashkërisht dënuan përdorimin e dhunës dhe të armëve vdekjeprurëse kundrejt një populli dhe shteti sovran në zemër të Evropës.

Reis'ul-Ulemanë në këtë takim e shoqëronin Drejtori i Sektorit për Punë të Jashtme mr. Mustafa ef. Dauti dhe Shefi i

Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Me Ambasadorin e Sllovenisë në Shkup, z. Millan Prodan, sot u realizua një vizitë e rëndësishme, ka shkruar Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, të njëjtën ditë në faqen e vet në Facebook.

“PËRGJEGJËSI E MADHE ËSHTË TA PREZANTOSH ISLAMIN NË SLLOVENI”



Fjalimi i Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu me rastin e inaugurimit të Myftiut të Meshihatit të Sllovenisë, z. Nevzet Poriq (Porić), në Lubjanë:

Bismil-lahi-rrahmani-rrahim. "Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërdheshin prej teje, andaj ti falu atyre dhe kërkodjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu tek Allahu, se Allahu i do ata që mbështeten." (Ali Imran: 159)

I nderuar Reis'ul-Ulema i Bashkësisë Islame të Bosnjës dhe Hercegovinës dr. Husein Kavazoviç. I nderuar Myfti i Meshihatit të Bashkësisë Islame të Sllovenisë.

Të nderuar vëllezër dhe motra.

EsSelamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu.

Kam kënaqësinë e madhe t'i përcjell urimet e sinqerta në emër të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në emrin tim Myftiut të sapozgjedhur të Meshihatit të Bashkësisë Islame të Sllovenisë, z. Nevzet Poriq, dhe në të njëjtën kohë i lutem Allahut Fuqplotë që Myftiut të ri të Meshihatit të Sllovenisë t'i japë vullnet të fortë, të palëkundur, urtësi, sinqeritet dhe durim, shëndet, jetë të gjatë dhe suksese në një detyrë shumë të rëndë dhe të përgjegjshme.

Të dashur vëllezër dhe motra! Të jesh Myfti i Meshihatit të Bashkësisë Islame të Sllovenisë është një obligim dhe nder i madh, por mbi të gjitha është përgjegjësi e madhe ta prezantosh Islamit në një vend përparimtar, modern, demokratik

dhe evropian.

Nuk ka dyshim se Islami sot në të gjithë botën është realitet në të gjitha sferat e jetës njerëzore dhe është i gatshëm të jetë subjekt krijues për të kontribuar në lëvizjet pozitive këtu në Slloveni e më gjerë, sepse Islami është fe e dijes, e paqes, e tolerancës dhe e bashkëjetesës.

BFI e RMV është e gatshme dhe e vendosur të jetë në shërbim të bashkëpunimit të ngushtë me të gjitha Bashkësitë Islame në Ballkan, veçanërisht me Meshihatit e Sllovenisë, me në krye Myftiun z. Nevzet Poriq.

Duke parë kushtet e jashtëzakonshme të MBI këtu në Lubjanë, jam i bindur se myslimanët e udhëhequr nga Myftiu i ri dr. Poriq do të jenë në nivelin e detyrës për të ruajtur vlerat e tyre tradicionale dhe islame, duke edukuar vetë myslimanët dhe duke ndërtuar marrëdhënie të mira me të gjithë, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare apo kombëtare.

Në fund, të dashur vëllezër dhe motra, ju falënderojmë për ftesën që të jemi sot në këtë ambient imponues dhe në këtë tubim madhështor, që shënon një frymëzim të ri dhe të gjallë për një të ardhme më të mirë për Islamit dhe për myslimanët në këtë rajon.

MYFTIU I RI MORI DETYRËN



Më 18 mars, 2022, dr. Husein Kavazoviç, Reis'ul-Ulema i Bosnjës dhe Hercegovinës, i dorëzoi Muraselen Kryetarit të ri të Meshihatit të Bashkësisë Islame të Sllovenisë mr. Nevzet Poriq në xhaminë e Lubjanës. Në manifestim ishte i pranishëm edhe Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i BFI të RMV u shoqërua nga Myftiu i Strugës mr. Salim ef. Sulejmani dhe Drejtori për Diasporë dr. Selver ef. Xhemaili, ndërsa pjesëmarrja ishte me ftesë të Meshihatit të Bashkësisë Islame të Sllovenisë. Merrnin pjesë

mysafirë të lartë nga Bosnja dhe Hercegovina, Sanxhaku, Mali i Zi dhe RMV. Kryetari i ri edhe zyrtarisht e mori detyrën e Myftiut.

Në fjalën përshëndetëse Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu falënderoi organizatorët për ftesën dhe njëherësh i shprehu urime të përzemërta Kryetarit të ri të MBI të Sllovenisë për detyrën e re, duke i dëshiruar suksese të reja në menaxhimin e jetës fetare në Slloveni.

Solemnitetin e nderoi edhe prezenca e Kryetarit të Republikës së Sllovenisë, z. Borut Pahor. Ishin të pranishëm edhe kryetarët e bashkësisë fetare të tjera në Slloveni, thuhet në njoftimin e BFI.

VIZITË MBRESËLËNËSE XHAMISË NË CASALDO TË ITALISË

Më 19 mars, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Myftiu i Myftinisë së Strugës mr. Salim ef. Sulejmani dhe Drejtori për Diasporë dr. Selver ef. Xhemaili, vizitoi Xhaminë në Casaloldo-Itali, ku u pritën nga dr. Reshat Ibishi, me Kryesinë e Xhamisë, thuhet në njoftimin e BFI.

Vizita u bë me ftesë të Qendrës Islame në Casaloldo. Në këtë mbresëlënëse dhe shumë të këndshme, me prezencë të një numri të madh të bashkëvendësve tanë dhe kontribuesve të Xhamisë, delegacioni lartë i BFI me në krye Reis'ul-Ulemanë përshëndetën të pranishmit, me disa këshilla dhe falënderime për pritjen e ngrohtë dhe vëllazërore.

Pas porosive dhe fjalëve përshëndetëse të Myftiut të Strugës, mr. Salim ef. Sulejmani dhe Drejtorit për Diasporë, dr. Selver ef. Xhemaili, Kryetari i BFI të RMV në këtë mbresëlënëse drejtua të pranishmëve me një ligjëratë dhe prezantim modest, me ç'rast foli për vlerat e bashkatdhetarëve dhe të qendrave islame në diasporë, për sfidat e tyre, si dhe për angazhimin e Bashkësisë Fetare Islame në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e jetës fetare në vendlindje, si dhe në diasporë, si dhe për kontributin e pashmangshëm të bashkatdhetarëve tanë për mirëmbajtjen e pesë medreseve në RMV, në vendlindje.

Prezantimet ishin shumë domethënëse dhe kuptimplote, me një qasje inovative ndaj sfidave të kohës së sotme, si dhe shumë



mbresëlënëse dhe inspiruese për të gjithë të pranishmit.

Në fund, për kontributin e madh të këtij xhemati Kru i BFI i ndau mirënjohje Imamit të kësaj qendre, si dhe Kryetarit të BFI të Italisë, dr. Reshat ef. Ibishi, me motivacionin "Veteran i jetës fetare në diasporë, Itali". Po ashtu, u dekorua edhe Kryesia e Xhamisë për angazhimin dhe kontributin në zhvillimin e jetës fetare në këtë qendër, e cila vlerësohet si një ndër qendrat islame shqiptare më aktive në diasporën shqiptare e sidomos në Itali.

Falënderim i veçantë iu bë Kryesisë së Xhamisë, si dhe të gjithë pjesëmarrësve për vëmendjen dhe prezencën e tyre. Zoti i nderoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

ORGANIZIM I MREKULLUESHËM I JETËS FETARE NË TREVIZO

Gjatë vizitës në Itali, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut,

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 20 mars, 2022, vizitoi xhaminë "Emaneti" në

Susegana, Trevizo (Itali), thuhet në njoftimin e BFI.

Bashkë me anëtarët e delegacionit të BFI të RMV – Myftiun e Strugës mr. Salim ef. Sulejmani dhe Drejtorin për Diasporë dr. Selver ef. Xhemaili, patën një pritje madhështore nga xhamati i kësaj xhamie.

Fillimisht, Imami i Xhamisë Avnija Nurçevski dhe Kryesia e Xhamisë i dëshiruan mirëseardhje delegacionit të Bashkësisë Fetare Islame të RMV me në krye Reis'ul-Ulemanë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu e vlerësoi lart organizimin e këtij xhemati dhe i informoi ata për rrjedhat e organizimit të jetës fetare në vendlindje, si dhe me rezultatet tjera që ka arritur BFI gjatë dy viteve të fundit.

Ajo që binte në sy, ishte organizimi i mirëfilltë i xhematit, i cili vinte nga të gjitha trojet e Maqedonisë së Veriut. Po ashtu, objekti i Xhamisë ishte pronë e besimtarëve, të cilin e kanë blerë



dhe tani e kanë në pronësi të tyre, ndërsa Xhamia i kishte të gjitha kushtet - me mejtep dhe me vendin për gjininë femërore.

Delegacioni i BFI i shprehu falënderimet më të përzemërta xhamisë "Emaneti" në

Susegana, Trevizo (Itali) për pritjen madhështore, thuhet në njoftimin e BFI.

VËLLEZËRIT RAMADANI, ME PROJEKTE GJIGANTE NË ITALI

Gjatë vizitës në Qendrën Islame në Casaloldo (Itali), delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame të RMV vizitoi edhe ndërmarrjen e madhe "ZECCA S.r.l." të Vëllezërve Ramadani nga Patishka Reka e Shkupit, ndërmarrje kjo për projekte të mëdha të përcuesve të rrymës, thuhet në njoftimin e BFI.

Vëllezërit Enver, Azem dhe Hasan janë një familje shumë e suksesshme, me rezultate gjigante në Itali, ku ndërmarrja e tyre realizon projekte të mëdha në tërë shtetin italian.

Gjatë vizitës, z. Azem Ramadani në detaje shpjegoi se si funksionon kjo ndërmarrje e madhe, e cila ka të punësuar mbi 200 punëtorë profesionalë.

Kryetari i BFI i shprehu urime të përzemërta në emër të delegacionit, me lutje tek Allahu Fuqplotë që t'u japë suksese në veprimtarinë e tyre. Familja Ramadani është një donator i njohur në sferën fetare dhe kombëtare. Ishte kënaqësi që nga afër të shihet veprimtaria e mërgatës sonë. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI. (19.03.2022)

ME KRENARI KULTIVOHET ISLAMI NË ASOLO

Më 20 mars, 2022, pas namazit të jacisë, delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, i kryesuar nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, vizitoi Xhaminë në Asolo të Italisë, thuhet në njoftimin e BFI.

Në delegacion ishin edhe Myftiu i Strugës mr. Salim ef. Sulejmani dhe Drejtori për Diasporë dr. Selver ef. Xhemaili.

Në Xhaminë në Asolo u pritën nga një numër i madh besimtarësh, me në krye Imamin h. Emro ef. Ajdarovski dhe Kryetarin e Kryesisë, z. Mukrem Sejdiu, pastaj nga z. Fejsali, z. Jetoni e të tjerë.

Ishte një ambient i bukur dhe masiv. Mirëseardhje në xhaminë e tyre Reis'ul-Ulemasë dhe shoqëruesve të tij u dëshiroi Imami h. Emro ef. Ajdarovski, duke theksuar se Shtëpinë e Zotit në këtë vendbanim italian ata tashmë e kanë në pronësi.

Nga ana e tyre, delegacioni i BFI e përshëndeti xhematin e kësaj xhamie dhe



i uroi për arritjet që kanë bërë. Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu u shpreh falënderimet në emër të tij dhe të delegacionit që kryesonte, sidomos për pritjen madhështore, ndërsa më pas e njoftoi xhematin me rrjedhat në BFI të RMV, si dhe i përndau këshilla për organizimin e jetës fetare në vendin ku punojnë.

Pritja ishte mbresëlënëse dhe do të mbetet në kujtim të gjatë, sidomos re-

spekti i këtij xhemati.

Për punën e madhe që kanë bërë në vazhdimësi, Xhamisë së Asolos - Itali iu nda një mirënjohje, e cila iu dorëzua Kryetarit të Kryesisë së Xhamisë, z. Mukrem Sejdiut, ndërsa Imamin Emro Ajdarovskit iu nda mirënjohje për punën e palodhshme në kultivimin e vlerave fetare.

Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

NË SEZHANA, TEK IMAM QAZIMOSKI

Në kthim, delegacioni nga BFI e RMV ka qëndruar në qytetin Sezhana (Sežana) të Sllovenisë. Është vizituar xhamia e këtij qyteti, ku si Imam shërben z. Shaban Qazimoski, me një xhemat të vyeshëm nga Maqedonia e Veriut, kryesisht nga Llabunishti i Strugës, thuhet në njoftimin e BFI. Shihej, thuhet në njoftim, një formim i kushteve shumë të mira për kryerjen e obligimeve fetare dhe të mësimbesimit islam. Delegacioni u takua me Kryesinë e Xhamisë, të cilët informuan se, përveç tjerash, është blerë edhe objekti dhe tani është pronë e tyre.

Delegacioni u ka shprehur mirënjohje, siç thuhet, për punën e madhe që kanë bërë. Mbetën shumë të kënaqur me



vizitën që ua bëmë. Në emër të BFI të RMV, i shoqëruar nga anëtarët e delegacionit: Myftiut të Strugës mr. Salim ef. Sulejmani dhe Drejtorit për Diasporë dr. Selver Xhemaili, u shprehëm urimet tona, duke iu lutur Allahut Fuqiptotë që

t'u japë suksese të reja. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

Me përmbajtje të ngjashme ka dalë edhe Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, të njëjtën ditë, në faqen e vet në Facebook. (21.02.2022)

PRITJE NGA GASTRONOMI I NJOHUR FARUK NEZIRI

Faruk Neziri, gastronomi nga Çe-grani (Gostivar) me renome ndërkombëtare në Kastelucchio, ka pritur delegacionin e BFI të RMV gjatë qëndrimit të tij në Itali, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, është shoqëruar nga Myftiu i Strugës mr. Salim ef. Sulejmani dhe nga Drejtori për Diasporë dr. Selver ef. Xhemaili.

Ishte një pritje e ngrohtë, me një spekt të veçantë, thuhet në njoftim. Zoti Faruk Neziri është një profesionist i njohur, i cili në Itali ka marrë "Çmimin e Parë" në këtë veprimtari, si dhe shumë mirënjohje të tjera ndërkombëtare. Ai vlerësohet me përgatitjen e ushqimeve origjinale, si dhe me projektin e ushqimeve gjithëshqiptare, që janë kultivuar dhe kultivohen edhe sot e kësaj dite, si një projekt kombëtar shqiptar.

Klientët që vizitojnë restorantin e tij janë të profesioneve të ndryshme dhe elitare. Njihet edhe si artist i pikturave të llojeve të ndryshme, ku ka arritur rezultate të larta.

Delegacioni i BFI falënderoi nikoqirin për ftesën dhe për respektin e treguar. Gastronomit Faruk Neziri në fund i dëshiroi shëndet dhe vazhdim të sukseseve të reja në veprimtarinë që kryen, thuhet në njoftimin e BFI. (20.03.2022)


SHËNOHET NATA E BERATIT NË XHAMINË ALI PASHA

Manifestimi qendror i Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame të RMV për nder të Natës së Beratit u mbajt të enjten në mbrëmje, më 17 mars, 2022, në Xhaminë Ali Pasha të Ohrit, thuhet në njoftimin e BFI.

Organizimi ishte nga Myftinia e Ohrit, me në krye Myftiun h. Samet ef. Ajdari. Nga Rijaseti i BFI në këtë aktivitet u angazhua Sektori për Kulturë, i udhëhequr nga Musanif ef. Rufati.

Në manifestim, në emër të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i ndodhur në udhëtim zyrtar, prezantoi Myftiu i Myftinisë së BFI-Shkup, dr. Qenan ef. Ismaili.

Kjo natë u shënuar në mënyrën më të mirë, me program të pasur, me Kuran e ilahi, në prani të shumë pjesëmarrësve, ku si mysafir ishte delegacioni i lartë i Dijanetit të Turqisë, pastaj Atasheu për Çështje Fetare i Ambasadës së Turqisë në Shkup hfz. Mustafa ef. Mesten, Sekretari i Përgjithshëm i BFI h. Irsal ef. Jakupi, myftinjte e BFI-së: h. Sabahudin ef. Zen-



deli (Gostivar), h. Qamil ef. Rushiti (Kërçovë), Shefi i Kabinetit të Reis'ul-Ulemasë dr. Abdylqerim ef. Iseni, Drejtori i Sektorit për Arsim dhe Shkencë prof. Jusuf ef. Zimeri, Drejtori i Sektorit për Kulturë h. Musanif ef. Rufati, personalitete të ndryshme, hoxhallarë e hafëzllarëve dhe xhematlinj të Ohrit.

Me këtë rast, Myftiu i Shkupit i uroi të gjithë të pranishmit në emër të Reis'ul-



MBËSHTETUR MBI PRAGUN E PRITJES...

"Dashninë që Allahu ta vendos në zemër... nuk ka forcë a pushtet që ta heqë, pos Atij që e ka vendosur! Mos pyet, as ata që e provuan, as mjekun!", thoshte Ahmed Sheuki i famshëm...

Malli i kësaj nate përmendi emrin tënd dhe zemra u ndez flakë, në këtë sahar të heshtur kujtimesh... Errësitrat u përumbën në tingujt që lanë pas prekjet e natës plot bekim qiejsh pa kufi... Flaka e ndezur ndriçoi, si thirrje udhëzimi, larg mbi Tur...

Mbështetur mbi pragun e pritjes vë-

shtroj në horizont, larg shfaqet Drita jote, që s'ka të krahasuar me asnjë bukuri të kësaj bote iluzionesh jetëshkurtra...

Para teje shuhen tërë rropatjet e dëshpëruara të skllëvërve të kësaj bote; asgjë s'ka më vlerë, veç bukurisë së emrit tënd në këtë natë, që përkund me melan-kolinë e saj trazimin e zemrës...

Mbështetur mbi pragun e pritjes vë-shtroj natën në sy... Kjo jetë është e var-

Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, duke iu dëshiruar plot mirësi e begati të panumërta.

"Ne, përfaqësues të Islamit, ne që i besojmë Fjalës së Allahut dhe që jemi pa-sues të rrugës së ndritshme të pejgamberit tonë, Muhamedit (a. s.), duhet që në përditshmërinë tonë, me njerëz të cilitdo besim e kulturë, të reflektojmë paqe, dashuri e mëshirë në çdo kohë e në çdo vend. Kështu na urdhëron Allahu i Madhërishtëm e kështu na ka porositur edukatori ynë, Muhamedi (a. s.)", tha, mes tjerash, në fjalimin e vet Myftiu i Myftinisë së BFI-Shkup, dr. Qenan ef. Ismaili.

Ju qoftë për hair kjo natë e bekuar! – thuhet në njoftimin e BFI.

Manifestimi fetar me rastin e Natës së Beratit, organizuar nga BFI e RMV dhe Myftinia e Ohrit, në kohë reale është transmetuar drejtpërdrejt në platformat elektronike të Bashkësisë Fetare Islame të RMV.

fër pa prekjet e mallit tënd; pa të, ajo mbetet sahra e thatë, pa ujë e pa bekim... Kjo jetë nuk vlen as sa një natë e heshtur, pa dashninë e ujitur nga Krijuesi i saj...

Mbështetur mbi pragun e pritjes, zemra nis e këndon ca vargje të lashta: "O fllad i erës, thuaju degëve të njoma, trëndafilve veçse ma shtoi etjen..!", pa kthyer kokën, as djathtas, as majtas...

Mbështetur mbi pragun e pritjes, me flladet e kësaj nate, dërgova Selamet e mallit përtej horizontit...

Imam Muhamed B. Sytari

NATA E BERATIT - NATË E PASTRIMIT SHPIRTËROR

Më 17 mars, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka shkruar:

“Sonte jemi në pritje të natës së vlefshme, me vlera të larta shpirtërore, të Natës së Beratit, që shënon natën e 15-të të muajit Shaban. Kjo natë e madhe është rast i veçantë që t'i kthehemi vetes tonë, për të pastruar shpirtin dhe zemrat tona, për të ngritur vetëdijen tonë mbi vlerat; për të edukuar veten, familjen, shoqërinë, për të qenë në shërbim të Zotit të Madhërisëm.

Në emër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe në emrin tim, ju shpreh urremtet e përzemërta, me lutje Allahut Fuqipotë për praninë të veprave të mira, të lutjeve tona, të pendimeve tona, të faljeve të mëkateve tona, të evitimit të dobësive tona, të forcimit të lidhjeve tona ndërfinansore dhe ndërnjerëzore dhe vendosjen tonë në shërbim të mirëqenies dhe të paqes në këtë nënqiell dhe në botën në përgjithësi.”

Fjala berat në gjuhën arabe do të thotë të shpëtosh, të falesh e të lirosh prej gjynaheve, prej fajeve dhe dënimeve. Në këtë natë shumë myslimanë gjejnë faljen dhe lirinë prej gjynaheve nga ana e Allahut (xh. sh.), i arrijnë mirësitë dhe dhuntitë e Zotit dhe zemrat u mbushen me nur e dritë hyjnore, ka thënë hfz. Jusuf ef. Xheladini.

“Është kjo natë e bekuar dhe e madhe, ngase, sipas disa komentuesve të Kuranit, në këtë natë Kurani fisnik ka zbritur në formë të plotë nga qielli i shtatë në të parin, pra në qiellin e dynjasë, kurse në natën e Kadrit ka filluar t'i shpallet Pejgamberit (a. s.) në formë shkallë-shkallë, brenda 23 vjetëve”, ka thënë ai.

Nënkohë që ne rendim pas ëndërimeve, dëshirave, punëve e halleve të kësaj dynjaje, po harrojmë se kush jemi, nga vijmë e ku shkojmë, ka theksuar h. Besar Ilazi. - Neve na duhet një ndalesë, një pauzë, që ne të kujtohem se kush jemi në të vërtetë, cila është arsyeja që jemi krijuar, kush na ka krijuar, përse kemi ardhur në këtë botë. Kjo mënyrë e të menduarit merr akoma më shumë kuptim pikërisht në këtë natë, e cila ka një vlerë të madhe, ka thënë h.



Besar Ilazi në vigjilje të Natës së Beratit 2022.

Salim ef. Sulejmani shkruar: “I dërguari i Allahut (s.a.v.s.) ka thënë: ‘Kjo natë është nata e 15-të e muajit Shaban. Në këtë natë Allahu i shpëton njerëzit nga Xhehenemi sa numri i qimeve të deleve të fisit Beni Kelb, por nuk i shikon fytyrat e atyre që i bëjnë shirk Atij, të atyre që bëjnë urrejtje dhe armiqësi ndaj myslimanëve, të atyre që i shkëpusin lidhjet me të afërmit, të atyre që mburren dhe janë mendjemëdhenj, të atyre që nuk i respektojnë prindërit dhe të atyre që vazhdimisht pijnë alkool.’ (Buhariu, Tirmidhiu) Nata e Beratit shënohet edhe si nata kur engjëjt fillojnë të shkruajnë fatin e njerëzve për vitin në vijim. Nata e Beratit po ashtu na lajmëron ardhjen e shpejtë të muajit të bekuar të Ramazanit, andaj ta kalojmë në namaz, në agjërim nafile dhe në lexim të Kuranit. Dashed Zoti të përfitojmë mëshirën e Allahut dhe faljen e Tij.”

Nga Xhamia Shqiptare e qytetit Rorschach (Zvicër) kanë shkruar: Përveç emrit Berat, Beraet, kjo natë ka emrat: Nata e Begatë, Nata e Pafajësisë, sepse, nëse vlerësohet si duhet, është një mun-

dësi e dhënë nga Allahu për të dalë i pastër nga gjynahet dhe gabimet. Kjo natë quhet edhe “Sak”, dekret shpëtimi. Gjithashtu, mban emrin Nata e Mëshirës, meqë njerëzit përfitojnë nga mirësia dhe mëshira e madhe e Allahut (xh. sh.). Një tjetër rëndësi që i jepet kësaj nate është mendimi i disa dijetarëve, të cilët pranojnë se ndërimi i Kibles nga Mesxhidi Aksa drejt Qabesë ka ndodhur vitin e dytë të Hixhretit pikërisht në këtë natë të bekuar.

Pesë veçoritë e Natës së Beratit: 1. Në këtë natë bëhet ndarja dhe përzgjedhja e punëve më të rëndësishme; 2. Adhurimet që bëhen në këtë natë dhe agjërimi që mbahet ditën (në vijim), kanë vlera shumë të mëdha; 3. Është një natë e mbushur plot me mirësi hyjnore dhe me begati; 4. Është nata e faljes; 5. Është dhënë e drejta e plotë Resulullahut për të bërë shefaat (ndërmjetësim për falje) për myslimanët. Pejgamberi (a. s.) në natën e 13-të të muajit Shaban kërkoi shefaat dhe iu dha një e treta; në natën e 14-të kërkoi përsëri shefaat dhe iu dha një e treta; në natën e 15-të (në Natën e Beratit) kërkoi përsëri dhe iu dha i plotë shefaati për ummetin e tij.”

TAKIM ME AMBASADORIN E EGJIPTIT NË SOFJE

Më 2 mars, 2022, në Sofje, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, realizoi një takim zyrtar me Ambasadorin e Egjiptit në Republikën e Bullgarisë, dr. Halid Ammareh, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në shoqërim të Reis'ul-Ulemasë ishin prof. Ibrahim ef. Idrizi - Drejtor i SHMI "Medreseja Isa Beu", Shkup dhe h. Ismet ef. Ademi - Drejtor i Sektorit për Marrëdhënie me Botën Arabe.

Me Ambasadorin e Egjiptit u realizua një takim miqësor dhe vëllazëror, thuhet në njoftim, me ç'rast Kreu i BFI-së e falënderoi Shkëlqesinë e Tij për pritjen që i bëri delegacionit të BFI.

Më pas, palët biseduan për shumë çështje aktuale, në veçanti për shqetësimin pas agresionit rus në Ukrainë dhe shprehën mendimin se lufta është e keqja më e madhe që i ndodh njerëzimit.

Tema kryesore e takimit ishte ripërtëritja e Marrëveshjes me Universitetin e Ez'herit në Kajro, për regjistrimin e nxënësve tanë në këtë universitet me famë botërore dhe historike. Delegacioni i BFI-së i dorëzoi Ambasadorit Ammareh drejtpërdrejt të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe nga ai morën premtimin se ky proces do të përfundojë me sukses, në afat sa më të shkurtër.

Njëherësh, delegacioni i BFI i shprehu Ambasadorit të Egjiptit përshtypjet e mira dhe memoriet e bukura me rastin e pjesëmarrjes së Kreut të BFI në Konferencën ndërkombëtare në Kajro, e cila u mbajt në datat 12 dhe 13 shkurt.

Të dyja palët u pajtuan që bashkëpunimi reciprok të vazhdojë në bazë të një respekti të ndërsjellë edhe në të ardhmen, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Një takim i frytshëm me Ambasadorin e Egjiptit dr. Halid Ammareh – ka shkruar Drejtori Ibrahim ef. Idrizi në Facebook. Në vazhdim ai ka thënë: Më 2 mars, 2022, së bashku me Kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef.



Fetahu, patëm një takim shumë të dobishëm dhe të frytshëm me Ambasadorin e Egjiptit me seli në Sofje të Republikës së Bullgarisë, dr. Halid Ammareh. Qëllimi i vizitës ishte mjaft i rëndësishëm për Medresenë Isa Beu, respektivisht temë e bisedës ishte përtëritja e Marrëveshjes mes Medresesë Isa Beu dhe njërit ndër universitetet më të vjetra në botë dhe me famë botërore – Universitetin e Ez'herit në Egjipt. Në këtë takim u bisedua për rolin dhe rëndësinë që ka ky universitet në kultivimin e dijes dhe përgatitjen e kuadrin të dijetarëve për të realizuar detyrën e misionarit dhe të mëkëmbësit të të Madhit Zot në këtë botë. Gjithashtu, këtij takimi iu bashkëngjiti edhe Drejtori për Marrëdhënie me Botën Arabe, h. Ismet ef. Ademi. Në fund, e falënderuam Ambasadorin për mikpritjen dhe angazhimin e tij në realizimin e shumë projekteve të Bashkësisë Fetare Islame, në veçanti të institucioneve edukativo-arsimore në vendin tonë, ka njoftuar Drejtori i Medresesë Isa Beu, prof. Ibrahim ef. Idrizi.

LUTJE PËR PAQE NË KISHËN QENDRORE SCHAFFHAUSEN



Anëtari i Kryesisë së Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër, njëherësh dhe Imam i Xhamisë Meka në Schaffhausen (Zvicër), Nimetullah ef. Veseli, me ftesë të Organizatës për Dialog Ndërfetar më 14 mars, 2022, mori pjesë në lutjet e paqes me moton “Së bashku për paqe - Gemeinsam für den Frieden”, thuhet në njoftimin e Xhamisë Meka, Schaffhausen.

Kjo ngjarje u shënuar nën kujdesin e Kishës Qendrore të Schaffhausenit, ku pjesëmarrës ishin gati të gjitha komunitetet fetare. Një mozaik i bukur! Imami lexoi pjesë nga Kurani famëlartë, respektivisht nga kaptina Huxhurat, ajetet 9, 10 dhe

13. Ndërsa përcolli edhe këtë mesazh:

“Lutja për paqe është kuptim i vetë lutjes. Do të kemi shumë probleme në jetë, por nuk guxojmë të kemi më shumë se një rrugë për zgjidhjen e tyre, e që është vetëm rruga e dialogut, e mirëkuptimit dhe e tolerancës! Jemi të ndryshëm për nga pamjet, për nga gjuha, feja, kultura, por buzëqeshjen, jetën, lirinë, dashurinë, paqen i kemi të përbashkëta! Nëse do të ketë njerëz që do të zgjedhin dhunën e luftën, ne do të zgjedhim gjithmonë rrugën e paqes! O Zot, të lutemi, mos na privo nga mirësia e paqes dhe e dashurisë, nga mirësia e harmonisë dhe e lumturisë. O Zot, zbutë çdo zemër të ashpërsuar. Amin!”

Paraqitja e Imam Nimetullah ef. Veselit në Kishën Qendrore të Schaffhausenit është mirëpritur gjerësisht nga të pranishmit dhe nga opinioni publik i Zvicrës, thuhet në njoftimin e Xhamisë Shqiptare në Schaffhausen, dërguar drejtpërdrejt revistës “Hëna e Re”.

NDJESË

Titulli duhet të jetë: Për pasurimin e shpirtit tonë, jo si ka dalë (“Hëna e Re”, nr. 365, shkurt 2022, fq. 13 B). Nga Redaksia.

TRIBUNA 30: XHAMIA EL-HIDAJE, ST. GALLEN

Më 26 shkurt, 2022, Xhamia El-Hidaje në St. Gallen ka mbajtur tribunën kushtuar 30-vjetorit të saj. Për këtë përvjetor Xhamia ka organizuar, dhe do të organizojë gjatë tërë vitit, edhe aktivitete të tjera, njoftojnë nga kjo qendër islame shqiptare, ku Imam është Mehas ef. Alija, njëherësh dhe Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër (DAIGS).

Viti 2022 është një vit i veçantë dhe historik për xhematin e Xhamisë El-Hidaje, pasi në këtë vit, më 23 shkurt 2022, mbushen 30 vjet prej formimit dhe themelimit të Bashkësisë Islame Shqiptare në qytetin St. Gallen. Për shënimin e këtij përvjetori janë paraparë disa aktivitete, me të cilat shpresojmë ta begatojmë sa më shumë gëzimin tonë, njoftojnë nga Xhamia El-Hidaje.

Në tribunën kushtuar këtij përvjetori i ftuar ka qenë dhe në të ka marrë pjesë Myftiu i Myftinisë së BFI-Shkup, dr. Qenan ef. Ismaili. Çaste të këndshme për xhuma në 'El-Hidaje' me Myftiun e nderuar të Shkupit, ka shkruar Mehas ef. Alija.

Në profilin e vet në Facebook Myftiu i Shkupit ka njoftuar: "Ishte nder dhe kënaqësi të jem në mesin e besimtarëve të qytetit St. Gallen, të xhematit të mrekullueshëm të Xhamisë El-Hidaje.

U ndava me bindjen se një Imam, një Kryetar si hfz. Mehas ef. Alija dhe një xhemat si ky, i mirë organizuar, i presin edhe shumë suksese të tjera. Ndjej obligim moral t'i falënderoj për kujdesin e treguar dhe - Allahu qoftë në ndihmë të tyre."

Një përvjetor i veçantë, me ligjërues të veçantë: Myftiun e Kryeqytetit të Dardanisë, Shkupit - ka shkruar xhematliu h. Qemal Rushiti, autor i një libri për Haxhin. Xhamia ishte, ka qenë dhe do të jetë foleja dhe vendtakimi ynë i përjetshëm, ka



thënë ai më tej. Si gjithandej, edhe ky tempull luajti një rol të jashtëzakoshëm ndër dekada. Nga aty na u dha mundësia ta njohim më së miri Zotin, fenë dhe kombin tonë. Aty u bëmë një grusht nga të gjitha trevat tona autoktone, ku ambiciet tona fetare-kombëtare i organizuam, i menaxhuam dhe i realizuam në formën më të mundshme. E pranuar, e fituar dhe e ndërtuar në formën më të bukur dhe, kështu siç na e lan të parët tanë, edhe ne do t'ua lëmë trashëgim brezave të rinj, që ata ta vazhdojnë këtë rrugëtim hyjnor në formën më vigjilente. Urime 30-vjetorin e qëndresës shpirtërore, fizike dhe historike Xhamisë El-Hidaje. Zoti i bekoftë të gjitha grupmoshat, të të dyja gjinive, që e mbështesin dhe e përkrahin misionin dhe vizionin tonë të përbashkët. We Selamun-Alejkum! - ka shkruar h. Qemal Rushiti në faqen e vet në Facebook pas tribunës në Xhaminë El-Hidaje, St. Gallen.

DY HATME TË VEÇANTA NË GJENEVË



Më 5 mars për burrat dhe më 6 mars, 2022, për gratë, në lokalet e Xhamisë Dituria në Gjenevë (Zvicër) u mbajt një program me rastin e përmblyljes së leximit të Kuranit (hatme) nga ana e 11 djemve dhe 18 vajzave që kanë ndjekur mësimin fetar tek Imami mr. Rijad ef. Aliu dhe te Hafëzja Rejhane Asipi Aliu, thuhet në njoftimin e Xhamisë Dituria-Gjenevë.

Programi ishte i përbërë nga lexime prej Kuranit famëlartë, të sureve, ila-

hive, si dhe të disa teksteve me përmbajtje edukative fetare islame.

Mysafir special, për ligjëratë, ishte hoxha Veton ef. Tulla nga Xhamia Flums (St. Gallen), pastaj hafëzi i njohur Xhemail Nuhui, i cili i kënaqi zemrat me ilahitë dhe Kuranin e kënduar para të pranishmëve.

Fjalë përshëndetëse pati Kryetari i Xhamisë, Abdulkadër Bekteshi, i cili në emrin e vet, të Imamit, të Kryesisë dhe të xhematit në përgjithësi u uroi vëlle-

zërve dhe motrave përfundimin e hatmes, duke iu dëshiruar suksese në jetë.

Për të gjithë nxënësit që kishin mbaruar hatmen e Kuranit Imami dhe Hafëzja e Xhamisë ndanë diploma, albume dhe nga një libër, thuhet në njoftimin e Xhamisë Dituria-Gjenevë.

Për hair ju qoftë hatmja, vëllezër e motra. Ta gëzoni, ishalla. Kurani ju qoftë mburojë në jetën tuaj, ka shkruar Imami mr. Rijad ef. Aliu në faqen e vet në Facebook.

XHAMIA "HËNA E RE" Mbledh të Rejat dhe të Rinjtë

Më 6 mars, 2022, në hapësirat e Xhamisë Hëna e Re në Kreuzlingen TG, Zvicër, u zhvillua takimi i radhës me afër 25 të rinj dhe të reja shqiptare myslimane nga Kreuzlingeni dhe rrethina, kanë njoftuar nga xhamia "Hëna e Re".

Fillimisht, Kryesia e Xhamisë për ta përgatiti ushqim nga skara. Më pas Imami Rejhan ef. Neziri ua prezantoi atyre hapësirat e Xhamisë: dy faltoret, sallën e mbledhjeve, zyrën e Kryesisë, klasën e mësimin islam dhe kafeterinë, ku edhe u zhvillua takimi i mëtejshëm.

Në vazhdim Imam Neziri me anë të projektorit ua prezantoi të pranishmëve historikun e Xhamisë, strukturën organizative, aktivitetet kryesore, si dhe 3 forumet e Xhamisë: Forumin e Grave Myslimane (më hollësisht për të foli Kryetarja Zuleja Nuredini); Forumin e të Shkolluarve në Zvicër („Networking“), që akoma është në ngritje e sipër (foli Imran Hasani); Forumin e të Rinjve (e prezantoi Imam Neziri, në mungesë të Kryetarit Arben Bajrami, për arsye shen-



detesore).

Në vazhdim u krijuan 4-5 grupe punuese për të mbledhur ide se çfare mund të bëjë Xhamia dhe Forumi i të Rinjve dhe te Rejave për ta dhe çfarë mund të bëjnë keta të rinj dhe te reja për Xhaminë dhe për Forumin.

Pas nja 20 minutave në grupe të ndara, pjesëmarrësit sërish u mbledhën në plenum, për të bërë rumbullakimin e ideve të tyre, të cilat u regjistruan në pllakate, sipas fushave: të fese, të kultures, të spor-

tit dhe të ndryshme dhe të njëjtat u arkivuan. Hapi i radhës ishte zgjedhja e një kryesie të ngushtë të këtij Forumi. Kryetar mbeti Arben Bajrami, Nënkryetare u zgjodh Sumeja Aziri, ndërsa Sekretar Jusuf Ziberi, thuhet në njoftimin e Xhamisë Hëna e Re, Kreuzlingen.

Në faqen e vet në Facebook, të njëjtën ditë, Imam Rejhan Neziri ka shkruar: "Një takim shumë i bereqetshëm! Allahu ju shpërbleftë për pjesëmarrjen dhe për angazhimin!"

FESAL EF. FETAI, IMAM I RI NË FRAUENFELD

Më 27 shkurt, 2022, në mënyrë solemne, përpara xhematit, u bë dorëzim - pranimi i detyrës së Imamit të ri, kanë njoftuar nga Xhamia Mesxhidi-Nur Frauenfeld TG (Zvicër).

Në fjalën e tij të rastit, Imami në pension, Sami ef. Misimi, falënderoi të gjithë xhematin, të cilit për dy dekada i shërbeu me përkushtim e zellshmëri dhe prej tij kërkoi hallallëkun.

Fjalë rasti pati edhe Kryetari i Xhamisë, z. Fatmir Sanakosi, i cili shprehu mirënjohje të thellë për punën dhe angazhimin e Mulla Samiut, i uroi pension të rehatshëm dhe njëkohësisht, në mënyrë zyrtare dhe solemne, përpara xhematit, përuroi imamin e ri, mr. Fesal ef. Fetai.

Në fund, fjalë përshëndetëse pati edhe Imami i ri, i cili falënderoi Imamin e gjertanishëm, Kryesinë dhe xhematin për mikpritjen e ngrohtë, duke u betuar para xhematit për punë korrekte dhe të drejtë. Zoti qoftë me ne - kanë njoftuar nga Xhamia Mesxhidi-Nur Frauenfeld (Zvicër).

99 VJET KMSH

Në datat 24 shkurt - 12 mars 1923 në Tiranë është zhvilluar Kongresi i Parë Mysliman Shqiptar, që shënon themelimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar. Në Kongres janë marrë vendime të rëndësishme për organizimin e jetës fetare islame për të gjitha trojet shqiptare, themelimi i një medreseje unike, e cila u quajt "Medreseja e Naltë" dhe i revistës "Zani i Naltë", si periodiku i parë islam në gjuhën shqipe...



TË KUPTUARIT E KURANIT NË KONTEKSTIN BASHKËKOHOR

Në Xhaminë e Bardhë në Aarburg të Zvicrës më 27 shkurt, 2022, është mbajtur seminari për të rinjtë në gjuhën gjermane "Të kuptuarit e Kuranit në kontekstin bashkëkohor". Ligjërues në të ka qenë h.fz. dr. Benjamin Idriz, me origjinë nga Shkupi.

S'është e lehtë të kalohet nga bota e mendimit të vetëm, në botën e mendimit integruar, që kërkon një udhëtim drejt subjektit dhe objektit, për shkak se nuk është një udhëtim i lehtë, pasi që kërkon gjetjen e mënyrave të reja për të kuptuar realitetin që i rrethon njerëzit dhe njerëzit janë fokusi i fetvasë dhe qëllimi i jurisprudence islame, ka shkruar në raportin e vet nga kjo ngjarje hoxhë Nehat Ismaili.

E, kur jeta është më e ndërlikuar, thotë ai më tej në raport, nevoja për të kuptuar realitetin është më e madhe dhe për këtë juristi mysliman bashkëkohor duhet të përgatit një qasje islame që do të ndihmonte komunitetin fetar në kuptimin e realitetit në dritën e teksteve, synimeve dhe objektivave të tyre.

Në këtë moment kritik të historisë, kur konstatojmë se jeta bëhet më e ndërlikuar, edhe evoluimi drejt një jete më komplekse e të gërshetuar dukshëm bëhet më i vështirë çdo ditë, madje çdo orë, dhe nga këtu nuk ka vend për ata që



nuk kanë një lexim gjithëpërfshirës dhe të integruar.

Shumica e njerëzve në këtë epokë akohen për mungesë të kohës, dhe për mungesë të informacionit, por kjo nuk është e vërtetë. Përkundrazi, jetojmë në një moment shpërthimi njohurish dhe komunikimesh të jashtëzakonshme mes njerëzve, por ajo që mungon në jetën e njerëzve është durimi në kërkim, këmbëngulja në lexim etj.

E, këtë më së miri e bëri h.fz. dr. Benjamin Idriz, Imami i nderuar i Xhamisë Penzberg (Munih), Gjermani, i cili në mënyrë të shkëlqyer diskutoi për çështje aktuale, tejet të rëndësishme dhe shumë sfiduese për intelektin njerëzor.

E gjithë kjo në një seminar të organizuar nga Xhamia e Bardhë Aarburg, de-

dikuar grupmoshave të reja, përfshi djem dhe vajza. Kumtesa u paraqit me një stil të lartë në gjuhën gjermane, në mënyrë akademike, me shumë bindje, me dinjitet dhe krenari.

Faleminderit, i nderuar Imam h.fz. dr. Benjamin Idriz! Allahu të bekoftë! – ka raportuar hoxhë Nehat Ismaili.

Të njëjtën ditë, në faqen e vet në Facebook, h.fz. dr. Benjamin Idriz ka shkruar: "Falënderoj për zemërsisht për ftesën dhe organizimin e Seminarit, i cili ishte një freskim intelektual dhe një kënaqësi e madhe për mua të jem në mesin e rinisë së xhamisë tuaj, Xhamia e Bardhë-Aarburg, dhe në mesin tuaj, i nderuar dhe shumë i respektuar Nehat efendi. Faleminderit edhe për fjalët e bukura për mua. Allahu ju ruajtë!"

ATMOSFERË DINI E IMANI NË XHAMINË TULIPAN

Atmosferë dini e imani përjetuam në Xhaminë Tulipan, Reinach AG (Zvicër), që nuk përshkruhet, por që përjetohet. Organizimi profesional dhe mikpritja e ngrohtë, tregon karakterin e xhematit të kësaj xhamie, ka shkruar h.fz. dr. Benjamin Idriz në faqen e vet në Facebook më 28 shkurt, 2022.

Kjo xhami madhështore është më e bukura në Zvicër dhe reflekton pasqyrën e identitetit shqiptaro-zviceran. Fillimi dhe mbarimi i ndërtimit të Xhamisë është bërë në kohën e pandemisë, përkatësisht në kohën më të vështirë dhe në një afat shumë të shkurtër. Besimtarët shqiptarë në qytetin Reinach e më gjerë kanë treguar se janë popull bujar dhe bamirës, që e do fenë dhe atdhenë, por dhe zhvillimin dhe integrimin në shoqërinë zvicerane.

E përgëzoi Imamin e Xhamisë, Efendi Halil Ademi, Kryetarin Azir Jusufi, Kryesinë, arkitekt Muharremin, xhematin, gratë dhe burrat, si dhe të gjithë donatorët e kësaj xhamie. Allahu ju shpërbleftë!



Falënderoj për interesimin që treguan për publikimet e mia. Librat që mora me vete, nuk mjaftuan, ngase interesimi ishte shumë i madh. Me gjithë dëshirë ia shkrova çdo personit emrin arabisht me kaligrafi artistike arabe.

Falënderoj anëtarët shqiptarë të xhamisë sime në Penzberg, që m'u bashkëngjiten në këtë udhëtim.

Falënderime të posaçme për Isak Si-

nanin, i cili i pari më kontaktoi për pjesëmarrjen time në manifestimin që u mbajt të shtunën në Reinach, si dhe për seminarin që u mbajt të dielën në Xhaminë e Bardhë-Aarburg. Allahu të shpërbleftë, vëlla Isak, për incizimin, për fotografitë dhe për organizimin e mirëfilltë!

Falënderoj edhe Shaqir Dervishoskin për shoqërimin e tij gjatë tërë udhëtimit, ka shkruar h.fz. dr. Benjamin Idriz.

MEDRESEJA, VATËR E DIJES DHE E MORALIT

Më 9 mars, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. h.fz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli, vizitoi SHMI "Medreseja Isa Beu" – Paralelja e Shtirirë e Vajzave në Gostivar, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Aty, vazhdon njoftimi, patën një pritje të veçantë nga Drejtori i Medresesë prof. Ibrahim ef. Idrizi dhe Administratorja e Paraleles prof. Myzeqete Hebibi, nga mësimdhënësit dhe nxënëset.

Tubimi u bë me ftesë të Drejtorit, të Administratores, si dhe të maturanteve në krye me kujdestaret e tyre. Tubimi u ndërlidh edhe me shënimin e 7 Marsit - Ditën e Mësuesit.

Drejtori e përshëndeti tubimin, duke shprehur mirëseardhjen dhe foli për ecurinë e procesit edukativo-arsimor në Medrese.

Në fjalën e tij, Reis'ul-Ulema h. h.fz. Shaqir ef. Fetahu falënderoi maturantet në krye me kujdestaret e tyre mr. Semire Fetahu dhe prof. Gjylimsere Jakupi për këtë tubim, pastaj foli për synimet e BFI-së në ngritjen e nivelit të Medresesë, si dhe për përpjekjet maksimale në



procesin e akreditimit të Medresesë, si dhe për shumë angazhime të tjera.

Mbresë të veçantë lanë fjalimet përshëndetëse të dy maturanteve Enisa Ebibi dhe Esra Ahmeti mbi rolin e Medresesë, rregullin dhe diturinë e madhe që marrin në këtë institucion fetar. Njëherësh, ato shprehën falënderimet e tyre për vizitën që bënë Kryetari i BFI dhe

Myftiu i Gostivarit.

Tubimin e përshëndetën edhe Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli dhe profesorë të tjerë.

Kreu i Bashkësisë Fetare Islame do të vazhdojë t'i vizitojë të gjitha Paralelet tjera të Medresesë sonë. Zoti i bekoftë. Medreseja është vatër e dijes dhe e moralit, përfundon njoftimi i BFI.

MIB: TAKOHEN GJENERATAT 9, 11, 12



Më 5 mars, 2022, u mbajt takimi jubilar i gjeneratave 9, 11 dhe 12 të medresantëve të Medresesë Isa Beu në Shkup dhe në të mori pjesë edhe Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. h.fz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Takimi u mbajt në prezencë të Drejtorit të Medresesë, prof. Ibrahim ef. Idrizi, Sekretarit Lutfi Nexhipi, profesore

rëve të parë: prof. Sabahudin ef. Mahmudi, prof. Rexhep ef. Osmani, prof. Shafi ef. Osmani.

Reis'ul-Ulemaja shoqërohej nga Shefi i Kabinetit, dr. Abdylqerim Iseni dhe bashkëpunëtorë të tjerë nga Rijaseti.

Me këtë rast, u përkujtuam dhe u përjetuam momentet më të bukura gjatë kohës së kaluar në këtë vatër edukativo-arsimore.

Të pranishmit, me një fjalim rasti i përshëndeti Reis'ul-Ulema h. h.fz. Shaqir ef. Fetahu, i cili nëpërmjet emocioneve i përkujtoi ditët e Medresesë, si dhe rolin e madh që kanë kuadrot e saj në shpjegimin e Islamit në vend dhe gjetiu nëpër Evropë, duke qenë nëpër funksione të sferave të ndryshme.

Të gjithë ish-nxënësit ishin të lumtur që takoheshin pas më shumë se dy dekada dhe përkujtonin me mall kohën e kaluar në SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup.

Bashkësia Fetare Islame e RMV, thuhet në njoftimin e BFI-së, është e hapur për të gjithë për kontributin e tyre, si dhe për sugjerimet, mendimet dhe këshillat. Falënderime për Drejtorin dhe stafin e tij për këtë organizim të mirë. Zoti i bekoftë – përfundon njoftimi.

Në rrjetet sociale, të njëjtën ditë, informacion, shoqëruar me fotografi, ishte dhënë edhe nga Medreseja Isa Beu dhe nga Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. h.fz. Shaqir ef. Fetahu.

MYFTINIA E RESNJËS, NË RRUGËTIM TË SHËNDOSHË



Më 3 mars, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, vizitoi Myftininë e Resnjës dhe mori pjesë në mbledhjen konstituive të saj, pas zgjedhjeve në BFI. Myftinia e Resnjës përfshin territorin e Prespës dhe udhëhiqet nga Myftiu h. Xhunejd ef. Jashar, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Gjatë kësaj vizite Kryetarin e BFI e shoqëruan Sekretari i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi, Drejtori i Sektorit për Arsim Fetar prof. Jusuf Zimeri dhe Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni.

Në emër të delegacionit të BFI, iu shprehën urime anëtarëve të rinj të Myfti-

nisë, duke iu dëshiruar suksese në detyrën e re. Njëherësh, Reis'ul-Ulemaja shprehu falënderime në emër të delegacionit për punën e madhe që ka bërë Myftinia në organizimin e jetës fetare, si dhe për procedurën e kthimit të disa pronave - vakëfit, vazhdimit të punëve në ndërtimin e katër lokaleve afariste, të selisë së re të Myftinisë, të ndërtimit të morgut, të gusulhanes dhe të shumë aktiviteteve të tjera.

Pasi që Myftiu dha raportin e aktiviteteve gjatë vitit 2021, ku vërtet u vërejt një angazhim i madh, Reis'ul-Ulemaja bëri ndarjen solemne të vendimeve për anëtarët e rinj të Myftinisë.

Në fund, në shenjë respekti, Myftiu falënderoi delegacionin e BFI të udhëhequr nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu për vizitën e bërë.

Nga ana e Myftinisë, pritja ishte vërtet e një niveli të lartë, që tregoi se kjo Myftini tashmë është serioze dhe drejt një ardhmërie të shëndoshë.

Namazi i iqindisë u fal në xhaminë qendrore "Haxhi Murat", ku namazit i priu vetë Myftiu h. Xhunejd ef. Jashar. Më pas delegacioni u takua me xhamatin e Resnjës, të cilit i dëshiroi suksese dhe falënderuan për pritjen e bërë. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

"ÇARSHI-XHAMIA" NË MBLEDHJEN E MYFTINISË SË PRILEPIT

Më 3 mars, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Sekretari i Përgjithshëm Irsal ef. Jakupi, Drejtori i Sektorit për Arsim Fetar prof. Jusuf Zimeri dhe Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni, mori pjesë në mbledhjen konstituive të Myftinisë së Prilepit, nën udhëheqjen e Myftiut h. Shefket ef. Imeri, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në këtë mbledhje Kryetari i BFI-së uroi të gjithë anëtarët e rinj, duke iu dëshiruar suksese dhe punë të mbarë në suazat e Myftinisë së BFI-Prilep. Njëherësh, Reis'ul-Ulemaja informoi të pranishmit edhe për procedurën e ndërtimit të xhamisë së djegur të Prilepit, Xhamia e Çarshisë, apo siç njihet ndryshe "Çarshi-Xhamia" dhe për tërë angazhimin dhe përpjekjet që po i bën Bashkësia



Fetare Islame e RMV që me sukses të kryhet dhe të përfundojë kjo brengë e kamotshme e BFI dhe e myslimanëve që jetojnë në këtë nënqiell.

Nga ana tij, Myftiu i Prilepit h. Shefket ef. Imeri falënderoi delegacionin e BFI të udhëhequr nga Reis'ul-Ulemaja dhe më pas bëri raportimin e aktiviteteve të ndërmarra gjatë vitit 2021, ndërsa në fund të

mbledhjes Reis'ul-Ulemaja bëri edhe ndarjen solemne të vendimeve për anëtarët e rinj të kësaj Myftinie, thuhet në njoftimin e BFI-së. Myftinia e Prilepit - unike dhe e sigurt në ardhmërinë e saj, ka shkruar të njëjtën ditë në faqen e vet në Facebook Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

MYFTINIA E MANASTIRIT HEDH HAPA PËRPARA

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Sekretari i Përgjithshëm Irsal ef. Jakupi, Drejtori i Sektorit për Arsim Fetar prof. Jusuf Zimeri dhe Shef i Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni, më 3 mars, 2022, mori pjesë në mbledhjen konstituive të Myftinisë së Manastirit, e cila u mbajt nën udhëheqjen e Myftiut të Manastirit h. Amit ef. Rasimi, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Fillimisht, Reis'ul-Ulemaja u shprehur urime të përzemërta anëtarëve të rinj, duke iu dëshiruar suksese në detyrën e re. Njëherësh, Reis'ul-Ulemaja i informoi të pranishmit për procedurën e ndërtimit të një xhamie në fshatin Llazhec, vend ku myslimanët përbëjnë 50 për qind të fshatit dhe akoma nuk kanë xhami ku t'i kryejnë ritet e tyre fetare, sepse grupe të ndryshme me qëllime të caktuara nuk lejojnë të ketë xhami në këtë fshat. Edhe përkundër gjithë pengesave dhe rrethanave, BFI dhe Reis'ul-Ulemaja po vazhdojnë angazhimin e madh që në këtë fshat të ndërtohet një xhami për nevojat e banorëve.

Më pas, Myftiu i Manastirit h. Amit ef. Rasimi dha raportin mbi aktivitetet e ndërmarra nga Myftinia e Manastirit gjatë vitit 2021, ku vërtet u vërejt një angazhim i madh i operativës, së bashku me Myftiun.



Në të njëjtën mbledhje Reis'ul-Ulemaja bëri edhe ndarjen solemne të vendimeve për anëtarët e rinj të Myftinisë.

Në fund të mbledhjes, Myftiu në shenjë respekti u ndau anëtarëve të delegacionit të BFI nga një dhuratë simbolike - gravurë e punuar në bronz e xhamive historike të periudhës osmane në qytetin e Manastirit.

Delegacioni i BFI, i udhëhequr nga Reis'ul-Ulemaja, pati fatin që namazin e drekës ta fal në xhaminë më të bukur të Manastirit, në Xhaminë Isakije, ku faljes i priu Imami z. Orhan ef. Demiri. Pas faljes së namazit të drekës, Reis'ul-Ulemaja

shfrytëzoi rastin për t'u takuar me xhamatlinjtë e këtij qyteti, me të cilët bisedoi për hallet dhe për nevojat e tyre.

Përshtypjet e delegacionit të BFI-së pas vizitës në këtë Myftini ishin se organizimi i jetës fetare në Myftininë e Manastirit po vazhdon zhvillimin e tij me hapa të sigurt dhe të shëndoshë, duke i tejkaluar të gjitha pengesat dhe peripeçitë e kohës. Reis'ul-Ulemaja në fund i falënderoi nikoqirët për mikpritjen dhe zemërgjerësinë, si dhe u dëshiroi shumë suksese në punë. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

INFORMIME TË NDËRSJELLA NË MYFTININË E STRUGËS

Më 23 shkurt, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, ka qëndruar në Myftininë e Strugës.

Me këtë rast, në Facebook ai ka shkruar:

"Patëm nderin të marrim pjesë në mbledhjen e parë të Myftinisë së BFI të RMV në Strugë, të udhëhequr nga Myftiu mr. Salim ef. Sulejmani, ku u bë konstituimi i anëtarëve të rinj të Myftinisë, si dhe u dha Raporti për punën dhe aktivitetet e Myftinisë gjatë vitit 2021. Në këtë mbledhje Myftiu informoi anëtarët e rinj të Myftinisë me aktivitetet dhe rezultatet e arritura gjatë vitit të kaluar, si dhe me synimet e saj në vitin 2022.

Në fjalën time përshëndeta Myftiun për ftesën dhe pritjen vëllazërore që na



bëri, si dhe u shprehëm urimet anëtarëve të rinj të Myftinisë, duke iu dëshiruar suksese në mandatin e besuar. Në të njëjtën kohë, informuam të pranishmit për rezultatet e arritura të BFI të RMV, si dhe për synimet e saj në të ardhmen. Më pas vizitua Xhaminë Qen-

dore të Strugës, ku falëm edhe namazin e drekës dhe me këtë përfundam këtë vizitë të rëndësishme. Në delegacion ishte edhe Sekretari i Përgjithshëm Irsal ef. Jakupi, Drejtori për Diasporë dr. Selver ef. Xhemaili dhe Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim ef. Iseni."

NË MBLEDHJEN E PARË TË MYFTINISË SË OHRIT



Më 23 shkurt, 2022, patëm nderin të marrim pjesë në mbledhjen e parë të Myftinisë së BFI të RMV në Ohër, të udhëhequr nga Myftiu h. Samet ef. Ajdari, ku u bë konstituimi i anëtarëve të rinj të Myftinisë, si dhe u dha Raporti për punën dhe aktivitetet e Myftinisë gjatë vitit 2021, ka njoftuar Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në faqen e vet në Facebook.

Në këtë mbledhje Myftiu informoi

anëtarët e rinj të Myftinisë me aktivitetet dhe rezultatet e arritura gjatë vitit të kaluar, si dhe me synimet e saj në vitin 2022.

Në fjalën time – thotë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu - përshëndeta Myftiun për ftesën dhe pritjen vëllazërore që na bëri, si dhe u shprehëm urimet anëtarëve të rinj të Myftinisë, duke iu dëshiruar suksese në mandatin e besuar.

Në të njëjtën kohë, informuam të pranishmit për rezultatet e arritura të BFI të

RMV, si dhe për synimet e saj në të ardhmen.

Më pastaj vizitua Xhaminë e bukur të Ali Pashës, ku falëm edhe namazin e iqindisë dhe me këtë përfundam këtë vizitë të rëndësishme.

Në delegacion ishte edhe Sekretari i Përgjithshëm Irsal ef. Jakupi, Drejtori për Diasporë dr. Selver ef. Xhemali dhe Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim ef. Iseni, ka njoftuar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

SUKSESE NË SHTIGJE TË REJA

Me ftesë të Myftiut të Kërçovës mr. Qamil ef. Rushiti, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 11 mars, 2022, mori pjesë në mbledhjen konstitutive të Myftinisë së BFI-Kërçovë, i shoqëruar nga Sekretari i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi, Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni dhe Drejtori për Shkencë dhe Kulturë Musanif ef. Rufati, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Ishte një mbledhje mirë e organizuar, me të gjitha tiparet serioze. Së pari Myftiu në fjalën e tij përshëndeti të pranishmit dhe dha një rezymë për zgjedhjet dhe më pastaj shpjegoi për aktivitetet e Myftinisë dhe sfidat me të cilat është ballafaquar.

Sekretari i Myftinisë, mr. Xhemal Ahmeti, shpjegoi në mënyrë të detajuar, përmes projektorit, për të arriturat gjatë vitit 2021, si dhe e paraqiti Propozimprojektit e aktiviteteteve për vitin 2022.



Arkëtarë i Myftinisë, z. Bejtullah ef. Baftiri, raportoi për çështjen financiare, si dhe për Propozimbuxhetin për vitin 2022.

Pas raportimeve, u verifikua mandati i anëtarëve të rinj dhe solemnisht u bënë ndarja e vendimeve.

Në fjalën e tij, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu përshëndeti Myftiun

dhe stafin e tij për ftesën dhe shprehu urime të sinqerta për kandidatët e rinj, duke iu dëshiruar suksese në mandatin e ri. Në të njëjtën kohë, Reis'ul-Ulemaja i informoi të pranishmit për rrjedhat në Bashkësinë Fetare Islame dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky institucion, thuhet në njoftimin e BFI-së.

MYFTINIA E SHKUPIT NË DEBATIN E CCG-së

Më 10 mars, 2022, Centre for Common Ground (Qendra për Bazë të Për-bashkët, CCG) ka organizuar në Shkup debatin “Dialog për ndërtimin e besimit ndërinstitucional”.

Nga Myftinia e Shkupit pjesëmarrës në të ka qenë mr. Nexhmi Ferati, Sekretar i Myftinisë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Shkup.

Dialogu për ndërtimin e besimit ndërinstitucional përfshin pushtetin lokal, policinë, institucionet arsimore, drejtuesit fetarë dhe përfaqësuesit e rinisë – e tëra kjo si pjesë e projektit “Fuqizimi i qëndrueshmërisë kundër ekstremizmit të dhunshëm të komuniteteve lokale në Maqedoni – Faza 2”.

Projekti ka për synim forcimin e zbatimit efektiv të strategjisë nacionale dhe të planit të veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në nivel lokal/komunal në Maqedoninë e Veriut, përmes mbështetjes teknike për



komunitetet dhe pjesëmarrësit nacional me qasje të lokalizuara për përballje me ekstremizmin e dhunshëm.

Ky projekt mbështetet nga Ambasada Britanike në Shkup, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

GAZMEND EF. TËRSTENA, IMAM I XHAMISË JAHJA PASHA

Më 11 mars, 2022, Sekretari mr. Nexhmi ef. Ferati, Referenti i vakëfit h. Fejsal ef. Kadriu dhe Referenti i xhematit dr. Fatmir ef. Zaimi nga Myftinia e BFI-Shkup vizituan xhematin e Xhamisë Jahja Pasha me rastin e autorizimit të Gazmend Tërstenës në detyrën Imam në këtë xhami, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Fjalën përshëndetëse në fillim e paraqiti dr. Fatmir ef. Zaimi. Nexhmi Fe-

rati e prezantoi hfz. Gazmend ef. Tërstenën para xhematit dhe në emër të Myftiut uroi Imamin e ri, duke i dëshiruar mbarësi në detyrën e tij dhe përmendi obligimet dhe të drejtat e nëpunësit fetar të autorizuar mbi bazë të Rregullores së Punës të Myftinisë së BFI-Shkup.

Ai mes tjerash vlerësoi dhe shprehu mirënjohje, në emër të Myftiut, për kontributin dhe shërbimin shumëvjeçar të

hfz. Halil ef. Selmanit, tashmë i pensionuar.

“Të gjithë dëshmojmë se hfz. Halil ef. Selmani ka dhënë kontribut të madh në shërbim të xhematit të Xhamisë së Jahja Pashës dhe të xhematit të Shkupit. I bëjmë lutje Allahut të Madhërisëm që ta shpërblejë me mirësitë e Tij të paku-fishme!” - u shpreh mr. Nexhmi ef. Ferati, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

KURANI FISNIK ME TITRA MAQEDONISHT

Për herë të parë Kurani fisnik me titra maqedonisht: Myftinia e BFI - Shkup ofron video-projektin “Kurani fisnik i titruar në gjuhën maqedonase”. Ky projekt me peshë dhe rëndësi të madhe, i pari në trevat tona për nga forma e realizimit, është vazhdimësi e përmbushjes së synimeve të Myftinisë së Shkupit ndaj besimtarëve të këtij nënqielli, ka njoftuar Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

Video-projekti “Kurani fisnik në gjuhën maqedonase” ofrohet në të njëjtin format të publikimit, i lexuar nga hfz. Xhemal ef. Nuhiju dhe i titruar në bazë të botimit “Përktimi i kuptimit të Kuranit famëlartë”, botuar në mars të vitit 2015.

Video-materiali do të lansohet në faqen zyrtare të Myftinisë së Shkupit në Facebook dhe në kanalën zyrtar në YouTube, ka njoftuar Myftiu i Myftinisë së Shkupit. (22.02.2022)

37. Господаре наш, дел од потомството мое го населив во долина една, неплодна, при Куката Твоја света, Господаре наш, за да извршуваат намаз. Одреди, тогаш, срцата човечки да стремат кон нив и снабди ги со благодатите за да се заблагодаруваат!

NË DITËN E MËSUESIT: DIJA, VLERË E SHENJTË

Me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka dalë me një mesazh urimi dhe me një shkrim rasti për arsimtarin e vet, personalitetin e lartë të sferës fetare islame, prof. Sherif Ahmetin (1920-1998).

RRUGA PËR NJOHJEN E ZOTIT: Dija është vlerë e shenjtë. Ajo dëshmon për lartësinë e njeriut në këtë botë. Hap rrugët e njohjes së Zotit dhe të krijimtarisë së Tij. Ajo bën të kuptosh qëllimin e ardhjes së njeriut në këtë botë, detyrat e jetës së tij dhe mënyra e përfundimit të jetës në këtë botë.

Bartës i kësaj është mësuesi, ai që shpjegon dhe inspiron mbi vlerën e dijes, nevojën e domosdoshme për të mësuar mbi Zotin, kombin, atdheun dhe vendosjen në shërbim të gjithçkajes në arritjen e qëllimeve fisnike të jetës në këtë botë.

Andaj, Dita e Mësuesit është vetëm një shënim modest për nga forma, por e madhe për nga përmbajtja, sepse ajo është inspirim i gjallë në ngritjen e vetëdijes mbi mësimin, studimin, hulumtimin për të ndryshuar botën drejt së mirës, drejt paqes dhe mirëqenies së gjinisë njerëzore.

Në emër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe në emrin tim, shprehim urime më të përzemërta për ditën e madhe të mësuesisë - 7 Marsin dhe: qofshin të bekuar bartësit e dijes dhe të arsimit. Zoti i bekoftë.

NJERIU QË NUK VDES KURRË: Gjatë shkollimit tim kam pasur fatin që të kem mësimdhënës të spikatur. Iu jam falënderues të gjithëve, por në kujtimet e mia mbetet përgjithmonë arsimtari im prof. Sherif Ahmeti, një personalitet i lartë i sferës fetare islame.

Pata fatin që ta kem profesor në Medresenë e Alauddinit në Prishtinë. Më ligjëronte Akaidin - apologjetikën islame. Njeri i spikatur, me njohuri të thella në sferën e Islamit, universal në njohuri të shkencave të ndryshme, i shkathët në debatet e kohës, i logjikshëm në dialog me të tjerët, tolerant në diversitetin e mendimeve, provokues në nxitjen e të menduarit logjik, i buzëqeshur dhe i lumtur në aftësitë e të tjerëve, i sigurt në ardhmërinë e vlerave islame, i ngritur në sferën e kulturës dhe të traditës, i dashuruar në rrugëtimin e kombit, i paluhatshëm në trasimin e mendimit të shëndoshë islam, i palodhshëm në fjalën e shkruar, të cilën e rezymoi me përkthimin e fjalës kuranore në gjuhën shqipe; i dashur te nxënësit, i thellë në qasjen e çështjeve fetare, respektabil ndaj të tjerëve, drejtues dhe strateg i madh i Medresesë.

Me një fjalë, mendimtar dhe kolos i mendimit islam në Ballkan dhe më gjerë.

I mbetemi borxh përgjithmonë. Sa herë që e kujtoj, gjej inspirim të gjallë drejt rrugëtimin tim në jetë.

Zoti i madhërisëm e bekoftë me Xhenetin e Tij të amshueshëm. (Mars, 2022)



Prof. Sherif Ahmeti



NËNË - KY EMËR I MADH

Nënë, ky emër i madh që i takon shpirtit dhe zemrës.

Fjala nuk është e aftë të përshkruajë këtë emër të madh. Vetëm i Madhi Zoti e definoi femrën në mënyrë hyjnore, duke i dhënë pozicionin e fëmijës, të vajzës, të bashkëshortes, të bazës së edukimit familjar dhe shoqëror.

Mbi të gjitha - i dha emrin nënë dhe e lidhi ngushtë me Madhërinë e Tij.

Bota një ditë ia ka kushtuar gruas, nënës, dhe ajo e ka emrin: Dita e 8 Marsit! Qoftë kjo datë moment për një besëdhënie të paluhatshme kujdesi të lartë ndaj nënës, gruas, femrës gjatë tërë jetës, në butësi e respekt, në barazi dhe të drejta, në edukim dhe profesionalizëm, në familje dhe shoqëri, sepse pa të nuk ka familje dhe pa familje nuk ka jetë.

Andaj, qoftë i bekuar çdo moment që i përkushtohet nënës. Dhe, mbajeni në zemër emrin Nënë, sepse ajo s'kërkon asgjë, përveç buzëqeshjes dhe lumturisë së fëmijëve të saj.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu

MYFTIU I SHKUPIT URON 7 MARSIN



"Kush ma mëson një shkronjë, bëhem rob i tij." (Aliu r.a.)

Në emër të Myftinisë së Shkupit, të ulemave e të hoxhallarëve të Shkupit dhe në emrin tim, uroj nga zemra të gjithë mësuesit dhe arsimdashësit me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, thuhet në urimin e dr. Qenan ef. Ismailit, Myfti i Myftinisë së BFI-Shkup.

Bazuar në fjalën e Zotit në Kuranin finisnik dhe në porositë profetike mbi vlerën

e dijes dhe shpërblimin që kanë dijetarët në edukimin e brezave, detyra e mësuesit është një mision dhe detyrë e shenjtë, por që duhet ta kryejmë së bashku.

Dashuria për Zotin, dashuria për fenë, dashuria për kombin janë të lidhura ngushtë me dashurinë për dijen dhe arsimin. Andaj sot kujtojmë, nderojmë dhe respektojmë sakrificën e mësimdhënësit. Vlerësojmë punën e tyre dhe iu njohim kontributin e përditshëm në edukimin e

shoqërisë.

Pafundësisht mirënjohës për mësuesit, për arsimtarët, profesorët, edukatorët dhe arsimdashësit që e bartën mbi shpatulla shkollimin e brezave.

Allahu e bekoftë dhe e shpërbleftë punën e mësuesve tanë!

Gëzuar 7 Marsin, Ditën e Mësuesit dhe të shkollës së parë shqipe! – thuhet në urimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit. (7.03.2022)

MIRËNJOHJE PËR NEXHAT BAKIUN

Më 11 mars, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në një vizitë vëllazërore z. Nexhat Bakiun, nga Shkupi (Medrese/FSHI), të cilin e uroi për daljen në pension. Nexhat Bakiu ia kushtoi tërë jetën Islamit, duke qenë në shërbim të Bashkësisë Fetare Islame dhe të institucioneve të saj, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Nexhat Bakiu ka qenë një kuadër me vlera të larta, i urtë, i moralshëm, komunikues, preciz në punë, profesionist i nivelit të lartë, i respektuar nga të gjithë, respektues ndaj të tjerëve dhe i lumtur që i shërbeu Islamit në çdo moment dhe si-

tuatë. Për këto arsye, Reis'ul-Ulemaja i shprehu falënderime në emër të Bashkësisë Fetare Islame për gjithë atë që ka kontribuar dhe për disponimin e tij që edhe në të ardhmen të jetë në shërbim aty ku e do nevoja.

Edhe z. Nexhat Bakiu u falënderua shumë për respektin që ka pasur në Bashkësinë Fetare Islame nga të gjithë, gjatë gjithë veprimtarisë së tij dhe shprehu gatishtërinë që në çdo moment të jetë në shërbim të interesave madhore.

Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, me nderime të larta i ndau mirënjohje për kontributin e dhënë në BFI dhe më gjerë.



TETOVA PËRFUNDON LIGJËRATAT JAVORE

Më 20 mars, 2022, në Xhaminë e lagjes Drenovec, u bë manifestimi i përfundimit të ligjëratave javore (nëntor 2021 - mars 2022), të organizuara nga imamët e Myftinisë së Tetovës, thuhet në njoftim.

Në këtë manifestim morën pjesë Myftiu i Tetovës, prof. dr. Qani Nesimi, punonjësit të Myftinisë dhe të gjithë hoxhallarët që kanë ligjëruar dhe lexuar gjatë periudhës nëntor 2021- mars 2022.

Pasi u fal namazi i jacisë, moderatori Abdusabur ef. Asani i përshëndeti të pranishmit. Programi, ndërkaq, filloi me një ashere të lexuar nga hfz. Bekim Havzija. Më pas vazhdoi me ligjëratën e mbajtur nga Myftiu i Tetovës, i cili falënderoi të gjithë ata që kanë kontribuar për realizimin e këtij aktiviteti, duke filluar nga moderatorët, ligjëruesit dhe shoqëruesit e tyre, Këshillat e xhamive dhe xhemati në përgjithësi.

Para përfundimit të programit u kënduan disa ilahi nga hafëzat Xhelil dhe Bekim Havzija.

Ndërkaq, në fund Myftiu i Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi, bëri ndarjen e mirënjohjeve për ligjëruesit, për lexuesit dhe për moderatorët.

Mirënjohje u ndanë për ligjëruesit (Imamë): Taxhedin ef. Iljazi (Xhamia e Madhe, Reçicë e Madhe), Muhamedxhemil ef. Hoxha (Drenovec), Emin ef. Mahmudi (Reçicë e Madhe), hfz. Amir ef. Asllani (Gam-Gam), Nuhi ef. Ganija (Gam-Gam), Zejnullah ef. Jusufi (Xhamia Arabati), Nasir ef. Xhemali (Çar-



shia e Epërme), hfz. Xheladin ef. Jusufi (Reçicë e Vogël), hfz. Bekim ef. Demiri (Dardania), hfz. Abdulbaki ef. Kasami (Xhamia e Pashës), hfz. Ekrem ef. Hasani, (Zhelinë), Jusuf ef. Zilbeari (Nerash), Enes ef. Alili (Odër), Hafezat ef. Dauti (Gajre),

Jusuf ef. Jakupi (Muhareme), Irfan ef. Emurlai (Kadi Çeshme).

Për lexuesit: hfz. Havzi ef. Ramadani, Imam në Xhaminë e Sahatit; Xhemal ef. Bilalli, Imam në Xhaminë e Re - Reçicë e Madhe; Qazim ef. Shabani, Imam në fshatin Saraqinë; Nuran ef. Havziu, Myezin në lagjen Drenovec; Kadri Ahmedi, Myezin në Xhaminë Eski; Armin ef. Shaqiri, Myezin në Xhaminë e Re - Reçicë e Madhe; Jonuz ef. Tahiri, Myezin në Xhaminë Muhareme; Venhar ef. Osmani, Myezin në Xhaminë Tabhane; Berat Ra-

madani, Myezin në Xhaminë e Dardanisë; hfz. Idriz ef. Osmani, Mualim dhe Muhafiz, Tetovë; hfz. Besir ef. Limani, fshati Çellopek i Ri; hfz. Ajdën ef. Jahja, student; hfz. Almir Murati, student, Tetovë; Hisen ef. Izeti, student, Sllatinë; hfz. Xhelil Havziu dhe hfz. Bekim Havziu, Drenovec; Abdullah ef. Limani, nxënësi, fshati Çellopek i Ri.

Për moderatorët: Abdusabur ef. Hasani, Imam në Xhaminë e Re, fshati Palçisht; Muhamedxhemil ef. Hoxha, Imam në Xhaminë e lagjes Drenovec; hfz. Bekim ef. Demiri, Imam në Xhaminë Dardania; hfz. Emir ef. Kasami, Imam në Xhaminë e Pashës; Irfan ef. Emurlai, Mualim në Xhaminë Kadi Çeshme - thuhet në njoftim, të shpërndarë në faqen personale të Myftiut të Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi. (Facebook, 21.03.2022)

DEKORATË PËR AKTIVISTIN FERIZ DERVISHI



Më 21 shkurt, 2022, në vizitë të BFI të RMV pritëm z. Feriz Dervishi, aktivistin e mirënjohur të çështjes kombëtare dhe fetare të trevave tona, në veçanti të Kumanovës me rrethinë, ka shkruar Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

Ishte një takim i ngrohtë dhe shumë i rëndësishëm - ka thënë ai dhe ka shtuar: Mençuria, aftësia dhe përvoja e z. Ferizit gjithmonë është e dobishme.

Ka qenë, është dhe do të ngelë njeri i popullit dhe i zhvillimeve pozitive në shoqëri.

Ka qenë gjithmonë personalitet që sa

herë që e ka dashtë nevoja, është vënë në shërbim të BFI të RMV, si dhe të jetës fetare, andaj vendosëm që sot, në shenjë mirënjohjeje, t'i ndajmë Dekoratën Ikre me emblemën e BFI. I bëjmë lutje Allahut fuqplotë që t'i japë shëndet dhe jetë të gjatë, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

NDIHMJA PËR XHEMATIN E XHAMISË LEJLETUL-KADER

Më 21 shkurt, 2022, Bashkësia Fetare Islame ka dalë me një njoftim në të cilin thuhet: Organizata humanitare HILAL, në kuadër të BFI-së të RMV, bëri shpërndarjen e veshjeve dimërore - donacion nga një firmë italiane. Ndihma i është dhënë xhematit të Xhamisë Lejletul-Kader në lagjen "Gjorçe-Petrov" të Shkupit.

Ditët në vijim do të bëjmë edhe donacione të tjera. Ishallah Allahu i gëzon të gjitha familjet, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Për këtë, një njoftim në rrjetin social Facebook kishte bërë edhe Kryetari i OH "Hilal", Fadil ef. Ramadani. Njoftimit ai i kishte bashkëngjitur edhe disa regjistrime audiovizive nga ndarja e ndihmave.



DISKUTOHEN PUNËT KOMUNALE

Më 1 mars, 2022, Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, realizoi një takim pune me drejtorin e NP "Higjiena Komunale" - Shkup, z. Zudi Enuzi Koka, thuhet në njoftimin publik.

Shfrytëzova këtë takim që ta uroj Drejtorin për detyrën e tij, ndërsa më pas diskutuam për shumë çështje që i ndërlidhin institucionet tona, ka deklaruar Myftiu pas takimit.

Jemi mirënjohës dhe falënderues për pritjen e ngrohtë, për vullnetin për punë dhe për gatishmërinë për bashkëpunim institucional në shërbim të besimtarëve, ka deklaruar Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

MIRËNJOHJE PËR HOXHALLARËT NË PENSION

Më 4 mars, 2022, me rastin e Ditës së Mësuesit - 7 Marsit, Myftinia e Tetovës organizoi një takim me hoxhallarët që tashmë janë në pension, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.

Myftiu prof. dr. Qani ef. Nesimi, në shenjë respekti, në emër të Myftinisë, të gjithë hoxhallarëve në pension u shpërndau nga një mirënjohje.

Hoxhallarët në pension që pranuan mirënjohje janë: Shaban ef. Hasani, ish-Imam në Xhaminë e fshatit Përshëfcë; Bajram ef. Hasani, ish-Imam në Xhaminë e fshatit Dëbërcë; mr. Nashit ef. Mustafa, ish-Profesor në FSHI; Nasir ef. Dauti, ish-Myezin në Xhaminë e fshatit Poroj; Vesel ef. Selimi, ish-Myezin në Xhaminë e fshatit Llërcë.



Në fund, Myftiu i Tetovës falënderoi hoxhallarët në pension dhe përkujtoi rolin dhe punën e tyre të kryer me nder, duke i

shërbyer gjithnjë popullit të këtyre trojeve, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Tetovë.

ALI ERBASH TAKON PRESIDENTEN E KOSOVËS

Prishtinë - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, ka pritur më 8 mars, 2022, Kryetarin e Bashkësisë Islame të Turqisë (Diyanet İşleri Başkanlığı), prof. dr. Ali ef. Erbash (Ali Erbaş), thuhet në njoftimin e BIK.

Myftiu Tërnavë i uroi mirëseardhje dr. Erbashit në Kosovë dhe e cilësoi këtë vizitë si shumë domethënëse për popullin e Kosovës, duke marrë parasysh të kaluarën historike të përbashkët ndërmjet dy popujve.

Myftiu Tërnavë e falënderoi Kryetarin Erbash për gjithë atë çfarë ka bërë Diyanet-i për Kosovën. Ali ef. Erbash, ndërkaq, tha se ndjehet i lumtur për realizimin e projekteve në bashkëpunim me Kryesinë e BIK-ut. Ai luti Zotin që punët të ecin mbarë dhe sipas planit të paraparë.

Gjatë kësaj vizite Myftiu Tërnavë dhe Kryetari Erbash zhvilluan një bisedë telefonike me Presidentin e Turqisë, z. Rexhep Tajip Erdoğan (Recep Tayyip Erdoğan), të cilin e njoftuan për së afërmi me mbarëvajtjen e punimeve në Xhaminë Qendrore të Prishtinës.

Më pas, të njëjtën ditë, Kryetari i Ba-



shkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, dhe Kryetari i Bashkësisë Islame të Turqisë, Ali ef. Erbash, u pritën në një takim nga Presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani.

Në takim - thuhet në njoftimin e BIK - është diskutuar për rolin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe të bashkësive të tjera në kultivimin e tolerancës fetare në

Kosovë. Presidentja Osmani ka theksuar se toleranca ndërfetare në Kosovë është vlerë e shquar e shoqërisë kosovare dhe ka nënvizuar rolin pozitiv të Bashkësive Fetare në këtë drejtim.

Gjatë takimit Presidentja Osmani u njoftua me projektet humanitare të mbështetura nga Dijaneti në Kosovë, thuhet në njoftimin e BIK.

DEPUTETI TURK MESTEN VIZITON BFI-në



Vazhdojnë vizitat zyrtare në Bashkësinë Fetare Islame të RMV. Më 11 mars, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në një vizitë në Rijaset deputetin e Parlamentit të Republikës së Turqisë, z. Osman Mesten, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, thuhet në njoftimin e BFI-së. Kreu i BFI-së me mysafirin nga Ankara bisedoi gjerë e gjatë, e falënderoi

roi për vizitën dhe e njoftoi me rrjedhat dhe aktivitetet e BFI të RMV, me bashkëpunimin e ndërsjellë me institucionet fetare të Dijanetit të Turqisë dhe më gjerë.

Njëherësh, folën edhe për sfidat me të cilat ballafaqohet BFI në organizimin e jetës fetare në vend, si dhe me përpjekjet e kamotshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të kohës së Perandorisë Osmane, ku me theks të veçantë biseduan

për rindërtimin e Xhamisë së Prilepit, si një simbol i veçantë, e cila sot e kësaj dite rri e djegur.

Reis'ul-Ulemaja mbeti i kënaqur me idetë e deputetit të nderuar, duke shprehur gatishtësinë për të dhënë kontribut aty ku ka nevojë. Atë e shoqëronte Atasheu për Çështje Fetare pranë Ambasadës së Turqisë në Shkup, z. Mustafa Mesten, thuhet në njoftimin e BFI-së.

NGA DIJANETI VIZITOJNË BFI-në DHE XHAMINË NË NDËRTIM

Më 17 mars, 2022, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në selinë e Rijasetit të BFI priti delegacionin nga Dijaneti i Republikës së Turqisë, të përbërë nga Mehmet Bilgin-Drejtor i Përgjithshëm për Çështje Administrative, Salih Gör-Shef i Sektorit Euroaziatik, Zeynel Abidin Akduman-Shef i Departamentit të Çështjeve Sociale dhe Çështjeve Fetare, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si mikpritës i delegacionit, shoqërohej nga bashkëpunëtorët e ngushtë të Rijasetit të BFI dhe nga Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

Në një atmosferë shumë të ngrohtë, të sinqertë dhe vëllazërore, Reis'ul-Ulema shprehu mirënjohjen e tij për vizitën e delegacionit të Dijanetit dhe theksoi se mes këtyre dy organizatave simotra tash e shumë vite ekziston një bashkëpunim i suksesshëm, duke theksuar mbështetjen për arsimimin e gjeneratave të reja myslimane nga pjesa lindore e RMV-së dhe zonat tjera në vend, duke punësuar zyrtarë fetarë nga Republika e Turqisë dhe Republika e Maqedonisë së Veriut.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu gjithashtu theksoi se ky bashkëpunim me institucione si Dijaneti, TIKA, Drejtoria e Përgjithshme e Drejtorisë së Vakëfeve dhe institucione të tjera Republikës së Turqisë, është shumë i natyreshëm, sepse vendi ynë dhe Turqia, u tha, janë dy vende të afërta, si dhe kemi gja-



shtë shekuj lidhje të përbashkëta historike.

I ftuari Mehmet Bilgin, i cili foli në emër të delegacionit, tha se i mirëpret marrëdhëniet e ngushta vëllazërore mes dy institucioneve dhe projektet e realizuara dhe beson se këto marrëdhënie do të forcohen edhe më tej në të ardhmen. Ai theksoi se është i vetëdijshëm për rolin e Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut në botë për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e jetës fetare të myslimanëve në këtë zonë, andaj Dijaneti i Republikës së Turqisë do të jetë gjithmonë i gatshëm që të japë kontributin dhe mbështetjen e vet.

Pas takimit, delegacioni i shoqëruar nga Reis'ul-Ulemaja dhe bashkëpunëtorët e tij vizituan xhaminë e re në lagjen e

Tophanës, në ndërtim, në komunën e Çairit, që financohet nga Dijaneti i Republikës së Turqisë.

Delegacioni nga Turqia do të marrë pjesë edhe në aktivitetin qendror që do të mbahet me rastin e Lejletul-Beratit në Xhaminë Ali Pasha në Ohër, thuhet në njoftimin e BFI.

Në faqen e vet në Facebook, të njëjtën ditë, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu ka shkruar: “(Për xhaminë e re në lagjen e Tophanës) Biseduam që puna në këtë projekt të madh të përshejtohet dhe sa më shpejt t'i afrohet përfundimit. Delegacioni në fjalë premtoi se me përmirësimin e kushteve do të punohet intensivisht. Falënderuam për vizitën dhe interesimin e tyre për zhvillimin e punëve. Zoti i bekoftë.”

ATASHEU MESTEN NË FSHI

Dekani i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup, prof. dr. Shaban Sulejmani, priti për vizitë pune Atasheun për Çështje Fetare të Republikës së Turqisë, z. Mustafa Mesten, thuhet në njoftimin e FSHI.

Me këtë rast, Dekani prof. dr. Shaban Sulejmani e informoi Atasheun për punën e FSHI, për zhvillimin e mësimin, për programet mësimore të akredituara dhe për zhvillimin e aktiviteteve të tjera në kuadër të FSHI-së.

Atasheu Mustafa Mesten falënderoi Dekanin për pritjen e organizuar dhe e ftoi për bashkërenditjen e aktiviteteve dhe bashkëpunimin me fakultetet simotra në Republikën e Turqisë.

Dekani i FSHI prof. dr. Shaban Sulejmani falënderoi Atasheun Mustafa Mesten për vizitën në FSHI dhe e ftoi për një bashkëpunim të ndërsjellë dhe me interes për të dyja institucionet: FSHI-në dhe Ambasadën e Republikës së Turqisë në Shkup, thuhet në njoftimin e FSHI. (22.02.2022)



HOLOKAUSTI, TRISHTIM QË KURRË S'HARROHET

Me ftesë të Kryetarit të Bashkësisë Hebraike të RMV, z. Pepo Levi, më 10 mars, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori pjesë në përkujtimin e Holokaustit, të zhdukjes së mbi 6 milionë hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore (mbi 7.000 nga Maqedonia e Veriut) nga nazizmi famëkeq hitlerian, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Pjesëmarrja e Kryetarit të BFI të RMV ishte në përkrahje të paqes e të tolerancës, si dhe mesazh kundër luftës dhe gjenocideve në botë, në veçanti në Ballkan, si: të atij të Srebrenicës në BeH, të Reçakut në Kosovë dhe të shumë masakrave të tjera në botë.

Gjenocide të këtilla nuk guxojnë t'i ndodhin asnjë populli në botë, pa marrë parasysh kombin, besimin, racën apo vendin, sepse njeriu është vepra më madhështore e Zotit dhe çdo atak kundër nderit dhe jetës së njeriut, është atak kundër vullnetit të Zotit, thuhet në njoftim.

Në këtë përkujtim Reis'ul-Ulemanë e shoqëronin Sekretari i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi dhe Drejtori i Agjencisë për Stan-



dardhin Hallall h. Muhamer ef. Veseli.

Në Qendrën Memoriale të Holokaustit të Hebrenjve në RMV, në Shkup, prezent ishin pjesëmarrës nga të gjitha institucionet fetare, politike, Presidenti Pendarovski, Kryeministri Kovačevski, Ambasadorja e SHBA Kejt M. Bërns (Kate M. Byrnes), Drejtori i ITKSHSH dr. Skender Hasani e të tjerë, thuhet në njoftimin e BFI-së.

MAJA SUSA PROMOVON LIBRIN "FISNIKËT NDËR POPUJ"

Më 14 mars, 2022, në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup (ITSHKSH) është promovuar një libër për njerëzit nga Republika e Maqedonisë së Veriut që u kanë dalë zot hebrenjve gjatë Holokaustit. Libri titullohet Македонските "праведници меѓу народите" ("Fisnikët ndër popuj", Maqedoni), ndërsa autore e tij është Maja Susha, Udhëheqëse e Departamentit për Edukim dhe Hulumtim të Holokaustit në ITSHKSH. Anglisht, "Righteous Among the Nations" është term që shfrytëzohet nga shteti i Izraelit për t'i përshkruar jehobenjtë që kanë rrezikuar jetën e tyre për të shpëtuar hebrenj gjatë Holokaustit.

Në promovim mori pjesë edhe Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI-së.

Në këtë libër flitet për njerëzit që janë sjellë drejtas, me fisnikëri, ndaj hebrenjve në territorin e Maqedonisë së Veriut gjatë Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht për shpëtimtarët e jetës së hebrenjve, të cilët kanë marrë edhe mirënjohje nga ana e shtetit të Izraelit.

Autorja e librit, Maja Susha, tha se ky është projekt afatgjatë, i realizuar përmes hulumtimeve të shumta nëpër arkivat vendorë dhe izraelit dhe vjen në këtë formë pas mbrojtjes publike si tezë magjistrature në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup.

Skender Asani, Drejtor i ITSHKSH, tha se ky libër i Maja Sushës është shprehje e guximit për të shëruar plagët e së kaluarës, por edhe për të diagnostikuar



deformimet që mund të shfaqen në shoqërinë tonë.

Në promovim morën pjesë edhe Ambasadorja e Britanisë së Madhe, zonja Rachel Galloway; Ambasadori i Austrisë, dr. Georg Woutsas; Ambasadori i Republikës së Shqipërisë, Fatos Reka; Ambasadorja e Shtetit të Izraelit në Maqedoninë e Veriut, Simone Frankel; Kryetari i Bashkësisë Hebraike në Maqedoninë e Veriut, Pepo Levi, pastaj atashë dhe përfaqësues të ambasadave etj., thuhet në njoftimin e BFI-së.

"Përmes krahasimit, analizës, sinkronizimit dhe aktualizimit të materialit të disponueshëm, jam përpjekur të shkruaj një vepër unike, fokusi i së cilës është orientuar drejt atyre heronjve që kanë marrë titullin 'Fisnikë ndër popuj', e ata janë: Todor e Pandora Haxhi Mitkov, Trajko e Dragica Ribarevi, Boris e Vaska Alltiparmak, Aleksandar e Bllaga Todorovi, Stojan Bogoja Siljanovski, si dhe Smiljan Franjo Çekada", precizoi Maja Susha, duke potencuar rolin historik, heroizmin dhe humanizmin e tyre gjatë Holokaustit,

thuhet në njoftimin e ITSHKSH. Sipas Institutit, libri së shpejti pritet të përkthehet dhe të botohet edhe në gjuhën shqipe dhe angleze.

Libri, thuhet në njoftimin e Ambasadës Shqiptare në Shkup, është botuar në përkujtim të deportimit të 7.444 hebrenjve nga Shkupi drejt kampeve të shfarosjes naziste gjatë Luftës së Dytë Botërore. Promovimi kishte për qëllim dhe i bëri jehonë edhe bashkëjetesës fetare në zbutjen e ndasive përmes pjesëmarrjes së Kreut të BFI të RMV, Reis Shaqir Fetahu, si dhe të Kryetarit të Komunitetit Hebraik të Maqedonisë së Veriut, Pepo Levi. Po ashtu, ishin të pranishëm personalitete të jetës akademike, përfaqësues të trupit diplomatik dhe të mediave në vend, thuhet në njoftimin e Ambasadës Shqiptare në Shkup. Ky njoftim ishte shpërndarë edhe nga Drejtori Skender Asani në faqen e tij personale në Facebook. Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, të njëjtën ditë, po ashtu kishte dalë me një njoftim në faqen e vet personale në rrjetin social.

TRASHËGIMIA POPULLORE NË KULTURËN ISLAME

Më 12 mars, 2022, Myftinia e KMSH-Shkodër organizoi Seminarin e 10-të trajnuës me pjesëmarrjen e një grupi imamësh të xhamive të qytetit dhe të fshatrave. Mernin pjesë Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, Myftiu i Malësisë së Madhe, h. Edmir Smajlaj, si dhe i ftuari special, si ligjërues, Kryeimami i Bashkësisë Islame të Ulqinit, Ali ef. Bardhi, thuhet në njoftimin e Myftinisë Shkodër.

Tema e këtij seminari ishte "Rëndësia e studimit të trashëgimisë popullore në kulturën islame". Në të, përveç tjerash, mr. Ali Bardhi, tha: "Kurani famëlartë dhe praktika profetike janë burim dhe frymëzim për të hulumtuar dhe studiuar edhe për trashëgiminë shekul-

lore, për të kaluarën e popujve të hershëm në aspekt të besimit, të adhurimit, të moralit etj., si dhe për kulturën islame në përgjithësi."

Kryeimami i Ulqinit u fokusua tek puna e tij disavjeçare për evidentimin, regjistrimin dhe studimin e varrezave myslimane dhe shqiptare në zonat shqiptare në Mal të Zi. Vlen të theksohet se falë këtij përkushtimi të pashembullt, sot janë botuar tre vëllime të rëndësishme, ku është regjistruar historia dhe gjurma e shqiptarëve myslimanë ndër shekuj në këto zona.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në kuadër të kësaj teme theksoi: "Është shumë e rëndësishme mbledhja e folklorit dhe e trashëgimisë sonë

islame në zonat shqiptare. Ne kemi një pasuri shumë të madhe, e cila duhet të jetë pjesë e librave tona. Ju ftoj të ktheheni tek 'Fjalori i Orientalizmave' i Tahir bej Dizdarit, ku në të do të gjejmë trashëgiminë tonë në të folmen e përditshme. Është shumë i rëndësishëm evidentimi i gjurmëve tona, të cilat duhen ruajtur dhe përhapur në masë, si pjesë e trashëgimisë dhe e identitetit tonë kombëtar.

Gjykoj se është obligim për bashkësitë tona islame që të vlerësojnë këtë trashëgimi dhe të punohet edhe më shumë në drejtim të regjistrimit të këtyre dëshmimeve dhe gjurmëve shekullore, që për ne janë trashëgimia dhe historia islame në trojet tona shqiptare."



Më 26 shkurt, 2022, morëm pjesë në mbledhjen konstituive të Myftinisë së BFI-Gostivar, nën udhëheqjen e Myftiut h. Sabahudin ef. Zendeli. Në shoqërim të Sekretarit të Përgjithshëm z. Irsal ef. Jakupi, anëtarëve të rinj solemnisht u ndamë vendimet e BFI të RMV, duke iu uruar mandatin e ri dhe përgjegjësitë që kanë. Falënderuam po ashtu edhe anëtarët e mandatit paraprak për punën që kanë bërë, me lutje Allahut Fuqiptotë që t'i shpërblejë me shpërblimet e Tij të pakufishme. Më pas, Myftiu me referentët e tij raportoi për punën dhe aktivitetet e vitit 2021, si dhe miratimin e Propozimbuxhetit të vitit 2022. U bisedua dhe u dhanë mendime dhe sugjerime të ndryshme. Uroj rezultate pozitive dhe Allahu i bekoftë, ka shkruar Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në faqen e vet në Facebook.

KURANI NGA SHERIF AHMETI DO TË REDAKTOHET

Këto ditë në Arabinë Saudite po qëndron një delegacion i Bashkësisë Islame të Kosovës, respektivisht Komisioni për Redaktimin e Përkthimit të Kuranit në Gjuhën Shqipe prej haxhi Sherif Ahmetit, thuhet në njoftimin e BIK.

Kjo vizitë e Komisionit të BIK-ut po ndodh në kuadër të Marrëveshjes për bashkëpunim, e nënshkruar prej ministrit të Vakëfit dhe Çështjeve Islame të Arabisë Saudite, Abdul-Latif Al Sheikh dhe myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavës.

Me këtë rast Delegacioni kosovar në përbërje të Sabri Bajgorës-kryetar, Vedat Sahitit, Besim Mehmetit, Bashkim Mehanit dhe Besnik Jahës-anëtarë, ka vizituar Kompleksin dhe shtypshkronjën e Kuranit në Medinë, ku është pritur prej drejtuesve të tyre, prej Sekretarit të Përgjithshëm të Kompleksit të Mbretit Fehd për Botimin e Kuranit, Talal bin Razan Er Ruhejli, si dhe ka zhvilluar takime konsultative pune me dy grupe punuese në kuadër të institucionit: grupin shkencor për çështje fetare dhe grupin për përgatitje teknike. Në secilin nga takimet u



nxorën përfundime konkrete të bashkëpunimit, e të cilat do të reflektojnë në projekte konkrete e në dobi të besimtarëve myslimanë shqiptarë gjithandej nëpër botë, thuhet në njoftimin e BIK. (16.03.2022)

ME ÇMIM TË PARË NË STAMBOLL



Në datat 7-11 mars, 2022, në Stamboll është mbajtur "Java e botimeve ndërkombëtare", një takim i botuesve të më shumë se 65 vendeve të botës, ku kanë marrë pjesë mbi 365 botues. Në këtë javë kulturore, e cila organizohet për të shtatin vit me radhë nën kujdesin e Ministrisë së Kulturës dhe të Turizmit të Republikës së Turqisë dhe të Shoqatës Turke të Shtypit dhe të Botimit, pjesëmarrës ka qenë edhe SHB "Logos-A" nga Shkup, thuhet në njoftimin e këtij botuesi.

Në kuadër të kësaj ngjarjeje, ku botuesit realizojnë takime, i prezantojnë botimet dhe autorët e tyre para botuesve të tjerë, si dhe lidhin marrëdhënie të reja

mes vete, janë ndarë edhe disa çmime prestigjioze, siç është edhe çmimi që vlerëson botimet e përkthyer nga gjuhët e huaja, e veçmas ato nga gjuha turke.

Në mesin e gjithë atyre botuesve anekënd botës, SHB "Logos-A" është nderuar me çmimin e parë, në vendin e dytë është renditur shtëpia botuese libaneze "Arab Scientific" nga Libani, ndërsa në vendin e tretë "Alemak" nga Ukraina.

Çmimin e dorëzoi vetë ministri i Kulturës dhe Turizmit i Republikës së Turqisë, Mehmet Nuri Ersoy, ndërsa në ceremoninë e ndarjeve të çmimeve mori pjesë edhe historiani i njohur turk, një autor i përthyer edhe në shqip nga "Logos-A", prof. dr. Ilber Ortayli.

Pranimin e çmimit e bëri vetë drejtori i SHB "Logos-A", prof. Adnan Ismaili, duke e cilësuar atë si mirënjohje prestigjioze në 32-vjetorin e veprimtarisë botuese. Prof. Ilber Ortayli me këtë rast theksoi: "Interferimet kulturore turko-shqiptare, që sot po i vlerësojmë me këtë çmim, në të vërtetë janë shumë më të hershme dhe datojnë që nga koha e Sami Frashërit, i cili është autori i dramës 'Besë' dhe i romanit 'Dashuria e Talatit me Fitneten' në gjuhën osmane, ndërsa është edhe themeluesi i gjuhës moderne turke me 'Fjalorin e turqishtes'", thuhet në njoftimin e SHB "Logos-A" nga Shkup. (10.03.2022)

FOTOREPORTAZH



URON Kryetari e BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu: "Në natën e 27-të të muajit Rexheb ndodhi mrekullia e Israsë - udhëtimi i Muhamedit (a. s.) me ndihmën e Allahut fuqiplotë nga Mesxhidi Haram, në Mekë, deri në Mesxhidi Aksa, në Jerusalem, gjatë një pjese të natës, dhe prej aty u ngrit në qiejtë më të lartë, në Sidrei Munteha. Ishte ndihmë dhe përkrahje për Muhamedin (a. s.) mu në momentet më të vështira fizike e shpirtërore në misionin e tij hyjnor për të udhëzuar njerëzimin në rrugën e drejtë. Në këtë natë Muhamedi (a. s.) pati dhuratë të shumta, e në veçanti ishte obligimi i detyrueshëm i faljes se pesë kohëve të namazit - lidhje kjo më e fuqishme me Krijuesin. Në emër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe në emrin tim, u shpreh urime të thella të gjithë besimtarëve kudo që jetojnë dhe veprojnë, duke iu lutur Allahut fuqiplotë që këtë ndodhi të madhe ta kuptojmë si inspirim drejt ngritjes së vetëdijes për të jetuar sipas parimeve të shenjta, për të qenë të përkushtuar për vepra të mira, për paqe, për afrim mes vete dhe për të qenë bartës të vërtetë të vlerave islame në përgjithësi. Zoti ju bekoftë në këtë Natë të Madhe të Israsë dhe të Miraxhit." (27.02.2022)

Bashkësia Fetare Islame e RMV në Kumanovë organizoi Panel shkencor me temë "Israja dhe Miraxhi - porosi dhe aktualitet bashkëkohor". Panelistë ishin: prof. dr. Fahrudin ef. Ebibi, ish-Dekan i Fakultetit të FSHI dhe ligjërues aktual në të dhe dr. Islam ef. Islami, ligjërues në SHMI "Medreseja Isa Beu" - Shkup. Panelin shkencor e përshëndetën Kryetari e BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe Myftiu i Myftinisë së Kumanovës, Abedin ef. Imeri. "Ishte një organizim i mrekullueshëm dhe ambient imponant me qindra pjesëmarrës të sferave të ndryshme. Falënderojmë Myftininë e Kumanovës për pritjen vëllazërore, organizim të mirëfilltë dhe ambient të mrekullueshëm. Zoti i bekoftë", ka shkruar Kryetari e BFI të RMV në faqen e vet në Facebook. Në platformën elektronike të BFI, në kohë reale, Paneli shkencor ishte transmetuar drejtpërdrejt më 26 shkurt, 2022. Një ditë më vonë, më 27 shkurt, Paneli shkencor ishte dhënë edhe përmes TV IKRE të BFI të RMV. (26.02.2022)



Më 27 shkurt, 2022, në Filarmoninë e RMV në Shkup është mbajtur një manifestim kushtuar Israsë dhe Miraxhit. "Me ftesë të Partisë Demokratike Turke", ka shkruar Kryetari e BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në faqen e vet në Facebook, "morëm pjesë në manifestimin ku si mysafir dhe ligjërues ishte shkrimtari, poeti dhe letrari i mirënjohur me renome botërore nga Turqia, z. Hajati İnanç (Hayati İnanç), i cili ka mbajtur mbi një mijë ligjëratë nëpër shumë vende të botës me një stil të veçantë letrar dhe poetik. Ai përshkroi dashurinë e shprehur në poezinë turke ndaj Muhamedit (a. s.), si dhe në mënyrë letrare përshkroi Isranë dhe Miraxhin. La një përshtypje të veçantë të të pranishmit. I shoqëruar me z. İrsal ef. Jakupi, mr. Nasir ef. Rexhepi, h. Sabahudin ef. Zendeli, mr. Eljesa ef. Hasani, dr. Mumin Omer, z. Nizam Reshit e të tjerë, falënderuam Kryetarin e PDT (TDP) dr. Bejxhan Iljas dhe bashkëpunëtorët e tij për organizimin e mirë, si dhe për pritjen e ngrohtë që na bënë. Zoti i bekoftë."

PARALELET E VAJZAVE SHKUP, TETOVË, GOSTIVAR: Më 25 shkurt, 2022, në Xhaminë e Mustafa Pashës në Shkup u organizua manifestimi kushtuar Israsë dhe Miraxhit. Manifestimi u organizua nën patronazhin e Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe të Kryetarit të saj, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, kanë njoftuar Medreseja Isa Beu dhe BFI. Programi filloi me një asherë nga Kurani famëlartë, ndërsa nuk munguan edhe ilahitë dhe poezitë që u kënduan nga nxënëset e të tri paraleleve. Administratorja e Paraleles së Vajzave në Tetovë, prof. Barije Shabani, foli për rëndësinë që ka Israja dhe Miraxhi te myslimanët. Administratorja e Paraleles së Vajzave në Shkup, prof. Nurten Shehu Sakipi, u ndal te domethënia, rëndësia, roli dhe urtësitë e Israsë dhe të Miraxhit në Islam. Në fund, ky aktivitet u përmbyll me një asherë kuranore, ndërsa duanë me rastin e këtij manifestimi e bëri profesoresha e Medresesë Isa Beu - Paralelja e Gostivarit, Lindita Abazi.






ISRAJA DHE MIRAXHI NË ESKI-XHAMINË E TETOVËS:
Para xhemitit u prezantua një program fetaro-kulturor nga disa nxënës të medresesë "Isa Beu", studentë të FSHI dhe myezinit të Eski-Xhamisë, Kadri Ahmeti, udhëhequr nga Referenti për kulturë pranë Myftinisë së Tetovës, dr. Hysein ef. Rizai. Programi filloi me lexim të Kuranit famëlartë dhe vazhdoi me ilahi dhe kaside. Mbi vlerën e Natës së Israsë dhe të Miraxhit foli Myftiu i Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi. Në fund, u lexuan disa ajete nga hafëzi i mirënjohut hfz. Idriz ef. Osmani. (27.02.2022)

Manifestimin qendror me rastin e Israsë dhe të Miraxhit Myftinia e Shkupit e ka mbajtur në Xhaminë e fshatit Straçincë, më 27 shkurt, 2022. Ligjërues ka qenë hfz. Irfan ef. Abazi. Programi ka përbajtur: ligjërata, Kuran dhe ilahi. "Shprehim mirënjohje për të gjithë hoxhallarët dhe besimtarët e Shkupit që po vazhdojnë ta mbajnë gjallë përkujtimin dhe vlerën e kësaj nate të bekuar", ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, pas kthimit nga Zvicra, ku kishte marrë pjesë në shënimin e 30-vjetorit të Xhamisë Shqiptare në St. Gallen.



Myftinia e Manastirit, me rastin e natës së bekuar të Israsë dhe të Miraxhit, më 27 shkurt, 2022, organizoi një program të begatë me lexim të Kuranit famëlartë, ligjërata, ilahi dhe lutje. Programin e hapi me lexim të disa ajeteve Jusuf Arslani, ndërsa atë e udhëhoqi Imami Evdal Musoski. Myftiu i Manastirit, Amit Rasimi, mbajti fjalimin e rastit, kurse ligjërues të kësaj nate ishin Sekretari i Myftinisë, Orhan Demi dhe Imami i Xhamisë Hajdar Kadi, mr. Xhavit Ramadan. Myftiu i Manastirit, i shoqëruar nga Imami Vebi Klenja, ndan mirënjohje për disa xhematlinj që kanë dhënë kontribut në Myftininë e Manastirit dhe, në fund, Imami i fshatit Këshavë, Setmir Xhemaili, lexoi disa ajete nga Kurani famëlartë. Duanë e bëri Imami i fshatit Mexhitli Bekim Kamberi. Një ditë më parë, më 26 shkurt, u realizua manifestimi për Isranë dhe Miraxhin në Xhaminë e fshatit Këshavë për gjininë femërore – kanë njoftuar Myftinia e Manastirit dhe Myftiu Amit Rasimi në faqet e tyre në Facebook.

Manifestimi qendror i Myftinisë së BFI-Prilep, në nderim të Israsë dhe të Miraxhit, është mbajtur më 27 shkurt, 2022, në Xhaminë e fshatit Alldancë. Programi ka qenë me përbajtje nga Kurani, me ilahije dhe ligjërata – thuhet në profilin e Myftiut të Myftinisë së Prilepit, Shefket ef. Imeri, në rrjetin social.



"Në përkujtim të mrekullisë së Israsë dhe të Miraxhit" – është titulluar manifestimi i Myftinisë së Ohrit që është mbajtur më 27 shkurt, 2022, në Xhaminë e Ali Pashës. "Paqja, mëshira, mirësitë dhe begatitë e Zotit qofshin gjithmonë mbi ju", kanë thënë nga Myftinia e BFI-Ohër.



Manifestim për Isranë dhe Miraxhin në xhaminë "Salahudin Ejubi" në Labunisht (Strugë), më 27 shkurt, 2022: Programi, i moderuar nga Musa ef. Biba, filloi me lexim të një pjese të Kuranit nga hfz. Arifon ef. Zeqiri. Pastaj fjalë përshëndetëse pati Imami i Xhamisë, Sezair ef. Saloski. Manifestimi u zbukurua me leximin e pjesëve të Mevludit nga Myftiu i Strugës mr. Salim ef. Sulejmani, Xheladin ef. Maksutovski dhe Demir ef. Ravmanoski. Pjesë e këtij programi ishin edhe ilahitë e kënduara nga Imami i fshatit Labunisht, Xheladin ef. Maksutovski dhe nxënësi i Xhamisë, Nihat Juskoski. Ligjërata e kësaj mbrëmje u mbajt nga Imami i xhamisë "Mehmet Ali Pasha", Nexhat ef. Rustemoski. Programi u përmbyll me një pjesë Kurani nga Kadir ef. Daliposki, ndërsa duaja u bë nga Imami i Xhamisë Qendrore të fshatit Veleshtë, Abdulkadri ef. Sheji – thuhet në njoftimin e Myftinisë së Strugës.



Xhamia "Hëna e Re" në Kreuzlingen (Zvicër) ka organizuar një tribunë me rastin e Israsë dhe të Miraxhit. Mysafir ka qenë hoxha i nderuar Halil ef. Ademi, Imam në xhaminë "Tulipan" të Reinachut. "E falënderojmë Hoxhën për kohën që ka ndarë, bashkë me xhematit e vet, si dhe me Imamin veteran në Zvicër, Servet ef. Bajrami! Allahu i shpërbleftë me të mirat e Tij të pafund! Po ashtu, i falënderojmë edhe xhematlinjtë tanë, të cilët pos që ishin prezentë, me vete kishin sjellë edhe shumë ëmbëlsira. Allahu Bujar ua shtoftë bereqetin dhe të mirat e të dyja botëve", ka shkruar xhamia "Hëna e Re" në Kreuzlingen në faqen e vet në Facebook (27.02.2022).

Në Xhaminë Ebu Hanife të Grenchenit (Zvicër) është mbajtur një tribunë kushtuar Israsë dhe Miraxhit. Në të kanë folur: dr. Bashkim ef. Aliu, Imam në Xhaminë Shqiptare të Seebachut - Zürich; hfz. Abdyrrahim ef. Sylejmani, Imam në BI "Ebu Hanife", Grenchen. Porositë dhe këshillat qofshin udhëzim për mbarë ummetin; lutjet qofshin të pranuar tek Allahu fuqiplotë – ka shkruar Kryesia e BI "Ebu Hanife" Grenchen - Zvicër. (26.02.2022)





Xhamia Lozanë (Cicra), në Zvicër, ka organizuar më 26 shkurt, 2022, një tribunë fetare në përkujtim të Israsë dhe të Miraxhit. "Një falënderim i veçantë për Imamin dhe drejtuesin e Qendrës Religjioze për Kulturë dhe Integrim të Lozanës, mr. Fehim Abazi, si dhe për stafin e tij të mrekullueshëm, për mikpritjen e ngrohtë dhe organizimim e jashtëzakonshëm. Isha i nderuar që isha pjesë e këtij paneli të mrekullueshëm në shoqëri të Imam Bekim Alimit dhe Rijad Aliut. Një atmosferë imponante, të cilën na e dhuroi numri i madh i bashkatdhetarëve tanë në Lozanë dhe rajonet e ndryshme nga Zvicra", ka shkruar Imam Nehat V. Ismaili në faqen e vet në Facebook.

Më 26 shkurt, 2022, në xhaminë "IKRE-LEKO-LESEN", në Rorschach (Zvicër), është mbajtur tribuna "Reflektimet shpirtërore në natën e Israsë dhe të Miraxhit". Ligjërues ka qenë mr. Mixhit ef. Osmani, Imam në Xhaminë e Salmsach-ut. Përveç kësaj, ka pasur lexime nga Kurani dhe ilahi, ndërsa moderator ka qenë Imami i Xhamisë, Burim ef. Sherifi - ka njoftuar Xhamia në Rorschach. "Ishte një natë e frytshme, me një mikëpritje vëllazërore", ka shkruar hoxhë Mixhit ef. Osmani në Facebook.



Më 26 shkurt, 2022, për mrekullinë e Israsë dhe të Miraxhit është mbajtur një manifestim në Qendrën Kulturorë Shqiptare në Vjenë. "Mbrëmjen e zbukuroi prezenca e mikut të Qendrës sonë, efendi Adnan Skenderi, i cili foli para një numri të konsiderueshëm të xhemaltinjve. Kisha kënaqësinë që të prezantoj historikun e Kudusi - Sherifit (Jerusalem), vendin e Israsë, kiblen e parë të myslimanëve, të vendit prej ku u ngrit për në Miraxh Resulullahu (s.a.v.s.)", ka njoftuar hoxhë Usam Alimi nga Qendra Kulturorë Shqiptare -Vjenë.



VELIU E GAZMENDI NË NATËN E MIRAXHIT: Shoku im i nderuar dr. Xhevdet Ukalli, sonte është Nata e Miraxhit. Këtë natë të madhe më duhet ta pres vetëm dhe me lot në sy; sepse, para 6 muajve e përçolla djalin tim Veliun, hoxhën, në jetën e varreve dhe pas tij e përçollëm edhe djalin tënd, Gazmendin (viktimë e autobusit të djegur në Bullgari-Red.). Ti u bëre për rahmet dhe nuk e provove zjarrin që të shkakton humbja e djalit, kurse mua zjarri vazhdon të ma djegë shpirtin. Ti me djalin tënd jeni të bashkuar te varret, kurse unë do të vazhdoj t'i lutem të Madhit Zot që sa më shpejt t'i bashkohem djalit tim, Veliut. (dr. Veli Veliu, Kërçovë, Facebook, 26.02.2022)



TELEGRAM URIMI PËR 26-VJETORIN E TV FESTA



Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, me rastin e 26-vjetorit të TV Festa, Kumanovë, i dërgoi një telegram urimi pronarit dhe themeluesit të këtij televizioni z. Nexhat Aqifi dhe stafit që ai udhëheq.

Në vazhdim është Telegrami: I nderuar z. Nexhat Aqifi. Kam kënaqësinë që në emrin tim personal dhe në emër të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut t'ju uroj Juve dhe stafit të Televizionit Festa 26-vjetorin e themelimit.

Përvjetorët shpeshherë i festojmë për të na kujtuar vitet, brenda të cilave janë ditët, orët e sekondat të cilat për një televizion, përveç se janë punë e palodhshme, janë edhe krenari - si për stafin, ashtu edhe për auditorin, shikuesit.

TV Festa që nga starti kontribuoi në pasurimin e jetës mediatike në vendin tonë dhe gjithmonë ishte zëri i të vërtetës, zëri i fakteve dhe i argumentit, zëri i promovimit të vlerave tradicionale, vlerave demokratike dhe evropiane.

Bashkësia Fetare Islame e RMV gjithmonë e ka pasur derën e hapur në me-

dien tuaj, duke filluar nga ju personalisht, e deri te stafi i TV tuaj, andaj ju jemi mirënjohës dhe falënderues për gjithë bashkëpunimin ndër vite dhe ju dëshirojmë që me sukses e dinjitet të vazhdoni të jeni zëri i qytetarëve edhe në të ardhmen, sepse vetë ekzistenca juaj si TV Festa ka një rëndësi të jashtëzakonshme në shprehjen e mendimit të lirë në vendin tonë.

Urime edhe një herë 26-vjetorin dhe ju dëshiroj suksese të mëtejshme.

Me respekt, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (22.03.2022)

RIBOTOHET TEXHVIDI



Doli nga shtypi doracaku "Rregullat e Texhvidit, doracak për fillestarë", ka shkruar në faqen e vet në Facebook prof. Faredin Ebibi.

Më tej autori thotë: Ky është botim i tretë, i cili vjen si rezultat i kërkesës dhe nevojës së atyre që kanë nevojë për t'i mësuar rregullat e drejtëleximit të Fjalës së shenjtë - të Kuranit fisnik.

Është i lehtë, ngase është punuar në atë mënyrë që u përshtatet fillestarëve.

Krahas rregullave teorike, ka edhe disa shpjegime të natyrës juridike islame.

Këto udhëzime janë të rëndësishme dhe të dobishme për çdo lexues të Kuranit të shenjtë. Uroj të jetë literaturë e dobishme dhe e vyeshme për secilin që do ta vë në përdorim, ka shkruar prof. Faredin Ebibi. (9.03.2022)



Më 4 mars, 2022, në rrjetet sociale ka qarkulluar kjo fotografi, ku shihet një fëmijë 4-vjeçar, i cili është shpërngulur i vetëm në shkretëtirë nga Siria në Jordani. Atë e ka takuar ekipi i UNHCR-it. E vetmja gjë që ka pasur në qesen e dorës kanë qenë rrobat e nënës dhe të së motrës, të vrara në Siri. Desk/HeR nuk ka të dhëna se kur është bërë fotografia dhe kush është autor i saj.

DEVOCIONI, SYNIM I AGJËRIMIT

**Shkruan: Jusuf Zimeri
(Enkas për HeR)**

Madhështia e Islamit qëndron në faktin se kur i thërret njerëzit për një veprim të caktuar, intencën e tij është vetëm interesi i përgjithshëm shoqëror dhe individual i vepruesit dhe nuk ndalon nga ndonjë veprim, e vetëm se me të synon evitimin dhe largimin prej nesh të së dëmshmes. Kjo është natyrshmëri thelbësore e legjislacionit islam, nga e cila nuk mund të shmangen dispozitat juridike që burojnë prej tij.

Në frymën e këtij parimi islam, do të bëjmë përpjekje që në vazhdim të paraqesim disa urtësi dhe intencën nga shkolla e agjërimit, që dukshëm shkakton ndryshime thelbësore jo vetëm në organizmin e njeriut, por edhe në personalitetin, etikën, bindjen dhe vlerat e tij; si në planin individual, ashtu dhe në atë shoqëror, islam.

Pika thelbësore, të cilën detyrimisht duhet ta kuptojmë dhe të kemi bindjen për të, është se ligjësimi i këtij detyrimi nuk është sanksionimi, por edukimi i drejtë i besimtarit islam dhe trajnimi i tij për të arritur shkallën më të lartë të mundshme njerëzore dhe të devocionit. Këtë synim të agjërimit në mënyrë shumë të thuktë dhe të drejtpërdrejtë e paraqet ajeti kuranor me të cilin agjërimi si postulat islam bëhet detyrim për besimtarët islamë, që thotë: **“O ju që keni besuar, agjërimi ju është bërë obligim, ashtu siç obligim edhe i atyre para jush, në mënyrë që të bëheni të devotshëm.”** (El-Bekare: 183)

DETYRIM EDHE TE POPUJT TJERË

Nëse ajetin kuranor e vështrijmë me vëmendje dhe në mënyrë analitike, konstatohen shumë gjëra të mëdha. Fillimisht

dhe në shikim të parë, konstatohet se agjërimit nuk është ndonjë adhurim i kategorisë së risisë për Ummetin e Muhamedit (a. s.), për shkak se adhurimi si formë e komunikimit të njeriut me Krijuesin e tij ishte detyrim, edhe pse në formë të ndryshme, edhe te popujt dhe ummetet e peygamberëve të tjerë - që nga fillimi i ekzistimit të qenies njeri në rruzullin tokësor e sot, e deri në përfundimin definitiv të jetës në këtë botë. Kjo në vetvete ngërthen faktin për peshën dhe rëndësinë e këtij adhurimi, sepse ka qenë dhe ngel si forma më e sofistikuar e edukimit shpirtëror dhe fizik të qenies njeri në të gjitha kohët.

Krijuesit të tij, atëherë s’ka dilemë se edhe ndihma e Allahut (xh. sh.) është prezente për ta ndihmuar atë në adhurimin e tij. Prandaj, besimtari islam kur agjëron nuk ndien shqetësim, as lodhje; përkundrazi, ndien kënaqësi, të cilën asnjëherë nuk di ta përshkruajë me fjalë, pavarësisht nivelit të oratorisë së tij, sepse kjo është kënaqësia shpirtërore, e kënaqësia është cilësi shpirtërore e jo fizike.

Në anën tjetër, ajeti kuranor na e bën qartë me dije se rezultat më efikas i një agjërimit për hir të Allahut (xh. sh.) me bindje dhe sinqeritet të plotë, duke plotësuar ruknet, kushtet dhe kriteret ligjore islame, është devocioni. Kështu e kanë shpjeguar shumë dijetarë islamë nëpër etapa të ndryshme kohore. Një interpretim të ngjashëm të lidhshmërisë mes agjërimit dhe devocionit e gjejmë edhe te dijetari i famshëm Fahrur-Rrazi, i cili kur e shpjegon këtë ajet kuranor thotë: “Nga agjërimi lind devotshmëria; për shkak se përmes agjërimit, mposhten dëshirat, ndrydhen pasionet, largohen të këqijat, mposhtet mendjemadhësia dhe imoraliteti.”

PASTËRTIA SHPIRTËRORE E SJELL DEVOTSHMËRINË

Qëllimi esencial i agjërimit, edhe pse kjo është pjesë përbërëse e tij (agjërimit),

nuk është, thjesht, heqja dorë nga konsumimi i ushqimit, i pijeve dhe marrëdhënieve seksuale brenda një kohe të caktuar, sepse qëllimi final është arritja e devotshmërisë, e kjo nuk vjen pa arritjen e plotë të pastërtisë shpirtërore. Kjo vërtetohet edhe me hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejre, i cili ka thënë: Pejgamberi (a. s.) ka thënë: **“Ai i cili nuk heq dorë nga fjalët e rreme dhe të vepruarit me to, dhe nga arroganca, Allahu nuk ka nevojë për të që ai të heqë dorë nga ushqimi dhe pija e tij.”** (Buhariu) Imam Bejdaviu, ndërkaq, duke e shkoqitur këtë hadith mes tjerash thotë: “Agjërimit nuk ka synim final heqjen dorë nga konsumimi i ushqimit dhe pijeve, por më shumë se këtë: synon thyerjen dhe flakjen e dëshirave, të epsheve dhe të vetive të liga që i ka njeriu; e nëse nuk e arrin realizimin e kësaj, atëherë nuk mund të flitet për devotshmërinë, porse ngel vetëm në nivelin e pranimit dhe të mospranimit të tij.”

Devocioni është një atribut dhe një epitaf më i lartë që i jepet besimtarit islam. Ai është gjithëpërfshirës, që në vazhdimësi kërkohet nga besimtari islam, që qenien njerëzore e ndrit në piedestalin më të lartë të mundshëm të kompaktësisë së qenies njeri. Është një atribut që e motivon njeriun në punë të mira dhe konstruktive në jetën e kësaj bote dhe e ngre

në derexhetë më të larta të shpërblimeve në jetën e botës tjetër. Niveli më i lartë i devotshmërisë arrihet përmes agjërimit të plotë, të cilin eruditi i madh islam Ebu Hamid el Gazali e cilëson “agjërimit specifik i specifikës”, e ky është agjërimit nga i cili njeriu heq dorë nga të gjitha vetitë dhe veset e liga e të shëmtuara dhe me tërë qenien e tij shpirtërore dhe fizike i afrohet përkushtimit të plotë të adhurimit.

Sigurisht se devotshmëria më e theksuar tek agjërimit është për shkak se te veprat –adhurimet tjera ekzistojnë mundësia e përmbajtjes së një doze të hipokrizisë apo të dyfaqësisë, ndërsa agjërimit kategorikisht e përjashton këtë mundësi. Ka mundësi që dikush të falë namaz sa për sy e faqe, apo të japë sadaka për t’u krenuar me të para opinionit publik, ose shkon në haxh për të fituar një titull, por nuk ka mundësi që dikush të agjërojë për dyfaqësi ndaj të tjerëve, sepse si i tillë do të prishte agjërimit në rastet e vetmisë. Përkundrazi për këtë, Allahu (xh. sh.) në hadithin Kudsij të transmetuar nga Ebu Hurejreja (r. a.) thotë: E kam dëgjuar Pejgamberin (a. s.) të thotë: **“Çdo punë e mirë e birit të Ademit shumëfishohet prej dhjetëfish deri në shtatëqind, e Allahu (xh. sh.) ka thënë: ‘përveç agjërimit; ai është për Mua dhe Unë shpërblej për të, sepse ai (robi im) e ka braktisur kënaqësinë dhe ushqimin e tij për Mua.**

Agjëruesi ka dy gëzime: gëzimin në kohën e iftarit dhe gëzimin tjetër kur ta takojë Zotin e tij. Aromë e gojës së agjëruesit është më e mirë tek Allahu sesa aromë e miskut.” (Muslimi)

Në hadith vërehet qartë se besimtari islam për çdo punë të mirë e konstruktive mund të shpërblehet me dhjetëfishin e saj, deri në shtatëqindfish, por Allahu (xh. sh.) e veçon agjërimit, sepse agjërimit është lidhje e fshehtë mes robit dhe Krijuesit të tij, prandaj e përjashton nga ky rregull, duke thënë se “për agjërimit llogarinë e bëj Unë dhe për të shpërblej sipas llogarisë sime, e jo sipas llogarisë suaj”. Thënë shkurt: shpërblimi nga agjërimit, me të cilin arrihet niveli më i lartë i devotshmërisë, i pallogaritshëm në shifra. Kjo vërtetohet edhe me faktin se agjërimit nuk mund të arrihet pa kaluar nëpër shkollën e durimit, e për ata që bëjnë durim Allahu (xh. sh.) thotë: Thuaj: **“Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pa masë.”** (Ez-Zumer: 10) Prandaj, përderisa ne nuk i dimë shifrën e fundit të shpërblimit, si do të mund të dimë se sa është i madh shpërblimi i Allahut (xh. sh.) për agjëruesit e devotshëm, kur thotë se ‘ato janë pa masë’. (Shkup, 1 mars 2022)

(Autori është Drejtor i Sektorit Fetar-Arsimor të Rijasetit të BFI-Shkup)

VLERAT DHE MIRËSITË E MUAJIT TË RAMAZANIT

“O ju që besuat, agjërimi (saum) ju është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.” (El-Bekare: 183)

Shkruan: Prof. dr. Abdylxhemil Nesimi

Në virgjilje të muaji të begatë të Ramazanit anembanë botës myslimanët i drejtojnë sytë kah

qielli për të parë daljen e hënës së re dhe për të thënë: Mirë se erdhe, muaj i Ramazanit!

Ky muaj mbart me vete mirësi të mëdha dhe begati të shumta; në të ka falje

të mëkateve si dhe shpëtim nga zjarri. Ndaj, duhet që çdo mysliman të përgatit veten e tij për ardhjen e këtij muaji, duke e përmirësuar veten, duke pasur vullnet dhe vendosmëri të madhe, si dhe duke

qenë i gatshëm të japë maksimumin për të shfrytëzuar ditët dhe netët e tij.

Duke pasur parasysh se midis rajoneve të botës ekzistojnë ndryshime të rëndësishme, ku në një kohë në hemisferën veriore kemi dimër, kurse në hemisferën jugore vazhdon stina e verës, agjërimi është në lidhje direkte me natyrën. Në qoftë se agjërimi do të bëhej në një stinë të caktuar sipas kalendarit diellor, atëherë myslimanët që jetojnë në disa zona do të agjëronin gjatë gjithë jetës në stinë të nxehtë dhe me ditë të gjatë, kurse një pjesë tjetër e myslimanëve do të agjëronin përherë në ditë të shkurtra dimri. Një gjë e tillë siguron që myslimanët të agjërojnë në stinë të ndryshme dhe të mësohen me vështirësitë e secilës stinë të vitit për t'i eliminuar disavantazhet.

Për 1.6 miliardë myslimanë në botë ngjarja vjetore përfaqëson një kohë të shpejtë, gjatë së cilës vëmendje të veçantë i kushtojnë namazit, pastrimit dhe veprave të bamirësisë.

LASHTËSIA E AGJËRIMIT

Agjërimi i muajit Ramazan është detyrim islam dhe një nga pesë shtyllat kryesore të tij. Për agjërimin islam, i Plotfuqishmi zgjodhi muajin e bekuar të Ramazanit, i cili në shpirtin e myslimanit zë një vend të posaçëm, ngase në këtë muaj zbritën ajetet e para kuranore, të cilat i barti shpirti besnik (Xhibrili) deri në zemrën e besnikut, Muhamedit (a. s.). Megjithatë, agjërimi është shumë i hershëm; njëherësh, lashtësia e agjërimin flet për rëndësinë e tij dhe për faktin se në shpirtin e njeriut përherë është ushqyer ndjenja për adhurimin e Allahut Fuqipotë në forma të ndryshme.

Agjërimi, ashtu siç shprehet Kurani famëlartë, është ibadet që ka ekzistuar edhe në religjionet tjera para zbritjes së Kuranit dhe që shkon deri në kohë shumë të vjetra, të cilën lashtësia e përshkruan ajeti i agjërimin: “O ju që besuat, agjërimi ju është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm. (jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), të një të varfri; ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për të. Mirëpo, po qe se dini, agjërimi është më i mirë për ju.” (El-Bekare: 183-184)

Shprehja kuranore “ditë të caktuara” ka për qëllim muajin e Ramazanit, në të cilin filloi shpallja e Kuranit, si udhërrëfyes për njerëzinë dhe si dëshmi e qartë që shpie në rrugën e drejtë dhe që e ndanë të vërtetën nga e pavërteta.

Nga ajeti i cituar më lart shihet se agjërimi ka qenë i obliguar edhe para ardhjes së Muhamedit (a. s.). Disa nga ata popuj janë shfarosur, e disa jetojnë edhe sot, siç janë kinezët, indianët, persianët, egjiptianët etj.

Në ungjijt (sipas Mateut dhe Llukës) gjithashtu flitet për agjërimin. Dispozitat e agjërimin në Dhiatën e Vjetër (Bibël) janë të paqarta, mirëpo dihet se Musai (a. s.) agjëronte nga dyzet ditë.

Fakti se institucioni i agjërimin haset edhe te popujt paganë, flet se edhe këtyre popujve u kanë ardhur profetë me urdhëresa të njëjta ose të ngjashme, të cilat i ka shpallur edhe Kurani. Ndërkohë që disa popuj agjërimin e kuptonin si vetëmundim - duke mos ngrënë asgjë për një kohë të gjatë (brahmanët, budistët), të tjerët hanin, duke e lënë vetëm

mishin dhe dhjamin e kafshëve (të krishterët).

Për sa i përket agjërimi në Islam, ai është i një natyre krejtësisht tjetër nga ai që zbatohet më herët. Së pari, me agjërim kryejmë një obligim ndaj Zotit dhe i përgjigjemi urdhrin të Tij. Njëherësh, kjo është edhe esenca e vetë agjërimin, me anë të të cilit shprehim bindjen, devotshmërinë dhe sinqeritetin tonë ndaj Krijuesit.

Në vitin e dytë pas mërgimit të Muhamedit (a. s.) nga Meka në Medinë (623-624) ishin ajetet 183-185 dhe 189 të Kuranit hapi i parë në rrugën e themelimit të praktikës së pavarur, të re, të agjërimin të bashkësinë islame, plotësimi dhe përcaktimi i të cilave rregulla rituale do të mbetet detyrë e juridiksionit të mëvonshëm.

Është fakt i pamohueshëm se myslimanët kanë agjëruar edhe para kësaj date, por jo në muajin Ramazan, ngase agjërimi në këtë muaj nuk ishte i detyrueshëm para zbritjes së ajeteve që flasin për obligueshmërinë e agjërimin. Më parë Pejgamberi (a. s.) agjëronte në ditë të caktuara, edhe atë tri ditë në çdo muaj: ditën e 10-të, të 20-të dhe të 30-të. Thuhet në Kuran: “(jeni të obliguar për) Ditë të caktuara.” (El-Bekare: 184) Njëherësh, kjo ishte si parapërgatitje për myslimanët, që kur të zbresin ajetet që obligojnë agjërimin e këtij muaji, të jenë të përgatitur.


Në muajin Sha’ban të vitit të dytë hixhrij Muhamedit (a. s.) i zbresin ajetet kuranore të cilat e bëjnë të obligueshëm agjërimin e këtij muaji për të gjithë myslimanët që i plotësojnë kushtet për agjërim: “Muaji i Ramazanit, që në të (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtër). E, kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë.” (El-Bekare: 185)

Që nga viti i dytë hixhrij myslimanët e agjërojnë muajin e Ramazanit si obligim, si domosdoshmëri. Ata e aplikojnë atë me një devotshmëri të panjohur më parë, me vullnet dhe dashuri, me një disiplinë të lartë e të pashembullt në historinë e agjërimin.

PËRKUFIZIMI

Agjërimi është një nga pesë shtyllat mbi të cilat risendërtohet Islami. Është një institucion edukues-moralizues, që synon edukimin fizik dhe shpirtëror të njeriut.

Fjala agjërim (es-seum – gj. arabe),



sipas konceptit islam do të thotë: të përmbajturit, të larguarit, heqje dorë nga të ngrënët, nga të pirët dhe nga marrëdhëniet intime, që nga agu i parë deri në perëndim të diellit.

Në ajetet e Kuranit të transmetuara në Mekë ky term potencohet vetëm një herë. Aty i urdhërohet Merjemit (r. a.) që të flasë nëpërmjet mbulesës me këto fjalë: “Dhe ha, pi dhe qofsh e gëzuar (tekstualisht: me sy të freskët)! Dhe kur të shohësh ndonjë nga njerëzit, thuaj: i kam lënduar (premtuar, dhuruar) të mëshirëshmit (Zotit) agjërim. Prandaj, sot nuk do të flas me asnjë krijesë njerëzore.” (Merjem: 26)

Përkatesisht, nga komentuesit e Kuranit në këtë pikë bëhet lidhja e termit saum (agjërim) me “heshtjen - samt”, si shenjë e përkormës (- ngrënies me masë, duke qenë i përmbajtur, Red.) e cila është karakteristike gjatë agjërimit islam dhe në të gjitha sferat e jetës së përditshme.

Agjërim në kuptimin gjuhësor do të thotë: shmangie dhe privim, ndërsa në kuptimin fetar me agjërim nënkuptojmë: privimin e vetvetes dhe ndalimin e saj nga ngrënia, pirja dhe nga marrëdhëniet intime prej agut të parë deri në perëndim të diellit, duke pasur si qëllim adhurimin e Allahut fuqiptotë.

Nga përkufizimi i agjërimit arrijmë të kuptojmë se me agjërim nënkuptojmë kontrollin e nefsit nga ana e individit, duke bërë nijet dhe duke filluar nga agimi e deri në perëndim të diellit. Gjatë këtij intervali kohor agjëruesi qëndron larg ushqimit, larg pijeve, larg përgojimeve; me një fjalë, larg së keqes dhe së kotës. Pra, me agjërimin kemi të bëjmë me kontrollin e nefsit, të dëshirave, pasioneve e kështu me radhë.

KUSH ËSHTË I OBLIGUAR TË AGJËROJË?

Agjërimi islam është detyrë e domosdoshme fetare për çdo mysliman dhe myslimane të moshës madhore dhe të mençur, që të heqë dorë nga ushqimi, pija, marrëdhëniet intime, duhani dhe veprimet e ngjashme që e prishin agjërimin nga agimi deri në perëndim të diellit, me nijet që këtë ta bëjë në emër të Allahut, me kusht që ai nuk është udhëtar dhe që në vetvete nuk ka pengesa për agjërim.

Për të miturin agjërimi nuk është obligim, por atij i preferohet agjërimi, në mënyrë që të mësohet dhe t'i bëhet shprehje agjërimi i muajit të Ramazanit.

Personi i çmendur nuk është i obli-

guar të agjërojë dhe po ashtu nuk e ka obligim kompensimin e tij me fidje (ushqim ditor) edhe në qoftë se është person i rritur. Në këtë kategori bën pjesë edhe personi me të meta mendore dhe njeriu me mendje të brishtë (el-m'atuh), i cili nuk i dallon gjërat.

Personi i cili nuk është në gjendje të agjërojë për shkak të pengesave të vazhdueshme, siç janë moshë e vjetër ose sëmundja për të cilën nuk pritet shërim i shpejtë, është i obliguar që për çdo ditë të paagjëruar të japë fidje - të ushqyerit e të varfërve.

Pacienti, shërimi i të cilit pritet në një të ardhme të afërt, mund të mos agjërojë nëse agjërimi do t'i paraqet vështirësi për shëndetin e tij, por ai ato ditë të paagjëruara do t'i kompensojë pasi t'i përmirësohet gjendja e tij shëndetësore dhe pasi të shërohet.

Gratë shtatzëna dhe nënat mëndesha, nëse ato e kanë vështirë të agjërojnë për shkak të shtatzënisë ose të ushqyerjes me gj, ose në qoftë se frikësohen për fëmijën e tyre, do ta ndërpresin agjërimin, ndërkaq ditët e paagjëruara do t'i kompensojnë kur agjërimi do t'u bëhet i lehtë dhe i pafrikë.

Gratë në periudhën e menstruacioneve dhe të lehonisë do ta ndërpresin agjërimin, por do të kompensojnë ditët e lëshuara; e në qoftë se ka ndodhur ajo të agjërojë, agjërimi nuk do t'i jetë e vlefshëm.

Personi i cili është i detyruar të ndërpresë agjërimin për të shpëtuar të pafajshmin nga përmytja apo zjarri, do ta ndërpresë agjërimin për këto shkaqe, por do ta kompensojë mosagjërimin.

Për sa i përket udhëtarit, nëse dëshiron, mund të agjërojë e nëse dëshiron, mund të mos agjërojë (për arsye se e ka të lejuar), por ditët e lëshuara të agjërimit do t'i kompensojë, pa marrë parasysh se a ishte udhëtimi i papritur apo udhëtimi i përditshëm, siç e bëjnë taksistët.

Këto janë disa performanca që kanë të bëjnë me agjëruenin, meqë është vështirë të prezantohen që të gjitha problematikat që shfaqen gjatë agjërimit dhe të privuarit nga ky detyrim fundamental i Islamit.

VLERA E MUAJIT RAMAZAN

Për muajin e Ramazanit mund të flitet nga pikëpamje të ndryshme, duke filluar nga aspekti shpirtëror, kulturor, letrar, sociologjik etj. Kjo, për arsye se dhuratat e Ramazanit janë aq të shumta, saqë është e pamundur të përmbledhen

dhe se pse kanë forcë dhe ndikim të tillë shpirtëror në jetën e myslimanëve që nuk mund të matet me asnjë muaj tjetër. Thjesht thënë, ditët e Ramazanit të bekuar janë të veçanta, jo të zakonshme dhe unikale. Drita e Ramazanit të bekuar veçanërisht derdhet në zemrat dhe shpirtat e besimtarëve, të cilat kënaqësinë e vet e gjejnë në adhurimin e gjallë të Allahut fuqiptotë.

Për vlerat dhe virtytet shpirtërore të muajit të Ramazanit është thënë dhe shkruar shumë. Është vështirë të thuhet, apo të shtohet diç e re në këtë aspekt. Megjithatë, për hir të ardhjes së këtij Muaji të Bekuar e Madhështor dhe mysafirimit më të dashur në shtëpitë dhe zemrat e myslimanëve, është i dobishëm përkujtimi në disa vlera dhe virtyte të cilat e veçojnë nga muajt tjerë. Sepse, fjala është për muajin më të ndershëm dhe muajit të vetëm, emri i të cilit përmendet në Kuran. Në të është shpallur Libri më i Ndershëm robit më të përzgjedhur të Allahut. Në Ramazan kryhet një nga ibadetet bazë që na afron nga Krijuesi ynë. Në të gjendet nata më e vlefshme në vit. Në të zbresin melaqet më të ndershme.

Vërtet, Allahu fuqiptotë e ka begatuar ummetin e Muhamedit (a. s.) me muajin e Ramazanit, muajin në të cilin është zbritur Kurani, ku Allahu (xh. sh.) thotë: “Muaji i Ramazanit, që në të (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria). E, kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë...” (El-Bekare: 185)

Është muaj i agjërimit, i faljes së namazit, muaj i begatshëm. Për vlerat e mëdha të këtij muaji dhe të agjërimit të tij peygamberi Muhamed (alejhisselam) i përgëzonte sahabët e tij para se të vinte ky muaj duke u thënë: “Ju ka ardhur një muaj i bekuar, në të cilin është bërë detyrim agjërimi. Në këtë muaj janë hapur dyert e Xhenetit, janë mbyllur dyert e Xhehenemit dhe shejtanët janë lidhur në pranga. Në të gjendet një natë, e cila është më e mirë se një mijë muaj.”

Po ashtu, transmetohet nga Tirmidhiu, Ibn Hibbani, Ibn Maxheh dhe Bejhëkiu, e që është vlerësuar si hadith sahih, nga Ebu Hurejra (r. a.), se Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: “Çdo natë (prej netëve të Ramazanit) thërret një thirrës (Melaqe): ‘O ti që dëshiron punë të hairit, pranoji ato’ (shpërblime që t'i ka dhuruar Allahu në këtë muaj) dhe: ‘o ti që dëshiron punë të këqija, pakësoji ato’.”

(Kryhet në numrin tjetër)

VEÇORITË E MUAJIT RAMAZAN

Falënderimi (për shpalljen e Kuranit) do të arrihet përmes agjërimit në këtë muaj, të cilin Allahu i Lartmadhërishtëm e bëri obligim për robtë e Tij besimtarë.



Shkruan: Eljasa Mahmudi
(Enkas për Her)

Muaji Ramazan është njëri prej dymbëdhjetë muajve të vitit sipas kalendarit islam, përkatesisht ai është muaji i nëntë i takvimit hixhri. Allahu i Lartmadhërishtëm e dalloj muajin Ramazan me disa veçori, të cilat do t'i theksojmë në vijim.

Muaji Ramazan është muaj i shpalljes së Kuranit Famëlartë, respektivisht është muaji kur filloi të shpallet Kurani Famëlartë. Allahu i Lartmadhërishtëm thotë: **”Muaji Ramazan; në të (filloi) të shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria).”** (El-Bekare: 185)

Muaji Ramazan, pasi që është muaj i

shpalljes së Kuranit Famëlartë, atëherë ky muaj duhet të dallohet me një adhurim të veçantë, përmes të cilit e falënderojmë Allahun e Lartmadhërishtëm për mirësinë dhe dhuratën e madhe të shpalljes së Kuranit Famëlartë. Ky falënderim do të arrihet përmes agjërimit në këtë muaj, të cilin Allahu i Lartmadhërishtëm e bëri obligim për robtë e Tij besimtarë, duke thënë në vazhdim të ajetit të sipërpërmendur: **”E, kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë.”** (El-Bekare: 185)

Veçori tjetër e këtij muaji është se në këtë muaj hapen dyert e Xhenetit, mbylleten dyert e Xhehenemit dhe prangosen shejtanët, siç ka theksuar në hadithet e tij i dërguari i Allahut, Muhamedi (paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

Muaji Ramazan është muaj i faljes së mëkateve për ata të cilët agjërojnë me sinqeritet dhe me bindje të plotë tek shpërblimi i Allahut të Lartmadhërishtëm, siç ka theksuar Muhamedi (alejhissalatu ves-selam) në hadithin e tij: **”Kush e agjëron Ramazanin me besim të sinqertë tek Allahu, duke llogaritur në shpërblimin e Tij, atij i falen mëkatet e mëparshme.”**

”MELAQET KËRKOJNË FALJE PËR AGJËRUESIT”

Melaqet kërkojnë nga Allahu i Lartmadhërishtëm mbulimin e mëkateve dhe shlyerjen e tyre për agjëruenin, siç ka theksuar në hadithin e tij Muhamedi (alejhissalatu ves-selam) duke thënë: **”Melaqet kërkojnë falje për agjëruenin deri sa të bëjnë iftar.”**

Muaji Ramazan është muaj i solidarit-

tetit, i bujarisë dhe i bamirësisë, ndërsa Allahu i Lartmadhërisëm i do bamirësit, duke u premtuar atyre falje, shpëtim dhe Xhenet. Këtë solidaritet, bujari dhe bamirësi agjëruesi e arrin duke ua shtrirë dorën e solidaritetit dhe të bujarisë të varfërve, të ngratëve, jetimëve dhe skamnorrëve. Kjo arrihet në këtë muaj kur shtrohen sofrat e iftarit për agjëruesit, që bëhen shkak për falje të mëkateve, shpëtim prej zjarrit të Xhehenemit dhe shumëfishimin e shpërblimeve.

Muaji Ramazan është muaj i namazit të teravisë, të cilin e falin myslimanët gjatë netëve të Ramazanit, duke e praktikuar sunnetin e Muhamedit (alejhis-salatu ves-selam), i cili e fali këtë namaz vetë dhe disa net së bashku me shokët e tij, duke theksuar për vlerën e kalimit të netëve të Ramazanit në namaz, në hadithin e tij: *”Kush i kalon netët e Ramazanit në adhurim me besim të sinqertë tek Allahu, duke llogaritur në shpërblimin e Tij, atij i falen mëkatet e mëparshme.”*

Muaji Ramazan është muaj i dhikrit - i përmendjes së Allahut dhe i duasë. Për këtë shkak, Allahu i Lartmadhërisëm e ka theksuar vlerën e duasë në kontekst të ajeteve të agjërimit kur thotë: **”E kur robtë e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet. Pra, që të jenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua**

dhe le të më besojnë ata Mua.” (El-Bekare: 186) Pra, ky ajet argumenton lidhshmërinë e fortë ndërmjet agjërimit dhe duasë, që do të thotë se muaji i bekuar Ramazan është kohë shumë e përshtatshme për pranimin e duave.

Muaji Ramazan është muaji i mëshirës, i faljes së mëkateve dhe i shpëtimit nga zjarri i Xhehenemit. Muaji Ramazan veçohet me Natën e Kadrit - me natën më të mirë të vitit, e cila është më e mirë se një mijë muaj. Kjo natë është njëra prej dhjetë netëve të fundit të Ramazanit.

Muaji Ramazan dallohet nga muajt tjerë me shpërblimin e madh të atij që e kryen umren (vizitën Qabesë së bekuar) në këtë muaj të bekuar, siç transmetohet nga i dërguari i Allahut, Muhamedi (alejhis-salatu ves-selam), i cili ka thënë: *”Umreja në Ramazan është sa vlera e Haxhit.”*

Veprat e mira në këtë muaj shpërblehen shumëfish, për shkak të vlerës së jashtëzakonshme të këtij muaji madhështor. Muaji Ramazan llogaritet edhe si muaj i durimit, për shkak se agjëruesi përmes agjërimit të tij, duke u privuar nga pija, nga ushqimi dhe marrëdhëniet intime bashkëshortore, nga koha e imsakut deri në kohën e iftarit, ai adaptohet që të jetë i durueshëm, ndërsa dihet se durimi është një virtut shumë i lartë njerëzor, që ndihmon në kryerjen e veprave të mira, largimin

nga veprat e këqija dhe është armë shumë e fuqishme në tejkalimin e sfidave dhe vërshtirësive të jetës.

DURIMI ËSHTË ÇELËSI I SUKSESIT

Prandaj, ai konsiderohet çelësi i suksesit për besimtarin mysliman në kryerjen e suksesshme të misionit të tij në këtë botë dhe fitimin e shpërblimit të Xhenetit në botën tjetër. Muhamedi (alejhis-salatu ves-selam) ka thënë: *”Muaji Ramazan është muaj i durimit, ndërsa shpërblimi i durimit është Xheneti.”*

Duke qenë muaj i shpalljes së Kuranit Famëlartë, Allahu në Ramazan i dha vulën e pejgamberisë Muhamedit (alejhis-salatu ves-selam), që ai të jetë udhëzues për njerëzit dhe dallues i të vërtetës nga gënjeshtria. Për këtë arsye, besimtarët myslimanë gjatë këtij muaji të bekuar i kushtojnë kujdes të veçantë leximit të Kuranit Famëlartë dhe shpjegimit të domethënies së tij, në mënyrë që këto mësimet t’u shërbejnë atyre gjatë jetës së tyre të përditshme, duke i zbatuar dispozitat dhe porosinë kuranore.

Muaji Ramazan është muaj i kohës së bekuar, për shkak të vlerës së madhe të këtij muaji në krahasim me muajt tjerë. Për këtë arsye, agjëruesi i këtij muaji nuk duhet ta kalojë kohën në gjumë dhe punë të kota; përkundrazi, ai duhet të jetë shumë aktiv gjatë ditëve dhe netëve të Ramazanit, duke bërë vepra të mira dhe aktivitete të dobishme, siç janë: falja e namazeve me xhematë në xhami, leximi i Kuranit, prezantimi në ligjëratat, tribuna dhe iftare, dhënie e sadakasë-lëmoshës për skamnorrët, vizita e farefisit dhe përforcimi i lidhjeve farefisnore dhe shoqërore, si dhe shumë aktivitete të dobishme për individin, familjen dhe shoqërinë.

Me një fjalë, muaji Ramazan është muaj i devotshmërisë; ndërkaq, të jesh i devotshëm, do të thotë të jesh aty ku është urdhri i Allahut dhe mos të jesh aty ku është ndalesa e Allahut. Allahu i Lartmadhërisëm në Librin e Tij Fisnik thotë: **”O ju që besuat, agjërimi ju është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”** (El-Bekare: 183)

I bëjmë lutje Allahut të Lartmadhërisëm që në këtë muaj të na mbulojë me mëshirën dhe faljen e Tij, të na shpëtojë nga zjarri i Xhehenemit dhe të na pranojë në Xhenet përmes derës “Rejjan”, që është derë e veçantë në Xhenet për agjëruesit, e cila do të mbetet e hapur derisa të hyjë edhe agjëruesi i fundit. Amin!

(Autori është vaiz dhe hatib në Xhaminë e Re të Kumanovës)

ISLAMI ËSHTË KUNDËR BLOKIMEVE

Por, edhe kundër monopolit me të mbjellat bujqësore, që po ushtrohet më shumë se njëzet vjet (ngaqë njerëzit po ikin jashtë vendit)...

Shkruan: Taxhudin Hamidi

Shëriati islam është i vetmi konstrukt ligjor i cili kujdeset me të gjithë qenien e vet, përmes dispozitave gjegjëse, për gjendjen e ushqimit dhe të sigurisë së tij në forma ligjore dhe në mjaftueshmërinë e plotë për njerëzimin.

Interesimi i fesë islame nuk përfundon vetëm në marrëdhëniet mes njeriut si individ dhe Zotit si Krijues i Gjithësisë, por ai vazhdon edhe në sferën e sigurimit të një mirëqenie stabile edhe në dimensionin e ushqimit të tij, në sferën e përgjithshme në shoqëri dhe në tregun e qytetit dhe të marketeve. Pra, ai e kultivon edhe çështjen ekonomike të njeriut në shoqëri. Nga ky dimension, kemi dëgjuar prej imamëve tanë të vjetër se nuk është e preferuar të lidhesh në namaz i uritur dhe i etur. Gjithashtu, ata potencojnë se nëse ka ndonjë nevojë të theksuar të kësaj natyre, gjykatësi duhet të anulojë vendimin gjatë seancës gjyqësore. Që nënkupton se dispozitat e shariatit janë në përputhje me funksionimin optimal të organizimit biologjik të individit, apo të shoqërisë në përgjithësi.

Thënia e Pejgamberit islam na rekomandon: *”Ai që i bllokoi artikujt ushqimorë për përfitime komerciale (në kohra krize) meriton mallkimin e Perëndisë.”* Gjendja e monopolit të artikujve ushqimorë dhe rritja e çmimeve kontribuojnë në paralizimin e jetës ekonomike dhe pamundësojnë kthimin e borxheve. Prandaj, çdo individ duhet të kundërshtojë: paralizimin e jetës ekonomike; përhapjen e fajdexhinjve (atyre që mezi presin që t’i ngarkojnë familjet shqiptare me borxhe, duke dhënë pare me kamatë); dhe reduktimin apo humbjen e konkurrencës në treg.

Pra, dispozitat e shariatit islam në vazhdimësi kontribuojnë në ruajtjen e artikujve ushqimorë, si një nevojë e natyrës fizike dhe biologjike të sigurisë



së njeriut dhe të krijesave të tjera në të gjithë globin.

Dijetarët islamë janë kundër monopolit të nevojave të njeriut në të gjitha sferat e jetës dhe mbështetin kategorinë e dispozitave të shariatit në ndalimin e monopolit të ushqimit, si formë e haramit. Monopoli ka kategorinë e vet edhe në aspektin e fshehjes, apo të deportimit të fuqisë punëtore jashtë vendit, e cila shkakton kriza në degën e bujqësisë, siç është rasti me tokat shqiptare, ku humbi vlera e mbjelljes nga pamundësia e krahut të punës, ku me hektarë të tërë mbeten shkret, apo të pambjellë. Edhe ky konsiderohet një ihtikar, apo një bllokim i artikujve ushqimorë.

Kur lexojmë programet zhvillimore të Imam Jusufit nga shkolla hanefite se si ai kishte përcaktuar kredi për ata që e punojnë tokën në atë kohë, ne sot, duke lënë shkret gjithçka, mund vetëm të magjepsim dhe të turpërohermi nga këta imamë të mëdhenj.

Monopoli në treg është i gjykuar si haram nga jurisprudencia islame dhe nga juristët islamë, nëse fillon të dalë nga kontrolli i inspektoratit (shtetëror) të tregut. I njëjtë është edhe monopoli i të mbjellave bujqësore, që po ushtrohet më shumë se njëzet vjet (ngaqë njerëzit po ikin jashtë), që ka krijuar një vrimë prej 250.000 kilogramëve grurë, e cila duhet

të “zihet” nga importi. Ky lloj i tiranisë nga aspekti ekonomik dhe bujqësor për gjeneratat e reja nuk duhet të ndodhë dhe nuk është i njohur sa duhet, kështu që duhet të kemi kujdes se si duhet të menaxhohet kjo situatë e brishtë dhe delikate. Pra, sipas dispozitave të shariatit islam këtu kemi një padrejtësi dhe një zullum, të cilët i njeh bota dhe për të cilët feja islame tërheq vërejtjen në këtë dimension.

Reperkusionet dhe problemet që paraqiten shkojnë në dëm të popullatës njerëzore. Muhamedi (alejhis-selam) thotë: *’Men ihtekere fehuve hkati’* - që në gjuhën shqipe përshtatet me kuptimin “kush bllokoi me qëllim të rritjes së çmimit, ai ka bërë kundërvajtje”.

Dijetarët islamë janë kundër monopolit të nevojave të njeriut. Bllokimi i qarkullimit të mallrave përhap depresionin te të varfërit, shkakton grindje përbrenda familjes dhe i përsheq sëmundjet kronike. Koha e ihtikarit, apo e monopolit të artikujve ushqimorë, atakon pamëshirshëm nderin, besimin dhe devotshmërinë (takvallëkun).

Thuhet në Kuran: *“...dhe kushdo që të përpiqet të bëjë ndonjë të keqe a ndonjë mëkat, Ne kemi për t’ua shijuar një dënim të idhët.”* (Al-Haxh: 25)

(Autori është Referent i Vakëfit në Myftininë e Tetovës)

POROSITË E LARTA TË SURES EL-HUXHURAT

Nga Hfz. Mehas Alija

Falënderimi i takon Zotit të botëve, salavatet dhe selamet i takojnë të dërguarit të Tij, familjes, shokëve dhe gjithë atyre që e pasojnë për të mirë deri në Ditën e Gjykimit.

“O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë, pra, e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i Allahut, e Allahu është mëshirues; Ai e pranon shumë pendimin.” (El-Huxhurat, 12)

Surja El-Huxhurat është surja 49-të e Kuranit, ka 18 ajete dhe quhet ndryshe edhe si surja e ahlakut dhe edebit.

Ka shumë arsye se pse sot u përcaktova të sjell disa porosi nga kjo sure, por më kryesorja është se kjo sure i kushtohet thelësisht rregullimit të raporteve dhe lidhjeve midis njerëzve, si dhe paraqet modelin e një morali të shëndoshë shoqëror.

Gjendja sot në botë, por edhe në vendlindjet tona, tregon qartë për vuajtjet që kanë njerëzit si pasojë e problemit të lajmit, gjuhës dhe të sëmundjeve të saj. Xhami thyhet lehtë dhe zhurma e tij mbaron shpejt, por ajo që ngel janë copëzat e tij, të cilat mund ta dëmtojnë atë që i prek.

E njëjta gjë ndodh edhe me fjalët që janë të rënda dhe ofenduese. Ato nga goja dalin shpejt dhe lehtë, por dhimbja që shkaktohet prej tyre qëndron gjatë si plagë në zemër. Prandaj, të flasim vetëm atë që është hair dhe e dobishme.

Surja El-Huxhurat na sjell disa porosi të arta, sa i përket asaj se si duhet të sillemi në jetë me të tjerët. Ato janë: -Lajmin ve-

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اجْتَنِبُوا كَثِيرًا مِّنَ الظَّنِّ إِنَّ بَعْضَ الظَّنِّ إِثْمٌ وَلَا تَجَسَّسُوا وَلَا يَغْتَبَ بَعْضُكُم بَعْضًا أَيُحِبُّ أَحَدُكُمْ أَن يَأْكُلَ لَحْمَ أَخِيهِ مَيْتًا فَكَرِهْتُمُوهُ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ تَوَّابٌ رَّحِيمٌ

49:12

رَحِيمٌ

rifikojeni mirë!; -Të jeni vëllezër dhe të jetoni të pajtuar!; -Të jeni të drejtë!; -Mos e tallni njëri-tjetrin!; -Mos shpifni për njëri-tjetrin!; -Mos e fryni njëri-tjetrin me llagape të ulëta!; -Largohuni prej dyshimeve të shumta!; -Mos e spiunoni njëri-tjetrin!; -Mos e përfolni njëri-tjetrin!

I nderuar vëlla, e nderuar motër!

Le t'i marrim këto porosi dhe t'i zbatojmë në jetë. Mos t'i harrojmë kurrë. Jo se unë i kam thënë, porse janë porosi të arta që dalin nga libri i artë, Kurani famëlartë, të vendosura nga Allahu i Lartë. Këto janë porosi të gjalla, për njerëzit e gjallë.

Ne nuk jemi të obliguar që t'i bëjmë të lumtur të gjithë njerëzit, por jemi të obliguar që asnjë njeri të mos e ofendojmë, të mos e nënçmojmë apo ta përbuzim. Këtu nuk ka përjashtim.

Surja Huxhurat dëshiron të na kthejë te natyrshmëria jonë, tek ajo që na bën të lumtur, te vetvetja jonë. Ne nuk themi sikur Albert Kamy, i cili thotë se “njeriu është krijesa e vetme e cila refuzon të jetë ajo që është”, por themi se kush e njuh Zotin dhe jeton me parime e vlera të shëndosha në jetë, ai është dhe mbetet vetvetja.

“MOS U TALL KËSHTU, GOMAR!”

Një bujk shkoi te fqinji i tij për t'i kërkuar një litar, për ta lidhur gomarin në oborr të shtëpisë.


Fqinji iu përgjigj se nuk kishte litar, por atë e këshilloi duke i thënë: “Ti mund të bësh të njëjtat lëvizje rreth qafës së gomarit dhe të shtresh se po e lidh dhe gomari nuk do të largohet prej vendit!”

Bujku veproi sipas këshillës së fqinjit.

Të nesërmen në mëngjes ai e gjeti gomarin po në atë vend ku e kishte lënë. Me dëshirë që të shkojë në fushë, bujku tentoi që gomarin ta vë në lëvizje, por për çudi të bujkut gomari nuk lëvizte nga vendi!

Bujku u përpoq me të gjitha forcat ta lëvizte gomarin, por pa dobi... derisa u dëshpërua nga moslëvizja e gomarit.

Kështu, bujku u kthye te fqinji, duke i kërkuar këshillë se si të veprojë. Fqinji e pyeti: “A i bëre gomarit sikur po ia zgjidh litarin?” Bujku u përgjigj me habi: “Ai fare nuk është i lidhur me litar!” Fqinji iu përgjigj: “Po, e vërtetë është siç thua



ti, por sa i përket gomarit, litar i është i mbështjellë në qafën e tij.”

Bujku u kthye dhe bëri sikur gomarit po ia zgjidhte litarin. Kështu, gomari nisi të lëviz pa asnjë rezistencë!

Bujku, i habitur, iu drejtua gomarit: “Mos u tall kështu, gomar!”

Porosia e tregimit: Njerëzit gjithashtu

mund të jenë të lidhur me “litarë” të zakoneve, apo të bindjeve të rrejshme të qarqeve të ndryshme, vetëm e vetëm që të mbahen në ëndrra. Ata, thjesht, duhet ta zgjidhin litarin e padukshëm që mbështillet rreth mendjes së tyre!

(Përshtati dhe përktheu nga gjuha arabe: Qufli Osmani)

NJË ÇËSHTJE QË HYN NË FUSHËN E IMANIT

Nëse do të kishte shenja të Kiametit, sigurisht që Allahu i Madhërishëm do t'i kishte përmendur ato në Kuran. Po të kishin ekzistuar këto shenja, Allahu i Madhërishëm në asnjë mënyrë nuk do t'i harronte ato.



Nga Prof. dr. Bajraktar Bajrakli

Më pas me shembuj të ndryshëm shpjegohet se Kiameti do të shpërthejë papritur. Tani mund t'i parashtojmë këto pyetje: Përderisa në ajetin 187 të sures Araf thuhet se dija në lidhje me Kiametin është tek Allahu, se Pejgamberi (a. s.) nuk ka njohuri për të, se dituria e tij (për ndodhjen) do t'u vijë rëndë tokës dhe qiejve dhe se do të ndodhë papritmas; ndërsa në ajetin 15 të sures Taha Allahu i Madhërishëm thekson se Ai pothuajse e ka fshehur edhe nga vetja diturinë për ndodhjen e tij; atëherë, a thua vallë Pejgamberi (a. s.) i ka numëruar në këtë mënyrë shenjat e Kiametit?

Shenjat e tjera të numëruara janë si më poshtë: Kiameti do të ndodhë në momentin kur do të shfaqet Jexhuxhi dhe

Mexhuxhi (Gogu dhe Magogu), kur të këqijat të shtohen; kur t'i kaplojë hapësirat fitneja/grindjet e vogla e të mëdha; kur lumi Euftrat të tërhiqet dhe një kodër prej ari do të mbetet në vend të tij dhe njerëzit të luftojnë për të; do të çlirohet Stambolli, të shfaqet dexhalli/antikrishti, do të zbres Isai, i biri i Merjemes dhe dy vëllezër myslimanë do të nxjerrin shpatat e do të luftojnë kundër njëri-tjetrit. Një zjarr do të dalë nga rajoni i Hixhazit që do të ndriçojë qafat e deveve këtu; pikërisht në këtë kohë do të kris Kiameti. A thua vallë ky transmetim i Ebu Hurejres mund të jetë i saktë/vërtetë? (Buhari, Fiten, 24); (Tirmizi, Fiten, 23; Buhari, İman, 22; Buhari, Kader, 4; Tirmizi, Fiten, 21)

Përpos kësaj, “nuk do të ndodhë Kiameti përderisa shpatat e fisit Devs të tun-

den/përthyhen rreth idhullit të Zu'l-Halasa”. (Buhari, Fiten, 23)

Këtë hadith e transmeton Ebu Hurejra nga Pejgamberi (a. s.). A thua vallë është e mundur që Pejgamberi (a. s.) të thotë një hadith të këtellë për Kiametin, i cili do të ndodhë papritur?

Nga ana tjetër, ata transmetojnë edhe këtë hadith: “Unë jam dërguar si pejgamber afër ditës së Kiametit, siç janë afër njëri-tjetrit këta dy gishta.” (Buhari, komentit i ajetit të parë të sures Naziat)

A thua vallë i thotë këto fjalë Pejgamberi (a. s.), i cili ka në dorë Kuranin që shprehet “...të pyesin, thua se ti di diçka për të, thuaj: këtë e di vetëm Perëndia...” (Araf, 187)

A thua vallë i thotë këto fjalë Pejgamberi (a. s.), i cili e di ajetin që vijon: “Njerëzit të pyesin për Kiametin e ti

thuj: Për atë e di vetëm Allahu! E ku mund ta dish ti, ai ndoshta është afër!”(Ahzab, 63)

KUR DO TË NDODHË KIAMETI SIPAS KURANIT

“Të pyesin ty kur do të ndodhë Dita e Kiametit. Thuaju: “Atë e di vetëm Zoti im. Kohën kur do të ndodhë ai do ta tregojë vetëm Ai. Njohuritë (lajmi i tmerreve të Ditës së Kiametit) do të jenë të rënda për qiejtë dhe për Tokën, do t’u vijë krejtësisht papritmas. Të pyesin, thuajse ti di diçka për të. Thuaj: “Këtë e di vetëm Perëndia; e shumica e njerëzve nuk e kuptojnë këtë (të vërtetë)”. (A’raf, 187)

Ajeti është shpallur pas një pyetjeje të parashtruar. Sa për atë se kush e bëri pyetjen, sigurisht që nuk ishte dikush nga ithtarët e librit (Ehlil Kitab), por me siguri dikush nga banorët e Mekës gjatë periudhës mekase të Pejgamberit (a. s.).

Në mënyrë të veçantë, nuk ka rëndësi se cili grup i njerëzve e parashtrori pyetjen. Nga folja *jes’elunke* “të pyesin”, vetëkuptohet se pyetësit ishin shumë, meqë folja në këtë ajet është përdorur në shumës.

Në fakt, çështja se kur do të ndodhë/shpërthejë Kiameti, është një nga çështjet që njerëzit e kanë të vështirë ta besojnë. Edhe pse njerëzit më lehtë dhe më qetësisht e besojnë Allahun e Madhërishëm, besimi i tyre në ndodhjen e Kiametit dhe ringjalljen pas vdekjes është një nga gjërat më të vështira për t’u besuar. Të pranojnë këtë të vërtetë dhe t’ua bëjnë të besueshme të tjerëve, është një temë që has në vështirësi.

Për këtë arsye, në ajetin 185 të sures Araf, duke e sjellë në rend dite/aktualizuar faktin e vdekjes, kërkohet të mendohet/meditohet dhe të bëhet një hap më afër çështjes së Kiametit. Kurani e shpjegon çështjen e ringjalljes pas vdekjes me ligje shkencore. Tani mund të kalojmë në analizën e ajetit.

“Të pyesin ty kur do të ngjajë Dita e Kiametit.”

Pyetjet e parashtruara ndonjëherë i përbëjnë arsyet për zbritjen e disa ajeteve të Kuranit fisnik. Kjo për mësuesit, edukuesit, ka një dimension të veçantë shembullor. Edhe nëse studentët bëjnë pyetje të papërshtatshme, nuk duhet të shmanget përgjigjja e tyre. Ata që bëjnë pyetje, tregojnë se i kushtojnë vëmendje temës dhe se dëgjojnë me veshët e tyre, por do të ketë nga ata që bëjnë pyetje të qëllimshme, të pakuptimta dhe anakronike. Por, rregulli që duhet ndjekur është ky: pyetja e bërë nuk duhet të mbetet varur, asaj

patjetër duhet t’i jepet përgjigjja.

Fjala *se’ele/jes’elune* që përmendet në ajet do të thotë “të pyesësh, të kërkosh, të hetosh, të lutesh dhe të kesh përgjegjësi”. Kjo pyetje që iu drejtua Pejgamberit (a. s.) vazhdon dhe do të vazhdojë të parashtrohet edhe në të ardhmen. Pra, pyetja do të vazhdojë të ruajë freskinë e saj. Ajeti gjithashtu na e mëson përgjigjen për t’u dhënë pyetjeve të parashtruara në këtë mënyrë.

Fjala *mursaha* që përmendet në ajet do të thotë “të vijë dhe të ndodhë, të shpërthejë, të kris”. Në ajetin 187 të kapitullit Araf shprehet se do të vijë dhe do të ndodhë/shpërthejë Kiameti. Kjo do të thotë se njerëzit kanë pyetur se kur do të vijë dhe do të ndodhë Kiameti. Kjo pyetje ka një histori shumë të vjetër. Meqenëse data e saktë nuk mund të jepet, kjo çështje hyn në fushën e imanit/besimit. Fjala *es-sa’at* që përmendet në këtë pjesë të ajetit i referohet “momentit të fundit të botës, krisjes së Kiametit”.

“Thuaju: Atë e di vetëm Zoti im. Kohën kur do të ndodhë ajo do ta tregojë vetëm Ai. Njohuria, (lajmi i tmerreve të Ditës së Kiametit) do të jenë të rënda për qiejtë dhe Tokën, do t’u vijë krejtësisht papritmas. Të pyesin, thuajse ti di diçka për të. Thuaj: “Këtë e di vetëm Perëndia; e shumica e njerëzve nuk e kuptojnë këtë (të vërtetë)”.

“Thuaju: Atë e di vetëm Zoti im.”

Njohuri, njoftime në lidhje me faktin se kur do të ndodhë Dita e Kiametit nuk e është dhënë as pejgamberëve. Mu për këtë arsye, është e panevojshme që njerëzit të hulumtojnë këtë temë dhe të harxhojnë energji në lidhje me këtë çështje. “S’ka dyshim se vetëm Allahu e di kur do të ndodhë Kiameti...”(Lokman, 34). “Kiameti gjithsesi do të vijë, aty nuk ka dyshim, por shumica e njerëzve nuk besojnë.” (Mu’min, 59)

Pse Allahu i Plotfuqishëm ua fshehu njerëzve dijen, njohurinë se kur do të vijë Kiameti? Përgjigjen e kësaj pyetjeje mund ta gjejmë në ajetet 15 dhe 16 të sures Taha: “S’ka dyshim se momenti (Kiameti) do të vijë patjetër, kohën e së cilës e kam mbajtur të fshehtë, (do të vijë) që të gjithë të shohin shpërblimin për mundin e tyre. Prandaj, të mos shmanget nga kjo, ai që nuk i beson atij dhe që është dhënë pas dëshirave, se atëherë shkatërrohet!”

JETA ËSHTË SPROVË; DALLOJNË TË MIRËT/TË KËQIJTË

Pra, sikur të dinin njerëzit për momentin e ndodhjes së Kiametit, nuk do të

kishte kuptim që jeta e kësaj bote të ishte sprovë, dhe nuk do të kishte dallim mes të mirëve dhe të këqijve, sikur pyetjet e provimit të njiheshin që përpara. Njohja e atyre që morën masa paraprake dhe atyre që nuk ishin të kujdesshëm, si dhe virtyti i kësaj do të zhdukej, fare nuk do të kishte kuptim.

Xhibrili (melaqja) e pyeti Pejgamberin (a. s.) se kur do të vinte Kiameti dhe e mori këtë përgjigje: “Ai që pyetet për Kiametin nuk është më i ditur se ai që pyet për të.” (Buhari, *Īman*, 37; Muslim, *Īman*, 1)

“Kohën kur do të ndodhë Kiameti do ta tregojë vetëm Ai.”

Nuk ka askush tjetër përveç Allahut të Madhërishëm që mund të zbulojë/tregojë kohën se kur do të ndodhë Kiameti. Fjala *telxhije* në këtë pjesë të ajetit do të thotë “dikush të nxjerrë diçka në shesh, të zbulojë diçka”. Ndërsa fjala *texhel-li*, do të thotë “shfaqja vetvetiu e diçkaje”.


Ashtu siç është në kompetencë të Allahut të Madhërishëm njohuria për momentin e ndodhjes së Kiametit, gjithashtu edhe kohën se kur do të ndodhë ai, vetëm Ai do ta zbulojë. Në ajetin 18 të sures Muhamed tregohet se Kiameti do të vijë papritur. Në ajetin 46 të sures Kamer tërhiqet vëmendja se Dita e Kiametit është më e tmerrshme/mundimshme dhe më e dhimbshme. Pra, edhe pse thuhet se do të jetë papritur një moment i tmerrshëm/mundimshëm dhe i dhimbshëm, përsëri koha e tij nuk është përcaktuar.

“Njohuritë për ndodhjen e tij do të jenë të rënda për qiejtë dhe Tokën, do t’u vijë krejtësisht papritmas.”

Allahu i Madhërishëm e shpjegon Kiametin sipas konceptit, dhe perceptimeve që kemi në trurin tonë, ndërsa duke treguar se Kiameti ka një peshë të rëndë, thotë se qiejt dhe toka nuk mund ta përballojnë këtë peshë.

Në suren Kari’a çështja e Kiametit shpjegohet në këtë mënyrë: “Goditja e tmerrshme (Kiameti)!, Çështje goditja e tmerrshme? Kush të tregon ty për goditjen e tmerrshme? Njerëzit, atë Ditë do të jenë të shpërndarë si fluturat, kurse malet si leshi i shprishur.” (Kari’a, 1-5)

“Kur Toka të dridhet me dridhjen e tmerrshme të saj, dhe kur ajo (Toka) të nxjerrë materiale nga brendia e saj, dhe njeriu të thërret: “çka ka ajo?!” atë Ditë ajo tregon lajmet e veta (veprat e mira dhe të këqija) që kanë ngjarë në të”. (Zilzal, 1-5) “Kur të shkyhet qielli, dhe kur të rrëzohen (derdhen yjet), dhe kur të përzihen detërat (njëri me tjetrin)...”(Infitar, 1-3). “Kur Dielli të humbë shkëlqimin, dhe kur yjet të rrëzohen (errësohen), dhe kur



malet të lëvizin...” (Tekvir 1-3) “...Me të vërtetë, dridhja e Ditës së Kiametit është ngjarje e madhe!” (Haxh, 1)

Nga të gjitha këto shpjegime kuptohet se forma e qiejve dhe e tokës do të ndryshojë plotësisht. Por, kjo nuk do të jetë një zhdukje e tërë, përkundrazi, do të jetë një ndryshim/transformim. “Në Ditën kur Toka do të ndërrohet me tokë tjetër, por edhe qiejt në tjerë qiej.” (Ibrahim, 48) Kjo do të thotë se pesha e goditjes/ndikimit në momentin e Kiametit do të sigurojë transformimin e qiejve dhe tokës. Në këtë transformim, bota e vdekshme dhe ligjet e qiejve do të bëhen të pavdekshme.

Ne, këtë “ardhje të rëndë për tokën dhe qiejt” mund ta shikojmë edhe nga një këndvështrim tjetër: Njohuria mbi ndodhjen e Kiametit dhe përcaktimi i kohës së tij u vjen rëndë atyre që janë në qiell dhe në tokë. Ky lajm/informacion ka një peshë të rëndë që do të trondit njerëzit dhe qiejt. Goditja e Kiametit, që do të ndryshojë tërësisht qiejt dhe tokën, do të vijë papritur. Fjala *bagte* në ajetin e lartpërmendur, i referohet këtij momenti. Kjo fjalë është në modalitetin e kohës së tashme, si infinitiv. Andaj, një nga shenjat se momenti i Kiametit nuk dihet, është, se ai do të vijë papritur.

c) “Të pyesin, thuajse ti di diçka për të.”

Fjala *hafij*, e cila rrjedh nga folja *hafa*, që do të thotë “të dish” në këtë pjesë të ajetit është përdorur në kuptimin “ai që di”. Kjo fjalë gjithashtu shpreh kuptimin “ai që shkon deri në ekstreme në parashtrimin e pyetjeve dhe vazhdon deri në

pikën e fundit”. Kjo pjesë e ajetit nxjerr në pah faktin se, është një rregull, se si parashtrohet pyetja. Pyetja do të mbetet pa përgjigje nëse personi i pyetur nuk ka ndonjë njohuri/informacion të ndryshëm nga pyetësi. Kështu, Allahu e ruan autoritetin/kompetencën për të folur në lidhje me Kiametin. Tradita e parashtrimit të pyetjeve atyre që nuk dinë vazhdon ende. Kjo traditë përpiket të kontaminohet me ndytësi sferën e të vërtetës (hakikatit).

“Thuaj: “Këtë e di vetëm Perëndia.”

Kjo shprehje përdoret dy herë në të njëjtin ajet. Në të parën thuhet “(dija është) në praninë e Zotit tim”, në të dytën thuhet “në praninë e Allahut”.

dh) “E shumica e njerëzve nuk e kuptojnë këtë (të vërtetë).”

Sipas neve, ajo që njerëzit nuk e dinë këtu nuk është se kur do të shpërthejë Kiameti apo mënyra se si do të ndodh ai, por pse Kiameti të fshihet nga njerëzit. Nga ana tjetër, theksohet se njohuritë e njerëzve nuk do të jenë të mjaftueshme në këtë drejtim.

Si përfundim, mund të themi se sistemet filozofike nuk mund të jenë fe, meqë në lidhje me Kiametin dhe çfarë do të ndodhë brenda asaj ndodhie nuk flitet dhe nuk mund të diskutohet rreth tij. Pikëpamjet njerëzore që nuk kanë besim/iman në botën tjetër-Ahret, që nuk flasin për atë jetë dhe që nuk njohin xhennet apo xhehenem, nuk mund të jenë fe. Feja flet për ahretin, vendon si kusht besimin në ekzistimin e dënimit dhe shpërblimit, dhe ndodhjen e Kiametit e përfshin brenda parimeve të saj themelore/bazë.

Feja fillon me besimin në Një Zot (teuhid) dhe përfundon me besimin në botën tjetër (ahret). Do të vlerësohen të gjitha sjelljet dhe veprimet që janë bërë ndërmjet pikës fillestare - besimit në Një Zot dhe besimit në botën tjetër/ahretit, qofshin ato të fushës mendore/intelektuale, veprimeve me zemër apo aktivitete shpirtërore. Besimi në Teuhid i transferon veprimet, fjalët dhe qëllimet tona në botën tjetër/ahret dhe siguron që ato të vlerësohen atje. Kjo është arsyeja pse çështja e besimit në njëshmërinë e Zotit është shumë e rëndë. Gjëja që do ta lehtësojë këtë peshë është sinqeriteti.

Në një ajet tjetër Allahu i Madhërishëm kështu thotë: “Po ata a presin tjetër, pos Kiametit, i cili do t’u vijë befaz. Pa dyshim që ardhja e tij tashmë është lajmëruar. E kur të vijë Kiameti, çfarë do t’iu ndihmojë atyre që t’iu kujtohen mëkatet e tyre të kaluara?” (Muhammed, 18)

Meqë jobsimtarët nuk besojnë se do të vijë Kiameti, se ekziston Ahreti dhe se ne do të ringjallemi pas vdekjes, ata me tallje presin ardhjen dhe ndodhjen e Kiametit. Në një farë mënyre, ata thonë: “Nëse do të kris, le të kris tani!”. Për shkak të këtij mohimi, ata vazhdimisht parashtronin pyetje në lidhje me Ditën e Kiametit (Araf 187; Ahzab 63). Fjala *bagta* në këtë ajet do të thotë “papritmas”.

“Pa dyshim që ardhja e tij tashmë është lajmëruar.”

Dijetarët këtë pjesë të ajetit e interpretojnë si vijon: “Shenjat e tij tashmë kanë ardhur”. Fjalën “*eshrat*” që përmendet në këtë ajet e kanë interpretuar si



“shenjë”. Sipas mendimit tonë, përktimi i kësaj fjale në kuptimin e “lajmit” të dhënë nga Muhamed Assad është më i saktë. Kurani në shumë ajete të tij e ka aktualizuar çështjen e Ditës së Kiametit dhe e ka vendosur në baza të moralit. Në këtë aspekt, do të ishte më e saktë që fjala e lidhur me këtë temë (*eshrat*) të marrë kuptimin “Kurani lajmëron për të”. Meqenëse Allahu i Plotfuqishëm në suren Taha, në ajetin 15, thotë se Ai “pothuajse do ta fshehtë kohën e tij nga vetja”, andaj a thua vallë ngelën ndonjë fshehtësi e sendit, shenjat (kushtet) e së cilës janë plotësuar? Në suren Araf në ajetin 187 përmendet se ai do t’u vijë njerëzve papritmas; A mund të flitet për ardhjen e papritur për një gjë parashenjat e cilës veç më janë të njohura? Prandaj është e nevojshme që fjala *eshrat* në ajetin 18 të sures Muhamed të interpretohet si “lajm”.

“E kur të vijë Kiameti çfarë do t’iu ndihmojë atyre që t’iu kujtohen mëkatet e tyre të kaluara?”

TË BESOSH PARA FUNDIT TË BOTËS...

Ajeti pyet kur të vijë Kiameti çfarë dobie do t’u bëjë atyre të kujtojnë mohimet ose mëkatet e tyre, të mendojnë rreth këtyre fakteve dhe të marrin mësim. E rëndësishme është të besosh në të para fundit të botës, (para se të kris Kiameti). Kur të vijë Dita e Kiametit, nuk ka kthim prapa për të. Prandaj, pas kësaj, jobsimtarëve në asnjë mënyrë nuk do t’iu ndih-

mojë as pendimi që do të ndiejnë ata. Kur të vijë Dita e Kiametit, përsiatja dhe marrja mësim dhe kujtimi i së vërtetës fare nuk do të ndihmojnë. Kështu, pra, ajeti tërheq vëmendjen për faktin se fundi i atyre që mohojnë Kiametin është pendimi dhe dëshpërimi.

Çështja po qëndron si mal para mësim/arsimit dhe mësuesve/arsimtarëve fetarë, andaj puna është që njerëzit t’i edukojmë të besojnë në çështjen e Kiametit, në ringjalljen pas vdekjes, në jetën e përtejme, në dënimin dhe shpërblimin e ahiretit. Realizimi i këtij imani/besimi do të thotë forcim i themeleve të moralit dhe vendosje e një disipline të re në sjellje.

Nga ana tjetër, Allahu i Plotfuqishëm në ajetin vijues i qaset temës në këtë mënyrë:

“Njerëzit të pyesin për kohën e ndodhjes së Kiametit, thuaju: Dijenia për të është vetëm tek Allahu. E, ku mund ta dish ti, ai ndoshta është afër.” (Ahzab, 63)

E rëndësishme këtu është fakti se ata pyesin për fundin e botës (Kiametin) duke e mohuar atë. Kjo pyetje përmendet edhe në suren Araf, në ajetin 187. Ata e pyetën Pejgamberin (a. s.) sikur ai e dinte kohën e tij.

Meqenëse njerëzit nuk mund ta imagjinonin se universi do të shkatërrohej dhe një jetë tjetër nga ajo do të krijohet, ata bënë të njëjtën pyetje që theksohet edhe në ajetin 42 të sures Naziat. Ka pyetje që parashtrihen për të mësuar, por ka pyetje që bëhen për të mohuar (inkar) dhe për të tallur çëshjen e diskutuar. Të dyja situatat

kanë të bëjnë me temën kur është në pyetje çështja e Ditës së Kiametit.

Pavarësisht nga mënyra dhe qëllimi i njeriut për të parashtruar pyetje, Allahu i Madhërishtëm i përgjigjet pyetjes. Në edukimin hyjnor, qëllimi i “përgjigjes së pyetjeve dhe ndriçimi i çështjes në mendjet e njerëzve” është një metodë shumë e rëndësishme edukativo-arsimore.

Sipas kësaj pjese të ajetit, askush nuk e di kohën se kur do të ndodhë Kiameti, përfshi këtu edhe Pejgamberin (a. s.); “Ti nga e di atë që ti njoftosh të tjerët? Vetëm Zoti yt (përfundimisht) di për të.” (Naziat, 43-44)

Nga këto fakte nxjerrim përfundimin e mëposhtëm: Lajmet e shpikura në lidhje me ndodhjen e Kiametit, shenjat e numëruara dhe shpjegimet e dhëna janë krejtësisht të rreme.

Allahu i madhërishtëm lajmin për ndodhjen e Kiametit e quan “lajm i madh”. Në lidhje me këtë ajetet flasin në këtë mënyrë: “Për çka pyesin ata njëri-tjetrin? A për lajmin e madh, për të cilin ata kanë mendime të ndryshme? Jo, të mos pyesin, ata do ta kuptojnë në të ardhmen. Përsëri jo, se ata do ta kuptojnë.” (Nebe, 1-5)

Pra, lajmi i madh që i bën njerëzit të kenë divergjenca në mendime, të polemizojnë, diskutojnë dhe të sërish mos pajtohen është çështja e “ringjalljes pas vdekjes”. Një nga çështjet më të vështira për t’u zgjidhur dhe për të besuar në të, në historinë e njerëzimit ka qenë çështja e ringjalljes pas vdekjes, përkatësisht nëse ka apo jo një jetë të përtejme.

Vlerësimin se ky është një lajm i madh e bën vet Allahu i Madhërishtëm në Kuranin fisnik. Fjala që përmendet në këtë ajet *El-adhim* do të thotë “i madh”, por gjithashtu ka kuptimin edhe “i rëndësishëm”. Ky atribut plotësues mund të interpretohet si “lajm i madh”, por gjithashtu mund të përktet edhe si “lajm shumë i rëndësishëm”. Mushrikët, të cilët ishin në dyshime në lidhje me temën e një lajmi kaq të madh e kaq të rëndësishëm (Haxh, 5), u futën në grindje dhe polemizuan me njëri-tjetrin. Si duket ka mundësi të ishin futur në polemika dhe mospajttime tre grupe të njerëzve: besimtarët, ata që dyshonin dhe mohuesit.

Ndërsa foljes *seja’lemun* që përmendet në të dy ajetet e lartpërmendura, ndonëse duhet t’i jepet kuptimi “ata do ta dinë”, mirëpo ne e kemi parë të përshtatshme t’i japim kuptimin “ata do të kuptojnë”. Kur ata të kthehen në jetë/ringjalljen pasi të kris Kiameti, kur të vlerësohen veprat e tyre dhe të ndahen mëkatet dhe banorët e Xhenetit, ata do ta kuptojnë të vërtetën në një mënyrë që nuk mund ta mohojnë saktësinë/vërtetësinë e atij lajmi të rëndësishëm. Dyshimet e tyre do të zhduken dhe me siguri ata do ta dinë me një dije të prerë.

NË KURAN NUK JANË DHËNË SHENJAT

Ne nga këto dy ajete nxjerrim këtë përfundim: Çështja e dijes së këtij lajmi

do të ndodhë në botën tjetër; Ndërsa në këtë botë, ne kemi mundësi të besojmë, “të kemi iman” në lidhje me ringjalljen pas vdekjes dhe jetën në ahiret. Pra, ti “beson” në gjërat të cilat nuk i sheh me sytë e tu, nuk i prek dot me duar dhe nuk mund t’i provosh, por për atë që e sheh themi që “e di”. Në këtë mënyrë, Allahu i Plotfuqishëm njëkohësisht tregon dallimin mes çështjes së dijes dhe besimit. Në momentin që do të ndodhë ringjallja pas vdekjes, ajo do të shndërrohet në dije, por ne në këtë botë duhet ta besojmë atë; Kjo është situata që përcakton kufirin e besimit/imanit dhe diturisë, imanit dhe njohjes. Asnjëherë nuk duhet harruar se ka një kalim nga dituria në besim dhe nga besimi në dituri.

Si përfundim, mund të themi se, Allahu i Plotfuqishëm a nuk mund t’i theksojë parashenjat e Kiametit kur e ka trajtuar çështjen e tij në Kuranin fisnik? A guxojmë të themi se Allahu i Madhërishtëm i ka harruar t’i numërojë shenjat e Ditës së Kiametit? Meqenëse Allahu i Plotfuqishëm nuk i shpjegon, nuk i përmend fare shenjat e Kiametit në Kuran, atëherë a thua vallë nga vijnë këto shenja-besëtytni që theksohen në mënyra të ndryshme? Ne mund t’u përgjigjemi këtyre pyetjeve në këtë mënyrë. Nëse do të kishte shenja të Kiametit, sigurisht që Allahu i Madhërishtëm do t’i kishte përmendur ato në Kuran. Po të kishin ekzistuar këto shenja, Allahu i Madhërishtëm në asnjë mënyrë nuk do t’i harronte ato.

Këto shenja të shpikura burojnë nga literatura dhe kultura hebreje e njohur si “*israilijat*”. Më lart, ne i dhamë referencat duke treguar vendin se ku numërohen këto shenja në Bibël. Këto besëtytni, të cilat erdhën nga *israilijetet*, më vonë u transferuan/shndërruan në hadith të Pejgamberit (a. s.) dhe në këtë mënyrë siguruan pranimin e tyre në mesin e myslimanëve. Ata ua treguan njerëzve një gjë që nuk e kishte thënë Pejgamberi (a. s.) sikur ta kishte thënë ai. Shenjat e Kiametit mund t’i radhis e t’i numërojë Allahu i Plotfuqishëm, i cili zaten do të vendosë për fundin e botës (për krisjen e Kiametit). Apo Allahu i Plotfuqishëm i tha dikujt tjetër: “Unë do të vendos për fundin e botës (krisjen e Kiametit), e ti përcakto shenjat e tij”? A ka mundësi që vendimin ta marrë Vetë, e paralajmërimin e shenjave t’ia lë dikujt tjetër? Të thuash diçka që nuk është përmendur në Kuran për këtë çështje, do të thotë të shpifësh për Allahun e Plotfuqishëm. Në një farë mënyre, është një përpjekje/pretendim për t’i mësuar fenë Allahut, siç theksohet në suren Huxhurat, në ajetin 16. Ose, siç është fakti në suren Junus, në ajetin 18, një pretendim që të informosh Allahun për diçka në qiej dhe në tokë, kinse Ai nuk e di.

(Marrë nga libri “*Kuransız Müslimanlık*”, shtëpia botuese “*Düşün Yayıncılık*”, Stamboll, 2019, botimi i 6-të. Përktheu nga turqishtja: dr. Selver Xhemali)

PËRURORHET QENDRA KULTURORE NË BARBULLUSH

Në kuadër të Natës së Madhe të Israsë dhe të Miraxhit, më 27 shkurt, 2022, në fshatin Barbullush u zhvillua ceremonia e përvitimit të Qendrës Kulturore pranë xhamisë së kësaj zone, thuhet në njoftimin e Myftinisë së KMSH-Shkodër.

Nderonin me praninë e tyre: drejtuesi për Ballkanin i fondacionit “Rahmeh International” në Kuvajt z. Isa Dhewadi, drejtori i fondacionit “Mirësia” z. Korab Kaja, drejtori i fondacionit “Mirënjohja” z. Samed Shehu etj.

I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman, h. Bujar Spahiu, me bashkëpunëtorë; Myftiu i Malësisë së Madhe, h. Edmir Smajlaj, si dhe drejtues të shoqatave islame brenda dhe jashtë Shqipërisë, imamë, besimtarë etj.



Autoritetet dhe të gjithë të pranishmit vizituan nga afër ambientet e brendshme dhe klasat e kësaj qendre të

bukur, me të gjitha kushtet bashkëkohore, thuhet në njoftimin e Myftinisë së KMSH-Shkodër.



KONCEPTI I TEUHIDIT DHE IMPLIKIMET E TIJ ETIKE



Roli i kësaj shkolle është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e mendimit filozofik-teologjik. Ata kanë ndikuar edhe tek ata që i kritikojnë. Idetë e tyre ruhen më së shumti te kritikantët e teologëve të ndryshëm, sepse pjesa më e madhe e shkrimeve të tyre nuk është ruajtur.



Shkruan: Hasan Xhillo

Koncepti etik i mu'tezilëve së pari mbështetet në konceptin e lirisë dhe të përgjegjësisë së njeriut. Liria dhe përgjegjësia e njeriut janë të lidhura ngushtë me konceptin e njëjës (teuhidit) dhe të drejtësisë së Zotit. Në fakt, diskutimi për drejtësinë vjen menjëherë pas diskutimit për njëjës dhe krijimin. Diskutimi për vullnetin e lirë të njeriut supozohet me konceptin e fuqisë krijuese, në mënyrë të tërthortë: të botës dhe të dukurive në të, të varur nga providenca dhe krijimi i Zotit. Mu'tezilët janë të paarritshëm në qëndrimin e tyre se njeriu është qenie plotësisht e lirë dhe, si rezultat i kësaj, krijues i veprave ose i veprimeve të veta. Disa prej tyre i dëgjuan predika-

met e Hasan Basriut, i cili foli për individualitetin dhe përgjegjësinë e njeriut; se njeriu si individ i takon jeta e tij dhe vdekja e tij; se askush nuk e jeton jetën e dikujt tjetër dhe nuk e shijon vdekjen e vet të vdekjes, siç përmendet edhe në Kuran (shih: Bedevi 1975).

Duhet të theksohet se mu'tezilët ishin filozofët e parë të cilët iu qasën në mënyrë sistematike problemit të lirisë dhe të përgjegjësisë së njeriut në Islam. Sipas këndvështrimit të tyre të përgjithshëm, drejtësia e Zotit, si një parim i konceptit të debatit të tyre - edhe pse paraqiten me qëndrime të ndryshme - është koncepti mbi të cilin themelohet liria dhe përgjegjësia e njeriut. Sa i përket lirisë, ata trashëguan dy koncepte: atë që nënkupton

se njeriu është plotësisht i lirë (kaderitë) dhe atë që thekson se çdo gjë është e caktuar nga Zoti (xheberitë).

Debatet për lirinë e njeriut ishin gjithmonë të pranishme, sepse bëhet fjalë për një çështje e cila e prek edhe jetën shoqërore ose politike. Disa e përdorën çështjen e lirisë për të justifikuar mënyrën e tyre të qeverisjes me jetën e përbashkët, duke pretenduar se çdo gjë është në dorë të Zotit, e ata që iu ishte marrë e drejta në shumë gjëra, kërkoi që të hapet çështja e lirisë, në realitet, e veprimeve të njeriut. Mu'tezilët e mbanin anën e kaderive, të cilët konsideronin se njeriu është plotësisht i lirë në atë që bën dhe ofrojnë argumentet e tyre.

Drejtësia është cilësi e Zotit

Në të vërtetë, çka nënkuptohet me drejtësinë e Zotit? Vetë mendimi për drejtësinë e Zotit hap perspektivë të re. Drejtësia është cilësi e Zotit, si edhe cilësitë e tjera; dhe ajo, pasi që është e përgjithshme ose gjithëpërfshirëse, e përcakton kornizën që "të flasim për domosdoshmërinë e lirisë së njeriut dhe zgjedhjen e tij" (Jahja 1969: 232). Kur thuhet "drejtësia e Zotit", me të nënkuptojmë edhe atë që është në qiej edhe atë që është në tokë, dhe jo diçka që e krijoi njeriu, në mënyrë subjektive ose objektive, e cila do të vlejë për disa, e nuk do të vlejë për të tjerët. Këtu pikërisht gjendet parimi i lirisë së njeriut për të cilin flasim mu'tezilët. Drejtësia e Zotit nuk ka vetëm dimensionin arsimor ose shoqëror, por ajo është edhe fakt metafizik, mbështetet në vetë komunikimin, në relacionet që i vendos njeriu me Qenien e Zotit (po aty).

Koncepti i krijimit të mu'tezilët, që ndodh përmes cilësive, moduseve ose gjendjeve, tregon se, megjithatë, bëhet fjalë për aktet hyjnore. Në të njëjtën mënyrë, mund të vijmë në përfundim se fuqia dhe liria e njeriut janë akte të fuqisë dhe të lirisë së Zotit. Mu'tezilët sjellin argumentin vijues: fuqia e njeriut për të krijuar vepra vjen nga Zoti, siç vjen edhe zgjedhja e lirë. Nuk bëhet fjalë për faktet pa vënë lidhjen e tyre me cilësitë, moduset dhe gjendjet, për të cilat kemi folur si ndodhi - qofshin ato në mënyrë të tërthortë, ose të drejtpërdrejtë.

Kemi fituar bindjen se cilësitë e Zotit, në fakt, janë relacione të krijuara në botë, të cilat nuk kanë ekzistencë të pavarur nga Qenia e Zotit. Prandaj, Osman Jahjai vjen në përfundim se drejtësia është "shprehje e njëjës së Qenies, në të vërtetë, shprehje aktive e realitetit për shkak të ekzistencës së Zotit dhe përsosurisë së Tij të përjetshme". Gjithashtu, zgjedhja e lirë është për shkak të njeriut: "ai është shprehje e unitetit të individëve dhe simbol i përkryerjes së ekzistimit dhe pavarësisë së tij" (po aty: 231). Përsosuria e njeriut, mes tjerash, është edhe në participimin e tij në atë shprehje, siç është drejtësia e Zotit, e cila barazohet në konsekuencën e fundit me esencën e Zotit, si dhe me cilësitë ose moduset tjera. Mu'tezilët edhe në këtë drejtim zbatojnë parimin e përkryerjes dhe fuqizimit të vazhdueshëm të virtyteve. Ata jo vetëm që thirren përfaqësues të njëjës (teuhid), por asaj i shtojnë edhe "përfaqësues të drejtësisë" (ahlu at-tevhid ve al-adl). Mu'tezilët janë mjaft të interesuar edhe për integritetin e njeriut, ku fuqia racionale luan rolin kryesor.

Së pari duhet të përgjigjemi në pyetjen se prej nga vjen drejtësia e Zotit, në të cilën mbështetet edhe liria e njeriut. Nëse drejtësia është veçori e Zotit, në atë rast ajo paraqet fakt ontologjik, prezanton shprehjen e Zotit, si edhe shprehjet e tjera që dalin nga akti i Tij krijues. Vetë formulimi "drejtësia e Zotit", të udhëzon në atë se ka të bëjë me diçka që përmbahet në sferën e konceptit të Zotit, dhe në këtë mënyrë edhe liritë që mbështeten në këtë drejtësi, si fakte, nuk i janë lënë vetvetes pa bazë. Këtu aspak nuk është me rëndësi se a janë cilësitë e Zotit të përjetshme. Rolin kryesor e luajnë relacionet ose komunikimet e këtyre cilësive hyjnore që e mbajnë realitetin objektiv. Por, çështja e lirisë së njeriut, megjithatë, devijon nga koncepti i shkakësisë, për të cilin flasim Muameri dhe Nazzami. Nuk ka asnjë nga mu'tezilët që nuk flet për atë se njeriu i krijon veprat e tij, të mira ose të këqija. Njeriu e trajtojnë plotësisht të lirë në veprimet e tij; atë e konsiderojnë përgjegjës dhe nuk pranojnë involvimin e Zoti në të, sepse në të kundërtën, përgjegjësia e njeriut është e pakuptimtë në Ditën e Gjykimit. Vetë fakti që diçka urdhërohet e diçka ndalohet, flet për natyrën faktike të lirisë së njeriut. Njeriu, sipas mu'tezilëve, ka fuqinë, lirinë dhe zgjedhjen, të cilat i harmonizon me lirinë, me fuqinë dhe me zgjedhjen e Zotit. Nëse Zoti krijon për shkak të urtësisë, atëherë perceptimi racional i njeriut, qëllimi i të cilit është urtësia, mund të kuptojë edhe urtësinë e gjërave që ndodhet në vetë gjërat dhe të bëjë dallimin mes së mirës dhe së keqes dhe kështu mund të vendosë mes këtyre dyjave.

GJYNAHU, REZULTAT I QËLLIMIT

Kreacioni në përgjithësi, sipas mu'tezilëve, përmban në vete kuptim dhe vlerë. Zoti nuk e do të keqen dhe e gjykon atë. Nuk mund në të njëjtën kohë të krijohej dhe të dënohet, sepse kjo është në kundërshtim me konceptin e Tij për të mirën dhe drejtësinë. Atë që e bën njeriu i urtë, e bën për shkak të urtësisë; atë që bën njeriu i mirë, e bën për shkak të mirësisë; atë që e bën njeriu i sinqertë, e bën për shkak të sinqeritetit. Njeriu si qenie racionale ka fuqi të brendshme, me anë të së cilës e njeht se çka është e mirë e çka është e keqe. Për këtë nuk i duhet atij kurfarë autoriteti. Për këtë arsye, liria e njeriut dhe fuqia e tij përfaqësojnë ndodhitë të cilat burojnë nga fuqia dhe liria e Zotit. Në fakt, njeriu u krijua me lirinë dhe mundësitë që nuk ia ka borxh vetvetes. Por, perceptimi i tij racional, thotë Vasil

ibn Ata, është i vetëdijshëm për fuqinë dhe zgjedhjen e tij dhe e di se ato vijnë nga Zoti. Vallë, a do të bëjë njeriu mirë apo keq, varet nga qëllimet e tij. Prandaj, gjynah konsiderohet çdo veprim që është rezultat i qëllimit. Mu'tezilët, urdhrin e Zotit për të urdhëruar të mirën dhe për të ndaluar të keqen e përcjellin edhe në jetën publike dhe në institucionet e saj. Bëhet fjalë për konceptimin kuranor të veprave të mira, prej të cilit (konceptim) varet fati i njeriut në amshueshmëri.

Mësimet e mu'tezilëve për veprimet e njeriut, se ato varen nga vetë njeriu, nga liria e tij dhe se Zoti nuk ka "gisht" në këto, janë të lidhura ngushtë me këndvështrimin e tyre për aksidencat, te të cilat Zoti nuk ka ndikim. Nëse gjithçka në natyrë është e mbushur me moduse dhe me gjendje, ashtu edhe veprimet e njeriut ndodhin për shkak të fuqisë dhe të lirisë së zgjedhjes së vetë njeriut.

E mira dhe e keqja, sipas mu'tezilëve, janë refleks të veprimeve të njeriut dhe nuk hyjnë në sferën e dispozitave të Zotit. Këtë më së miri e pasqyrojnë urdhëresat dhe ndalesat e Tij. Nuk do të jetë gabim nëse thuhet se e mira dhe e keqja janë gjëra mendore, ato ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga ndarjet e tyre dhe, sapo të zbatohen ose të marrin formën e jashtme, me atë që i shtohen diçkaje, kemi gjëra të mira ose të këqija. Një prej argumenteve të mu'tezilëve është edhe ky: "E mira dhe e keqja janë ose dy gjëra që shtohen, kështu që diçka është e mirë duke i shtuar asaj të mirën, kurse e keqe është duke ia shtuar atë ndonjë gjësendi dhe ajo bëhet e keqe, ose janë dy gjëra të përcaktuara, dhe kështu e bukura dhe e shëmtuara, e mira dhe e keqja brenda tyre pikënisjen e kanë në dëshminë e atij i cili përcakton që diçka të bëhet, ose diçka të mos bëhet" (shih: Dgheimi 1998: 653-654). Çfarë forme do t'i japë njeriu gjërave, varet nga zgjuarsia ose nga gjykimi racional i tij dhe kjo përjashton çfarëdo involvimi të autoritetit të jashtëm. Këtu problemi i së mirës dhe i së keqes është çështje etike dhe jo metafizike. Prandaj, problemi i së keqes është i lidhur me vullnetin dhe lirinë e zgjedhjes së njeriut.

Edhe e mira edhe e keqja, shpjegojnë mu'tezilët, janë të krijuara, e kjo do të thotë ose diçka do të bëhet ose nuk do të bëhet, dhe kjo është e barabartë me ekzistencën ose joekzistencën edhe të njërës, edhe të tjetrës. Ose, thënë më thjeshtë, nuk ka duar ose këmbë të mira ose të këqija, por këto bëhen të mira ose të këqija duke sjellë në to të mirën ose të keqen, të cilat janë shprehje e vendimit të lirë të njeriut.

Mësimet e shkollës mu'tezilite hasën në reagime të ndryshme. Disa i kritikojnë ashpër, e të tjerët i përkrahin, varësisht nga dëshira e tyre për të diskutuar për çështjet dogmatike. Megjithatë, edhe në rastin e parë, edhe në rastin e dytin roli i kësaj shkolle është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e mendimit filozofik-teologjik. Ata kanë ndikuar edhe tek ata që i kritikojnë. Idetë e tyre ruhen më së shumti te kritikantët e teologëve të ndryshëm, sepse pjesa më e madhe e shkrimeve të tyre nuk është ruajtur. Madje, nuk ka asnjë shkollë tjetër që provokoi një ortek kaq të madh kritikash drejtuar racionalizmit të tyre, siç është rasti me këta. Në mësimin e tyre gjejnë shtytje edhe filozofët racionalistë, edhe iluministë. Disa mësimet i pranojnë edhe teologët (mutekellimunë), të cilët i përkasin kampusit të shkollës esh'arite. Vetë Esh'ari ishte nxënës i Xhubaiut dhe i pranoi disa qëndrime të tij. Shpirti i tyre liridashës dhe kritik, ka stimuluar formacione të forta të shpirtit të njeriut te një numër i madh i filozofëve islamë, për shembull, siç janë: Fahrudin Razi (mbi nocionin e esencës), El-Kindiu, El-Farabiu dhe Ibn Sina (mbi esencat e paaktualizuara), Ibn Arebiu (mbi esencat e palëvizshme, të vetë-pushuarit) dhe në kohën e fundit Muhamede Abduhu (mbi përdorimin e argumenteve shkencore ose racionale në argumentimin e njësë së Zotit). Kanë ndikim të madh edhe te disa filozofë he-

brej në botën islame, për shembull, siç është Majmonidi (në çështjen e drejtësisë hyjnore dhe të lirisë së njeriut). Kjo shkollë karakterizohet me një mori detajesh për lëndën e diskutimit të tyre, e dëshmitar i kësaj, sa kemi mundur të vërejmë, është mësimi i tyre mbi transcendençën e Zotit; ose mbi lidhjen e njëshit dhe të shumësit si çështje rrënjësore filozofike.

(Autori është Profesor në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup)

Literatura:

- Bagdadi, Abu Mansur (b. d.), Al-Farku bejn al-firek, Bejrut, Dar al-marifa.
- Nader, Albert N. (1956), Le System Philosophique des Mu'tezila, Bejrut.
- Afifi, Ebu al-Ala (1969), „Al-Ajan ath-thabita fi mezhebi Ibn Arebi ve al-madumat fi mezhebi al-mu'tezila“, në: Ibn Arebi, Muhjiddin, Al-Kitab at-Tizkari (fi adh-dhikra al-muvijet es-samini li miladihi), Kajro, Al-Haj'at al-misrija al-amm li et-telif ve en-nashr.
- Tusi, Nasirudin (1985), Talhis al-muhassal, Bejrut, Dar al-adva.
- Ešari, Abul-Hasan (1929), Kitabu makalat al-islamijin va ihtilaf al-musallin, edited by Hellmut Ritter, Istanbul.
- Shahrestani, Abul-Fath Muhammad ibn Abdulkarim (1994), al-Milal va an-Nihalu, Bejrut, Muassasatu kutubi eth-thekafija.
- Shahrestani, Abul-Fath Muhammad ibn Abdulkarim (b. d.), Nihajetu al-akdam fi ilmi al-kelam, b. m.
- Bedevi, Abdurahman (1975), Tarihu at-tasavuf al-islami (min bidajeti hatta al-karni

- as-sani), Kuvajt, Vikaletu al-metbua.
- Frank, Richard M. (1982), „Attribute, Attribution, and Being“ in: Philosophies of Existence (Ancient and Medieval), edited by Parviz Morewedge, New York, Fordham University Press.
- Gardet, L. & Anawati, M. M. (1968), Introduction a la theologie musulmane, Aspects et tendances – Experiences et techniques, 2 ed. Paris.
- Dgheim, Samih (1998), Encyclopedia of Islamic Theology Terminology, Bejrut, Librairie du Liban Publishers.
- Gilson, Etienne (1952), Being and Some Philosophers, Toronto, Pontifical Institute of Medieval Studies, 2nd Edition.
- Ibn Hazm (1975), Al-Fasl fi al-ahval va al-milel ve an-nihel, tom IV, Bejrut, Dar al-Marifa.
- Jahja, Osman (1969), „Nususun tarihiyatun hasatan bi nazarijat at-tauhid fi at-tafkir al-islami“, në: Ibn Arebi, Muhjiddin, Al-Kitab at-Tizkari (fi az-zikra al-muvijet es-samini li miladihi), Kajro, Al-Haj'at al-misrija al-amm li et-telif ve en-nashr.
- Madkur, Ibrahim (2003), Fi al-falsafe al-islamiya, tom II, Kajro, Dar al-ma'arif.
- Morewedge, Parviz (1982), „Greek Sources of Some Near Eastern Philosophies of Being and Existence“, in: Morawedge, Parviz (ed.), Philosophies of Existence (Ancient and Medieval), New York, Fordham University Press.
- Мухий, Ферид (1997), Смыслата и доблеста, Битола, Универзитет „Св. Климент Охридски“.
- Razi, Fahrudin (1992), Mealim al-usul ad-din, Bejrut, Dar al-fikr al-Lubnani.
- Watt, W. Montgomery (1985) Islamic Philosophy and Theology, Edinburg.
- Wolfson, Harry Austryn (1974), The Philosophy of Kalam, London, Harvard University Press Cambridge, Massachusetts.

RËNDËSIA E SHKENCËS SË AJETEVE MEKASE DHE MEDINASE

Da'veti tek Zoti i Madhërishtëm është art profetik, i lartë, profesion i ndershëm dhe vepër e shenjtë, dallohet me shije të posaçme kuranore, të cilën mund ta shijojë realisht vetëm ai që jeton në kopshtin e tij dhe nën hijen e drurëve të tij, në ajrin e pastër të tij dhe nëse e pi ujin e tij të kristaltë. Da'veti ka nevojë për metodë konkrete ndaj çdo lloji të amoralitetit në fe, besim, ligj, krijesë e sjellje.



Shkruan: Prof. dr. Hajredin Hoxha

Kurani fisnik nuk është shpallur përnjëherë, por i ndarë sipas ngjarjeve dhe rrethanave. Shpallja e tillë përmbante në vete parime, fshehtësi, leksione dhe mësimet, për të cilat do të kisha folur gjerë e gjatë sikur të mos ishte natyra e kufizuar e këtij studimi. Zoti i Madhërishtëm thotë: *“E ata që nuk besuan thanë: ‘Përse të mos i ketë zbritur atij (Muhamedit) Kurani përnjëherë?’ Ashtu (e zbritëm pjesë-pjesë), që me të ta forcojmë zemrën tënde dhe Ne e sollëm atë ajet pas ajeti (dalëngadalë).”* (Furkan, 32) *“Të pyesin ty për shpirtin; thuaj: ‘Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim’, e juve ju është dhënë fort pak dije.”* (Isra, 85)

Vazhdoi zbritja e shpalljes 23 vjet, në të dy periudhat - në atë mekase e medinase. Shkenca e ajeteve mekase e medinase nuk ka ekzistuar fare në kohën e Pejgamberit (a. s.), sepse ata ishin dëshmitarë dhe ishte e natyrshme që nuk kishin nevojë për një çështje të tillë. Pra, si të ndodhte një gjë e tillë, kur ata e shihnin zbritjen e shpalljes, vendin, kohën, arsyet dhe pas dëshmisë, nuk ndihet nevoja për tregues. Kështu thoshin disa dijetarë.ⁱⁱ

Pastaj Zoti i Madhërishtëm garanto mbrojtjen e Kuranit fisnik, duke thënë: *“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kurantin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.”* (Hixhr, 9)

Mbrojtja hyjnore ngërthen në vete edhe shkencën e ajeteve mekase dhe medinase, së bashku me mbrojtjen e sunne-

tit të pastër, sepse në detaje e sqaron dhe e shpjegon Kurantin fisnik. Myslimani nuk mund të ketë dobi të plotë nëse nuk i di shkaqet, lokacionet dhe arsyet e shpalljes së ajeteve.ⁱⁱⁱ

Nga mbrojtja hyjnore nxjerrim një horizont të lartë kulturor, përkatësisht orvatjen e popujve për të mbrojtur trashëgiminë intelektuale dhe elementet qytetëruese. Kurani fisnik është bazë e formimit të ummetit islam dhe për këtë shkak ne myslimanët obligohemi dhe duhet të kujdesemi maksimalisht dhe me çdo kusht ndaj mrekullisë së tillë, si p.sh. shkencën e shkaqeve të shpalljes, shkencën e texhvidit, shkencën e ajeteve mekase e medinase, shkencat e gjuhës etj. Horizonti kulturor dhe shkencor i kësaj çështje vërehet qartë në thënien e Ibn Me-

s’udit (r. a.): “Pasha Allahun, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër, nuk ka zbritur asnjë sure e Librit të Zotit pa e ditur unë se ku ka zbritur dhe nuk ka zbritur asnjë ajet nga Libri i Zotit, pa e ditur unë se për çka ka zbritur. Sikur ta dija se ndokush dinte më shumë se unë për Librin e Zotit, edhe po të kishte qenë larg (tek ai të shkohej me deve), do të shkoja tek ai.”^{iv}

Nga dobitë që përfitohej prej shkencës së ajeteve mekase e medinase janë:

I. Dallimi mes abrogimit dhe derogimit.

II. Njohja e historisë së legjislacioneve dhe suksesiviteteve të tij në mënyrë të përgjithshme.

III. Thellimi i besimit me lartësimin e politikës islame në edukimin e popujve dhe të individëve.

IV. Përforsimi i bindjes në këtë Kurani dhe në arritjen e tij të ne, i mbrojtur nga ndryshimi e apokrifit.

V. Njohja e kujdesit të myslimanëve ndaj shkencës së ajeteve mekase dhe medinase për të ditur se çka është shpallur para hixhretit e çka pas tij, çka është shpallur kur ka qenë në qytet e çka në udhëtim, çka është shpallur dimrit e çka natën, çka është shpallur dimrit e çka verës, çka është shpallur në tokë...^v

RËNDËSIA NGA ASPEKTI I DISA DIJETARËVE KLASIKË

Gjatë hulumtimit nuk kam hasur që ndonjë dijetar i mëparshëm të ketë shkruar vepra të posaçme rreth mënyrës së funksionalizimit të shkencave kurane, për shkencat e ajeteve mekase dhe medinase, për shkencën e leximit të Kuranit, përpos në raste të rralla - qoftë në sferën e da’vetit, të edukimit ose të synimeve të tjera. Gjithë ajo që kam gjetur rreth kësaj çështje, janë hulumtimet që theksojnë mënyrën e njohjes, karakteristikat dhe metodat tematike, ose stilistike etj.

Si shembull konkret mund të theksojmë se Imam Kurtubiu (Zoti e mëshiroftë) në librin e tij “El-Xhami’u li ahkamil-Kur’an” e thekson autoritetin e lartë të besimtarëve, prandaj sipas tij: “Secili komentues duhet të dallojë ajetet mekase prej atyre medinase për të ditur se për çka iu fliste Zoti robërve të Tij në fillim të shpalljes së Islamit e çka në fund të shpalljes së Islamit, me çka i obligoi në fillim e çka shtoi prej obligimeve në fund. Ajetet medinase i abrogojnë ajetet mekase në të shumtën e rasteve në Kuran, ndërsa nuk mund që ajetet mekase t’i abrogojnë ajetet medinase, sepse ajeti i

abroguar është pas zbritjes së ajetit abrogues.^{vi}

Pastaj, Imam Shatibiu (Zoti e mëshiroftë) në enciklopedinë e tij rreth usulit, fikut e tefsirit thotë: “Çështja e njëmbëdhjetë: ‘Ajeti medinas duhet të ketë zbritur ashtu që të kuptohet ai mekas, ajetet mekase për të kuptuar njëri-tjetrin sikur ajetet medinase në bazë të radhitjes në shpallje, sepse në të kundërtën, nuk do të ishte në rregull.

Dhe, kjo vërtetohet me faktin se shprehja medinase në pjesën dërrmuese është e mbështetur në atë mekase, si dhe të fundit prej tyre mbështeten në atë paraprake. Kjo vërehet qartë nga leximi i përqendruar, përkatësisht përmes rëfimit të përgjithshëm, të posaçmes së përgjithshme, të obligimit të përgjithshëm, të sqarimit të asaj që nuk është sqaruar, apo të plotësimit të asaj që nuk duket se është plotësuar...^{vii}

Imam Bedreddin Zerkeshi në enciklopedinë e tij kuranore “El-Burhan fi ulumil-Kur’an” e zbërthen këtë çështje nga aspekte të ndryshme dhe në detaje, por pa iu qasur çështjes së funksionalizimit të shkencës së ajeteve mekase e medinase për shkak të da’vetit dhe të edukimit.^{viii}

Edhe Imam Sujutiu (Zoti e mëshiroftë) e shqyrton këtë çështje të ajeteve mekase dhe medinase përafërsisht në mënyrë të njëjtë sikurse Imam Zerkeshiu, pa iu qasur çështjes së funksionalizimit të ajeteve mekase e medinase dhe shkencave të tjera për shkak të da’vetit dhe të edukimit.^{ix}

Imam Ibn Akajl el-Mekij në enciklopedinë e tij kuranore “Ez-Zijadetu vel-ihsan fi ulumil-Kur’an” po ashtu nuk e ka trajtuar këtë çështje. As në studimin e bekuar që e gjeta në enciklopedinë: “Ulumul-Kur’an min hilali mukat-dimatit-tefsir” të autorit Shejh Muhamed Safa, pastaj të Shejh Ibrahim Hakki nuk gjeta gjë.

Dhe, në fund, as edhe në një studim tjetër që titullohet “Ulumul-Kur’aninde in Abdilberr” nuk gjeta gjë rreth funksionalizimit pozitiv të shkencave të Kuranit në da’vet e edukim. Pra, kjo ishte e tëra që kishte të bënte me seletin klasik rreth kësaj çështje; madje, edhe vetë mund të vërehet se ata nuk e kanë shqyrtuar çështjen me të cilën merrem unë.

RËNDËSIA NGA ASPEKTI I DISA DIJETARËVE BASHKËKOHORË

Për sa i përket çështjes së angazhimit të disa bashkëkohësve në këtë çështje,

them se e shfletova tefsirin “El-Menar” të Reshid Ridasë (Zoti e mëshiroftë) për parakushtet që i parasheh rreth secilit që dëshiron të merret me tefsirin e Librit të Zotit, dhe për fat të keq nuk gjeta gjë nga ajo që kërkoja unë.^{xi} Pastaj vazhdova hulumtimin në tefsirin e Shejh Ahmed Meragiut dhe po ashtu, edhe aty për fat të keq, nuk munda ta gjej atë që e kërkoja.^{xii} Vazhdova hulumtimin tim në tefsirin “Et-Tahrir vet-tefsir” të dijetarit të njohur Tahitr ibn Ashur, me shpresë se do të gjej diçka në dhjetë parakushtet që duhet realizuar para tefsirit të Kuranit, por nuk gjeta gjë nga ajetet mekase e medinase.^{xiii} Pastaj vazhdova me librin “Mukaddimatut-tefsir”, me nëntitull “Nuzulu Kiramid-difan fi sahati hadaikir-ruhi, verrejhan”^{xiv} të Shejh Muhamed El-Emin ibn Andullah el-Eremij el-Alevij el-Hararij Esh-Shafi’ij dhe as aty nuk gjeta atë që më nevojitej mua.

Për sa i përket Shejhut dhe komentuesit Muhamed Duruze (Zoti e mëshiroftë), mund të thuhet se ai e ka dalluar metodën mes ajeteve mekase dhe medinase në tefsirin e tij “Et-Tefsir El-Hadith”, duke thënë se metoda e ajeteve mekase është e ndërlidhur me da’vetin në virtetet shoqërore, shpirtërore, njerëzore dhe në tërheqjen e vërejtjes nga mëkatet dhe amoraliteti. Aty ka da’vet, zbulim, kërcënim dhe kahëzim. Metoda mekase po ashtu dallon për nga mënyra e retorikës, sepse është e fuqishme dhe depërton thellë në vesh e në zemër. Aty po ashtu mbizotëron metoda e këshillave për durim, për qetësi, prehje dhe mosmërzitje nga qëndrimet e jobsimtarëve.

Metoda e ajeteve medinase përmban parime, obligime dhe rregulla adhurimi, morale, shoqërore, juridike, bihevoriste në mënyrë të pyetjeve, përgjigjeve dhe fetvave gjyqësore, shoqërore, morale, familjare e të sheriatit (legjislativ).^{xv}

Studimi i Shejh dr. Subhi Salihut (Zoti e mëshiroftë), që titullohet “Mebahith fi ulumil-Kur’an”, përmban diçka të re rreth çështjes së ajeteve mekase e medinase. Gjatë shtjellimit të tematikës së ajeteve mekase dhe medinase, thekson se të dy periudhat kanë fazat fillestare, të mesme dhe përfundimtare, dhe si duket këto fjalë i ka marrë nga Imam Ebu Kasim Nisaburi dhe se shkencat e ajeteve mekase e medinase ka nevojë për pastrimin e transmetimeve, vërtetimin e teksteve dhe përcaktimin e historisë së vërtetë. Kjo shkencë ka nevojë më të madhe për një çështje të tillë sesa shkencat e shkaqeve të shpalljes. Të gjitha suret e Kuranit kanë identitet të njohur dhe histori të qarta dhe nëse përzihen,

atëherë dijetarët e vërtetë iu qasen me standardet e tyre të sakta kritike, si dhe shkencat e ajeteve mekase e medinase ka ndodhur në një kohë. Metoda historike-kohore, e cila përmban në vete radhitjen kohore, përcaktimin vendor, ndarjen tematike dhe përcaktimin personal, dhe e gjithë kjo nuk mund të jetë larg horizonteve psikike dhe periudhave shoqërore, si dhe nuk mund të mohojë ndikimin e ambientit në jetë e në gjallesa. E gjithë kjo e pengon injorantin që gjatë da’vetit islam të merret me komentimin e Librit të Zotit.^{xvi} Kështu mendon Imam Ebu Kasim Nisaburi. Interesimi i madh i myslimanëve ndaj transmetimit dhe transmetuesve, si dhe pastrimi, përpikëria dhe preciziteti në radhitjen e sureve dhe të ajeteve kuranore sipas zhvillimeve të da’vetit, ndikoi që orientalistët të hedhin gurë e dru kundër transmetuesve dhe transmetimeve për të mbjellë dyshime në radhitjen e Kuranit në bazë të sires së Pejgamberit (a. s.) .^{xvii}

Studimi i prof. dr. Shejh Muhamed Muhamed Ebu Shuhbe po ashtu ngërthen çështje të rëndësishme, por pa iu qasur kësaj çështje me të cilën merrem unë. Përpos disa çështjeve të dyshimta, pa theksuar thënësit ose burimin e tyre.^{xviii}

Po ashtu nuk ka asgjë të re edhe në librin e Shejh Menna’i El-Kattan (Zoti e mëshiroftë), i cili titullohet: “Mebahithu ulumil-Kur’an”, përpos disa vështrimeve rreth ertësive dhe leksioneve nga zbritja shkencive e Kuranit fisnik.^{xix} Kam hasur disa të dhëna të thukëta në studimin e dr. Adnan Zarzurit në librin e tij “Ulumul-Kur’an i’xhazuhu ve tarihu teuthikihi” rreth kësaj çështje që më intereson mua, duke theksuar rëndësinë e të kuptuarit të qëndrimeve, situatave dhe pozicioneve në hapat e edukimit e të formimit. Kjo shkencë është hyrje në njohuritë rreth karakteristikave rrëfyese dhe bihevoriste të ajeteve mekase e medinase, duke sqaruar se tematika e ajeteve mekase ka të bëjë me besimin, ndërsa tematika e ajeteve medinase me sheriatin. Islami dhe Kurani janë: besim, sistem, legjislacione dhe parime.^{xx}

Në vendtakimin e komentuesve në internet, përkatësisht në një takim shkencor që zgjati katër sesione me shokët e profesorit të nderuar dr. Muhamed Abdurahman Sha’ji, dr. Abdurahman Mu’ada Esh-Shukrij, dr. Abbas ibn Husejn el-Hazimij (që të gjithë janë kolosë të kësaj shkencë), u shqyrtua çështja e ajeteve mekase e medinase në ajetet kuranore në mënyrë të thellë e në detaje dhe, në vijim diçka prej tyre aq sa më mundëson këtu hapësira e kufizuar. Kur filluan të flasin

për shkencën e ajeteve mekase e medinase, dr. Muhamed Abdurahman Sha’ji tha: “Çdo periudhë ka situatat, nevojat dhe kërkesat e veta, dhe nga Kurani merret në çdo periudhë atë që i nevojitej. Paramendo sa vuajnë shtetet e botës nga lëndët narkotike dhe sa para harxhojnë për ta luftuar e për ta larguar nga shoqëria, e megjithatë përsëri dështojnë. Pra, paramendo se si korri sukses Islami kundër problemit të alkoolit në shoqërinë ku ishte rrënjësuar thellë ky fenomen. Atyre që kujdesen për këtë çështje në botën islame u themi: “Nëse dëshironi t’i luftoni me sukses lëndët narkotike, atëherë duhet ta përforconi anën fetare te të rinjtë dhe te të rriturit.”^{xxi}

Këto fjalë përmbajnë mesazh dhe leksion për ata që punojnë në da’vetin e Zotit të Madhërishtëm dhe duhet shënuar me shkronja të arta. Pra, ai që merret me da’vet duhet ta njohë mirë gjendjen dhe realitetin e njerëzve ku jetojnë, t’i kuptojë mirë tekstat fetare, të kuptojë mënyrën e zbritjes së teksteve të tilla në kohën reale. Ai po ashtu duhet ditur nevojat e realitetit të tillë e pastaj të zgjedhë këshillën e përshtatshme për njerëzit. Thirrësi në fe duhet të mbjellë fenë në zemrat e njerëzve nëse dëshiron të përmirësojë sjelljen, mendjen dhe besimin e tyre.

Gjatë bisedës së nxehtë rreth kësaj tematike të rëndësishme,^{xxii} sheshi theksoi rëndësinë dhe dobitë që përfitohej nga njohja e ajeteve mekase e medinase, duke thënë: “Shijo mënyrat e Kuranit dhe dobinë prej tyre gjatë da’vetit në Zot., dhe ndoshta do të vëshesh të dhëna të bukura e të dobishme posaçërisht për kohën tonë, si t’i zhvillojmë metodat e da’vetit, për të qenë të përshtatshme me situatën dhe me nevojat e njerëzve të kësaj kohe dhe, nuk ka dyshim se dobitë e tilla mund të përfitohej nga shkencat e Kuranit dhe nga begatitë e Kuranit” .^{xxiii}

PËR ZHVILLIMIN E METODAVE TË DA’VETIT NË KOHËN TONË

Leksioni e mësimi që mund të merren nga fjalët e prof. Muhamed Kureshiut kanë të bëjnë me zhvillimin e metodave të da’vetit në kohën tonë, që të jenë të përshtatshme me gjendjen e rrallë të njerëzve dhe me përmbushjen e nevojave të tyre intelektuale dhe psikike. E gjithë kjo konsiderohet si dobi dhe bereqet nga shkencat e Kuranit fisnik. Edhe i afërmi edhe i largëti e dinë se koha jonë është e mbushur përplot mjete teknologjike, industriale e shkencore që mund të zhvillojnë metodat e da’vetit dhe që ndihmojnë t’iu flitet njerëzve ashtu siç e

kuptojnë ata duke u mbështetur në Kuran e në sunnet. Vetëm dijetarët e kuptojnë këtë çështje të rëndësishme.^{xxiv}

Për sa i përket ndarjes së përfitimit dhe sjelljes së njerëzve me shkencën e ajeteve mekase e medinase, njerëzit kanë qëndrime të ndryshme e të llojllojshme, si dhe varësisht nga kapaciteti i tyre shkencor, mundësia e tyre për të ditur dhe nga specializimi i tyre i përpiktë dallohen edhe metodat dhe mënyrat e tyre. Dijetarët e vërtetë përfitojnë nga kjo shkencë ashtu siç përfitojnë edhe specialistët e tefsirit dhe të shkencave të Kuranit. Po ashtu edhe studentët e përgjithshëm përfitojnë nga kjo shkencë ashtu siç përfitojnë edhe njerëzit e rëndomtë.

Kjo shkencë nuk është e përkufizuar vetëm për një kategori njerëzish, por prej saj mund të kenë dobi të gjitha kategoritë e njerëzve, p.sh., dijetarët e muxhtehidët kanë nevojë për *nasihun* e *mensuhun*. Dijetarët po ashtu kanë dobi edhe nga njohja e historisë së sheriatit islam...^{xxv}

Njohja e shkencës së ajeteve mekase e medinase formon një shtyllë të fuqishme në të cilën mund të mbështeten të gjithë thirrësit në fenë e Zotit të Madhërishtëm, ashtu siç ndihmon edhe në njohjen e mënyrës së da’vetit, ngjyrat e ligjërit, shkallëzimin e parimeve, obligimeve, formimit dhe përkryerjes. Da’veti tek Zoti i Madhërishtëm është art profetik, i lartë, profesion i ndershëm dhe vepër e shenjtë, dallohet me shije të posaçme kuranore, të cilën mund ta shijojë realisht vetëm ai që jeton në kopshtin e tij dhe nën hijen e drurëve të tij, në ajrin e pastër të tij dhe nëse e pi ujin e tij të kristaltë. Da’veti ka nevojë për metodë konkrete ndaj çdo lloji të amoralitetit në fe, besim, ligj, krijesë e sjellje. Obligimet e tij bien mbi supet e atij që është i përgatitur për një mësim të tillë, si dhe parimet e sheriatit dhe sistemet shoqërore vijnë pas pastrimit të zemrës dhe përcaktimit të qëllimit derisa të jetë jeta në rrugë të Zotit. Në këtë kontekst, Zoti i Madhërishtëm thotë: “*Thuaj: ‘Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras tek Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu, e unë nuk jam nga idhujtarët.*” (Jusuf, 108)

Kush e lexon Kurantin fisnik do të vërejë karakteristikat të ajeteve mekase që nuk janë në ajetet medinase,^{xxvi} pa marrë parasysh se të dytë mbështeten në të parët në parime e ligje ashtu siç thekson Imam Shatibiu në enciklopedinë e tij “El-Muvafekat” .^{xxvii}

Pas një orvatje të vazhdueshme hulumtuese, Zoti i Madhërishtëm më udhëzoi në një burim që konsiderohet pasuri

e mendimit tim shkencor, dhe për këtë së pari e së fundi i falënderohem Zotit të Madhëruar. Nuk do të udhëzoheshim sikur të mos na udhëzonte Zoti i Madhëruar! Zoti e shpërbleftë autorin e këtij thesari, profesorin Sejjid Kutub (Zoti e mëshiroftë) dhe tefsirin e tij: “Fi dhilalil-Kur’an”, krahas disa punimeve tjera të tij.^{xxviii} S’ka dyshim se atij i takon merita më e madhe në këtë çështje, për shkak se kishte interesim të madh ndaj çështjes së mënyrës së funksionalizimit të shkencës së ajeteve mekase e medinase. Ai është përqendruar gjerë e gjatë në tefsirin e sures En’am dhe të sureve tjera të Kuranit. Gjatë qëndrimit të tij të gjatë, ai thekson disa çështje edukative dhe të da’vetit,

dhe ne si thirrës në fe duhet të mendojmë rreth mënyrës së funksionalizimit të tyre dhe dobisë prej tyre. Në fillim të tefsirit të sures En’am, ai (Zoti e mëshiroftë) thotë: “Kjo sure është mekase... Nga Kurani mekas., Kurani, i cili vazhdoi t’i zbret Pejgamberit (a. s.) plot trembëdhjetë vjet, flet për një çështje, vetëm për një çështje dhe Kurani mekas nuk e ka tejkaluar në çështjet që kanë të bëjnë me sistemin e jetës përdërisa e pa Zoti se është plotësuar ajo që duhej thënë dhe se është përfunduar e ngulitur në zemrat e njerëzve të zgjedhur nga njerëzia, dhe të cilëve u caktoi Zoti që të jenë bartës të fesë, që të formojë sistemin real në bazë të kësaj feje...”^{xxix}

Nga fjalët e lartpërmendura të prof. Sejjid Kutubit nënkuptojmë se Kurani mekas nuk e ka tejkaluar çështjen e besimit të pastër që mbështetet në monoteizëm të pastër e të sinqertë të Zotit të Madhërisëm. Kjo është çështja e besimit, e bazës dhe e shtyllës mbi të cilat më vonë do të mbështeten obligimet, ligjet dhe të gjitha detyrimet tjera fetare.

(Autori aktualisht ligjëron në disa universitete në Katar në gjuhën arabe dhe angleze. Tekstin për “Hënën e Re” e sjell prof. dr. Muhamed Mustafa, ligjërues i Gjuhës Arabe në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup)

ⁱ Forma “Ve jes’elunke”, me theks te shkronjat “ve” dhe pa të në pesëmbëdhjetë vende në Kuranin fisnik.

ⁱⁱ Zerkani, Muhamed Abduladhim, Menahilul-urfan fi ulumul-Kur’an, vëll. I, fq. 196.

ⁱⁱⁱ Disa dijetarë e quajnë shkencën e ajeteve mekase dhe medinase: “Ilmu ezimetin-nuzul” dhe “ilmu emkinetin-nuzul”.

^{iv} Nisaburi, Muslim ibn Haxhxhaxh, Sahihul Muslim, Daru ih-jail-kutubil-arabijjeti, bot. III, 1425, nr. 3088.

^v El-Burhan fi ulumul-Kur’an, vëll. I, fq. 187-188.

^{vi} El-Kurtubi, El-Xhamiul-ahkam vel-mubejjuu lima tedmunuhu mines-sunneti ve ajel-Furkan, muessesetur-risaleti, bot. I, 2006, vëll. I, Mukadimetul-kitab, fq. 4.

^{vii} Shatibi (790 hixhri), El-Muvafekat, tahkik Ebu Ubejde, Daru ibn Affan, bot. I, 1997, vëll. IV, fq. 256. Vlen të theksoj se kam hasur një studim të rëndësishëm rreth shkencave të Kuranit tek Imam Shatibiu nga dr. Shaji ibn Abduhu Es’merij, autor i këshillit arsimor në Fakultetin e Katarit në Universitetin Islamik të Medinës me titull: “Me’al-imam Esh-Shatibij fi mebahithi min usulul-Kur’an ve tefsirihi, ku flet për çështjet që kanë të bëjnë me Kuranin, tefsirin, kushtet e komentuesit sipas Shatibiut etj.

^{viii} El-Burhan fi ulumul-Kur’an, Imam Zerkeshi, vëll. I, fq. 168.

^{ix} El-Itkan fi ulumul-Kur’an, Imam Sujuti, vëll. I, fq. 34-74.

^x Ibn Ukajle, Ez-Zijade vel-ihsan fi ulumul-Kur’an, bot. I, 2006, Fakulteti i Sheriatit, Universiteti Sharika, Imaratet e Bashkuar Arabe, fq. 1, 268.

^{xi} Rida, Sejjid Muhamed Rida, Tefsirul-Menar, bot. II, Darul-Menar, Kajro 1947, fq. 17.

^{xii} Meragi, Ahmed Mustafa, Tefsirul-Meragi, bot. I, Matba’atu Mustaf El-Halebi ve ve euladihi, 1946, fq. 24-30.

^{xiii} Ibn Ashur, Muhamed Dhakir, Tefsirul-Tahrir vet=tenvin, bot. I, Ed-Deuletut-tunisijjetu, 1984, Tunis, fq. 10-130.

^{xiv} Bot. I, Daru turukin-nuhat, Bejrut, Liban.

^{xv} Duruze, Muhamed Izzet, Et-Tefsirul-hadith tertibus-suver kasdut-tenzil, bot. II, Darul-Garbil-Islamij, Bejrut, vëll. I, fq. 126-127.

^{xvi} Salih, Subhi, Mebahith fi ulumul-Kur’an, fq. 168-169.

^{xvii} Po aty, fq. 169, 184.

^{xviii} Ebu Shehbe, Muhamed Muhamed, El-Med’hal li derasatil-Kur’anil-Kerim, bot. II, 2001, Darul-livai, Bejrut, fq. 219-261.

^{xix} El-Kattan, Menna’i, Mebahith fi ulumul-Kur’an, bot. 5, 2002, Muessesetur-risaleti, Bejrut.

^{xx} Zarzur, Adnan, Ulumul-Kur’an ve i’xhazuhu ve tarihu teuthikihi, bot. I, 2005, Amman, Jordani, fq. 211-213.

^{xxi} www.tafsir.net/vb/tafsir29336/#ixzz278CVA3ji

^{xxii} Kisha nderin që të jem student i shejhit dr. Muhamed Kureshiut në Fakultetin e Kuranit në Universitetin Islamik të Medinës, në lëndën e Kuranit, në vitin 1413/1414, dhe i jam falënderues tërë jetën!

^{xxiii} www.tafsir.net/vb/tafsir29336/#ixzz278CVA3ji

^{xxiv} Rreth karakteristikave të mrekullisë metodologjike, stilistike e ekspresive shih veprën e dr. El-Mu’ti, Abduladhim Ibrahim, Hasaisut-ta’biril-Kur’anj ve simatihi el-belagijjeti, bot. I, 1992, Mektebetu Vehbe, vëll. 1, fq. 214-320; Duruze, Muhamed Abdullah, En-Nebeul-adhim, nedharat xhedide fil-Kur’anil-Kerim, bot. 2, 2006, Bejrut, Liban, fq. 76-108; Po ashtu shih enciklopedinë gramatikore, stilistike dhe retorike: “Dirasatul-uslubil-Kur’an” të autorit Abdulhakk, bot. II, Darul-hadith, Kajro, 2007.

^{xxv} www.tafsir.net/vb/tafsir29336/#ixzz278nwAKzN.

^{xxvi} El-Ajd, Zejd ibn Umer, El-Mekkij vel Medenij fi ujunil-musteshrikine, fq. 5; Dr. Hasan Azuzi, Menahilul-musteshrikin el-bahthijje fi dirasatil-Kur’anil-Kerim, i këshilloj lexuesit që ta lexojnë këtë vepër për t’i kuptuar mënyrat e tyre hulmtuese për Kuran e sunnet. Libri gjendet edhe në versionin elektronik në rrjetin mari-manges: www.muslim-library.com/book,415,1.html.

^{xxvii} Shatibi, El-Muvafakat fish-sheriatil-islamijjeti, vëll. 1, fq. 256; Salih Subhi, Mebahith fi ulumul-Kur’an, fq. 184.

^{xxviii} Shih tefsirin e tij në hyrjen e sures El-En’am, Fi dhilalil-Kur’an.

^{xxix} Kutub, Sejjid, Fi dhilalil-Kur’an, vëll. 2, fq. 3-24.

IFTAR ME TOP NË KAMJAN

Ramazani në fshatin Kamjan të Tetovës këtë vit do të bëhet në një atmosferë më ndryshe, ka njoftuar TV2 Gostivar.

Informata është marrë nga kamjan.com dhe në të në vazhdim thuhet: Për lajmërimin e kohës së iftarit do të kriset me top. Kjo, paralelisht me dritat e xhamive që do të ndizen dhe të ezanit që do të thërritet në kohën e iftarit.

Për nder të Ramazanit, si obligim fetar, bashkëfshatari ynë Kalosh Bajrami ka bërë donacion një top simulues, përmes të cilit do të kryhet lajmërimi i çeljes së iftarit gjatë 30 ditëve të Ramazanit 2022, thuhet në njoftimin e shpërndarë nga kamjan.com. (21.03.2022)

AMINA OKUEVA, HEROINA E UKRAINËS

Amina Okueva (1983-2017) është myslimaneja më e famshme në Ukrainë. Ajo ishte një anëtare e Forcave Speciale Antiterroriste të Ukrainës ATO, ishte një snajperiste super e shkëlqyer, së cilës nuk i gjendej shoqi. Ajo u vra në tetor 2017, në një atentat ndaj saj dhe burrit të saj nga ana e Vlladimir Putinit dhe Ramzan Kadyrovi.

Amina Okueva ka lindur si Natalia Nikiforova në Odesa të Ukrainës, në vitin 1983. Ajo është fëmija i një babai çeçen dhe i një nëne polake. Ajo ishte modele në Rusi dhe më pas, në moshën 17-vjeçare, u konvertua në Islam dhe u martua me çeçenin Isa Mustafinova.

Pas martesës, ajo e ndryshon emrin e saj në Amina. Burri i saj Isa vdiq shpejt në luftën me Rusinë. Amina rimartohet me një tjetër çeçen, i cili më vonë u dënua me burgim të përjetshëm për likuidimin e inteligjencës ruse. Bashkëshorti i saj i tretë dhe i fundit, Adem Osmayev (Osmayev tani është udhëheqës i vullnetarëve çeçenë që luftojnë në anën e Ukrainës), është akuzuar për tentativë për të vrarë Vlladimir Putinin dhe u ka mbijetuar dy tentativave për vrasje.

Pas qëndrimit në Çeçeni, pra pas kthimit në Ukrainë, Amina iu përkushtua studimeve për mjekësi, të cilat i përfundoi me sukses dhe u bë kirurge.

Në fillim të luftës në Ukrainën lindore, në Lugansk dhe Donetsk (2014), Amina iu bashkua luftës së bashku me vullnetarë të tjerë çeçenë. Më vonë ajo u bë anëtare e njësisë speciale anti-terroriste Kyiv-2, si snajperiste. Sipas dëshmisë



së bashkëluftëtarëve të saj, Amina ishte një snajperiste shumë vdekjeprurëse.

Amina dhe bashkëshorti i saj Adem Osmayev ishin nën ndjekjen e vazhdueshme të agjentëve të Putinit dhe të Kadyrovit. Në verën e vitit 2017 ata iu nënshtruan një atentati. Një vrasës, i

quajtur Arthur Abdulayevich Denisultanov, u prezantua rrejshëm si gazetar i gazetës franceze “Le Monde”, duke organizuar një intervistë me ta në një rrugë në Kiev. Kur Amina dhe bashkëshorti i saj Ademi erdhën për intervistën e planifikuar, gazetari i rrejshëm qëlloi mbi ta. Amina ka reaguar shumë shpejt, ka arritur të qëllojë katër herë atentatorin. Atentatori mbijetoi, më pas u shkëmbye dhe iu dorëzua palës ruse.

Disa muaj më vonë u bë një atentat i ri ndaj Aminës dhe bashkëshortit të saj Osmayev. Fatkeqësisht, Amina nuk i mbijetoi atentatit; ajo u qëllua me dy plumba në kokë.

Ukrainasit i bëjnë nder dhe respekt të madh Amina Okuevës. Sot ka dy rrugë në rajonin e Kievit me emrin e saj. Bashkëshorti i saj, Adem Osmayev, po udhëheq vullnetarët çeçenë në mbrojtjen e Ukrainës këto ditë.

Ky tekst është shoqëruar edhe nga një video duke i bërë homazhe Amina Okuevës në Kongresin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. (18.03.2022)

(Burimi, në bashkëpunim: 360grade.al etj.)

MYFTIU I UKRAINËS: “MOS LUFTONI PËR PUTININ”

“Myslimanët, pjesë e Ukrainës”, “Myftiu i Ukrainës u kërkon sirianëve të mos luftojnë për Putinin” dhe tituj të ngjashëm janë duke qarkulluar këto ditë në disa media, të cilat i referohen gjendjes në Ukrainë deri sa ajo përballet nga agresioni rus.

Disa ditë pasi presidenti rus Vlladimir Putin aprovoi atë që pretendoi se ishin 16 mijë vullnetarë nga Lindja e Mesme, të gatshëm për luftë në Ukrainë, krah Rusisë, Myftiu i Ukrainës Shejh Said Ismagilov ka publikuar një mesazh, ku, siç thuhet, u bën thirrje sirianëve që të mos marrin pjesë në luftë.

“Putini dëshiron që t’ju punësojë për t’ju sjellë në Ukrainë”, ka thënë ai. “Mos ejani këtu për të na vrarë, mos kryeni një krim. Myslimanët janë pjesë e Ukrainës. Ne po mbrojmë kombin tonë. Ukraina nuk e sulmoi Rusinë. Rusia e sulmoi Ukrainën”, ka shtuar ai.

Myftiu Shejh Said Ismagilov ka thënë se Rusia po vret civilë e fëmijë e se po shkatërron objektet fetare ukrainase. (16.03.2022)

(Burimi: desk/HeR)



“Sot, në varrim të Bardha Bislimit në Kumanovë, e cila nga një sëmundje e rëndë ndërroi jetë në moshën 18-vjeçare. Ajo është mbesa e z. Mustafa Dauti, Drejtor në Rijasetin e BFI të RMV. Pjesëmarrja jonë ishte gjest i përkrahjes së babait dr. Fuad Bislimi në këtë sprovë të rëndë, si dhe të kryefamiljarit, babëgjyshit z. Ejup Dauti dhe tërë familjes Dauti. Pjesëmarrje masive e besimtarëve të Kumanovës, e Myftiut Abedin ef. Imeri, pastaj e Myftiut të Strugës mr. Salim ef. Sulejmani me bashkëpunëtorë, e përgjegjësve të sektorëve të Rijasetit të BFI të RMV. Fjalë ngushëllimi pati Myftiu h. Abedin ef. Imeri, ndërsa në fjalën e rastit që mbajta ju shpreha ngushëllimet tona, duke iu lutur Allahut Fuqiptotë që merhumet t’i fal xhenetin, ndërsa familjes i bëra apel për durim të paluhatshtëm”, ka shkruar Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook. (21.02.2022)



“Më 16 mars, 2022, vizituam familjen Mahmudi në fshatin Arnaqi, komuna e Sarajit (Shkup), respektivisht vëllezërit Nusret dhe Osman (nxënësin tim të dikurshëm në Medrese), si dhe nëpunësin e BFI, z. Mahi Mahmudi, për t’iu shprehur ngushëllimet tona të thella në emër të BFI të RMV me rastin e ndërrimit jetë të vëllait të tyre Orhan Mahmudi në moshë të re, i punësuar si Inspektor në Qeverinë e RMV-së. Ne iu shprehëm përkrahjen tonë në këto momente të dhimbjes dhe të humbjes së madhe, jo vetëm për familjen Mahmudi, por për gjithë kombin, duke i këshilluar për durim të pashoq, me lutje që rahmetliut Allahu t’i falë xhenetin. Në këtë vizitë ngushëllimi më shoqëruan z. Irsal Jakupi, z. Fadil Ramadani, z. Qufli Osmani, z. Rexhep ef. Ziberi e të tjerë nga Rijaseti i BFI të RMV. Falënderojmë familjen Mahmudi për pritjen vëllazërore që na bënë. Zoti i bekoftë”, ka shkruar Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

KUJTOJMË H. FEMI REXHEPIN (1922-2022)

H. Femi Rexhepi u lind në vitin 1922 në një familje me tradita fetare në fshatin Përshefcë të Tetovës. Në moshën gjashtëvjeçare, ai bashkë me familjen do të shpërngulej dhe do të vendosej në fshatin Përllubisht. Mësimet e para fetare i mori nga babai i tij, i cili ka qenë një autoritet me kulturë të gjerë dhe dashamir i literaturës fetare.

Pas përfundimit të shkollës fillore, ai do të regjistrohet në medresenë e njohur El-Hidaje në Tetovë, ku do të ketë fatin ta mësojë Kurani Kerimin dhe njohuritë e tjera fetare nga hoxhallarë të mirënjohur të kohës në Tetovë e më gjerë.

Më pas, gjatë gjithë jetës, ai me ëndje do ta përmendte këtë proces edukativo-shpirtëror dhe me respektin më të madh e me miradije do t’i kujtonte emrat e disa hoxhallarëve të tij, siç janë: Abdulxhemil efendiu, Bedaet efendiu, Ali efendi Metushehu; pastaj, me theks të veçantë, asketin e njohur të Tetovës, Ali efendiu, të cilin e llogariste si mik të Zotit/evlija dhe shëmbëlltyrë të moralit profetik dhe e prezantonte si arketip të sjelljes me delikatesë të thellë. Mbresat dhe dashurinë për hoxhën e Kurani Kerimit, Rexhep efendiu, do t’i kujtonte me emocione të thella. Ai hoxhën e nderuar e llogariste si person i cili ia kish mbjellë thellë në zemër dashurinë për të lexuar dhe dëshirën për t’ua mësuar të tjerëve fjalën e të Madhit Zot, prandaj për të fliste me ngazëllim dhe i përloteshin sytë sa herë që e përmendte.

Po ashtu, ai kur fliste për ditët në medrese përmendte me miradije edhe emrat e disa hoxhallarëve me të cilët kishte mësuar bashkë, si: Veli ef. Nesimin nga Dobroshti, Salih ef. Misimin nga Bogovina, hafëz Isak ef. Mustafën nga Jazhinca, Selim efendinë nga Llaskarca, Zaim ef. Ejupin nga Shemshova e Tetovës, mualimin e njohur mulla Mahmut ef. Asllanin, me të cilin gjatë tërë jetës mbante kontakte të vazhdueshme.


Për shkak të ndryshimeve të kufijve dhe turbulencave administrative që kanë ndodhur gjatë periudhës derisa ai ishte nxënës në medresenë në fjalë, do të detyrohej të ndërpriste shkollimin në medrese, kurse më pas, për njëfarë kohe

do të vazhdonte t’i ndiqte mësimet te hoxha Imer ef. Abazi në fshatin Shemshovë.

Femi efendiu ishte njeri hijerëndë, serioz, intelegjent dhe i mirëkuptueshëm, i dashur dhe punëtor i palodhshëm. Shumë i vendosur e i përkushtuar me plot kuptimin e fjalës në fenë e Allahut (xh. sh.). Ai kishte respekt shumë të madh ndaj dijetarëve, me theks të veçantë ndaj hoxhallarëve. Edhe pse nuk ka qenë i angazhuar me detyrë në ndonjë xhami, ai gjatë gjithë jetës ka shërbyer si mualim, ndërsa shtëpia e tij ka qenë si një mejtep ku nxënësit nga fshatra të ndryshëm kanë mësuar leximin e Kuranit dhe njohuritë elementare të fesë. Me theks të veçantë, në kohën kur politika moniste-ateiste e kish ndaluar mësimin fetar nëpër mejtepe, ai i vendosur dhe i syptrembur do ta vazhdonte këtë traditë të shenjtë në shtëpinë e tij. Detyrën e mësuesit të Kuranit, të cilën e kryente me përkushtim dhe me shumë zell, ai nuk do të ndërpriste madje edhe në moshë të shtyrë.

Si një lexues i mirë i Kuranit, me një zë simpatik, ai me vite të tëra ka kryer detyrën e imamit në fshat, e në veçanti kanë qenë tërheqëse faljet e namazeve të teravive gjatë muajve të Ramazanit. Dashurinë ndaj leximit të Kurani Kerimit dhe literaturës fetare, të cilën e kishte fituar nga mësuesit në medrese, do ta ruante dhe kultivonte me zell dhe përkushtim deri në vitet e fundit të jetës. Paralelisht me dashurinë e thellë për Kurani Fisnik, Femi efendiu njihet edhe për vendosmërinë dhe përpikërinë në faljen e namazeve. Krahas angazhimeve të ndryshme, ai vazhdimisht kujdesej që namazin ta falte në kohë dhe me xhemat. Vazhdimisht thoshte se nuk mbante mend që ndonjë kohë e namazit t’i kishte ngelë për kaza!

Ai ishte njeri pragmatik dhe i kushtonte rëndësi edukimit shpirtëror dhe platformizimit të besimtarit me parimet fetare, duke qëndruar kështu larg bisedave shterpe rreth çështjeve fetare. Theks të veçantë i kushtonte arsimimit dhe edukimit të gjeneratave të reja. Vazhdimisht thoshte: ‘Obligim i juaj është që këshillat e Pejgamberit (a. s.), për mësim dhe dije, t’i mbillni te fëmijët



tuaj dhe ta përcillni këtë dritë të bekuar te gjeneratat e ardhshme. Fetarisht nuk është me rëndësi vetëm të flitet dhe të dëgjohej për fenë, por gjërat që fliten dhe që dëgjohej, duhet të bëhen pjesë e jetës sonë të përgjithshme.’

Femi efendiu, i cili gëzonte një respekt të madh në rreth e më gjerë, pas një sëmundjeje të shkurtër, ndërroi jetë më 7 shkurt 2022 dhe u varros në varrezat e reja në Tetovë, në prezencë të një numri të madh të xhematit dhe të hoxhallarëve. Allahu e pastë mëshiruar!

Mr. Nasir ef. Rexhepi, Myftiu i Myftinisë së Shtipit (nip i h. Femi Rexhepit)

VARROSET SPORTISTI BESJAN JASHARI



Më 16 mars, 2022, Myftiu i Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët nga Myftinia dhe nga kolegët nga Rijaseti, mori pjesë në ceremoninë e varrimit të të riut shumë të nderuar dhe të dashur, përkatësisht sportistit Besjan Jashari nga fshati Çellopek, i cili ndërroi jetë para disa ditëve në një aksi-

dent në Gjermani, thuhet në njoftim.

Në këtë ceremoni Myftiu përcollti ngushëllime të sinqerta për familjen e rahmetliut dhe iu lut Allahut fuqiptotë që merhumin ta shpërblejë me shpërblimet e Tij të pafundta.

Pastaj u lexuan suret e shkurtra dhe u bë dua ja e xhenazes nga hfz. Imer ef.

Kamberi.

Mënyrën e faljes së namazit të xhenazes e tregoi Imami i Xhamisë së fshatit Çellopek i Ri, hfz. mr. Nexhadi ef. Limani, kurse në namazin e xhenazes priu Myftiu i Tetovës, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së BFI-Tetovë, prof. dr. Qani ef. Nesimi.



”Sot qëndruam për ngushëllime te familja Rexhepi në fshatin Sullare e Poshtme (Shkup), me rastin e ndërrimit jetë të profesorit tonë të nderuar h. Remzi ef. Rexhepi, i cili tërë jetën ia kushtoi Islamit dhe Medresesë Isa Beu. I shoqëruar nga Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Myftiu i Strugës mr. Salim ef. Sulejmani, Drejtori i Medresesë prof. Ibrahim ef. Idrizi dhe drejtorët e Rijasetit, shprehëm ngushëllimet dhe përkrahjet tona të thella në këto momente të dhimbjes së madhe familjare, me lutje Allahut Fuqiptotë që rahmetliut t’i fal xhenetin e amshueshëm, ndërsa familjes - durimin e paluhatshtëm”, ka shkruar Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në faqen e vet në Facebook më 21 shkurt, 2022.

KALON NË AMSHIM PROF. FIKRET KARÇIQ (1955-2022)

Fikret Karçiq (Karčić), profesor në Fakultetin Juridik në Sarajevë dhe në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë, ish-Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Bashkësisë Islame, ka vdekur në moshën 66-vjeçare, shkruan më 16 mars, 2022, Hoxhë Azmir A. Jusufi.

I lindur në Vishegrad (Bosnjë e Hercegovinë) në vitin 1955, arsimin e mesëm e kreu në Medresenë Gazi Husrev Bej në Sarajevë. Në vitin 1978 u diplomua në Fakultetin Juridik në Sarajevë. Shkallën e magjistratit dhe të doktorit të shkencave i fitoi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit në vitin 1985, përkatësisht në vitin 1989.

Ishte profesor i Historisë juridike krahasuese në Fakultetin Juridik të Universitetit të Sarajevës. Ka ligjëruar në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë, në Universitetin Marmara në Stamboll, në Universitetin Islamik Ndërkombëtar të Malajzisë, në Universitetin e Oslos dhe në Universitetin Shtetëror Boise (SHBA).

Interesi i tij kryesor akademik ishte Historia e të drejtës së shariatit dhe institucioneve islame në Bosnjë dhe Hercegovinë në periudhën post-osmane, lëvizjet reformiste në Islam, myslimanët e Ballkanit dhe kulturat juridike krahasuese.

Karçiq ka qenë Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Bashkësisë Islame në Bosnjë e Hercegovinë për dy mandate. Ishte redaktor i Glasnik-ut dhe kolumnist shumëvjeçar i gazetës informative islame “Preporod”.

Në vitin 2018, së bashku me dr. Enes Kariq (Karić), ishte fitues i çmimit pre-

stijjioz për vepër jetësore, që ndahet nga Shoqata e Shkencëtarëve Shoqërorë Myslimanë (MB).

Ndër veprat e botuara të Fikret Karçiqit janë: “Šerijatski sudovi u Jugoslaviji 1918-1941“, „Društveno-pravni aspekt islamskog reformizma“, „The Bosniaks and the Challenges of Modernity: Late Ottoman and Hapsbury Times“, „Studije o šerijatskom pravu i institucijama“, „Metodi istraživanja u islamskim naukama“, „Muslimani Balkana: istočno pitanje u XX vijeku“, „The Other European Muslims: A Bosnian Experience“, shkruan Azmir A. Jusufi.

Nga shtëpia botuese “Logos-A“, Shkup, kanë shkruar: “Profesor dr. Fikret Karçiq ishte shembull (shpesh i paarritshëm!) për shumë prej nesh në shkencë, studim dhe sjellje në jetë. Sidomos në seriozitetin me të cilin ai iu qas punëve dhe detyrave të tij mësimore, akademike dhe pedagogjike. Mbetet për t’u mbajtur mend guximi dhe rregullsia e tij njerëzore dhe profesionale. Për shumë prej nesh, këto mund dhe duhet të jenë një pikë referimi. Rahmet pastë shpirti i tij i mirë.”

Azmir A. Jusufi, student i të ndjerit, e ka sjellë shqip edhe fjalën e akademikut Enes Kariq (Karić) për prof. Fikret Karçiqin. Në të ai thotë:

“Këto fjalë po i shkruaj me dhimbje dhe pikëllim të madh për të ndjerin prof. dr. Fikret Karçiq. Publiku ynë shkencor dhe akademik, i Bosnjë-Hercegovinës dhe i Evropës, ka humbur ekspertin më të mirë në fushën e shkencave juridike dhe sheriato-juridike, si dhe të studimeve juridike krahasuese dhe të historisë së të drejtës. Prof. dr. Fikret Karçiq ishte i



shkëlqyer në këto dhe në disiplina të ngjashme.

Qëkur ishte si nxënës i Medresesë Gazi Husrev Bej fliste arabisht dhe anglisht. Kujtojmë se si atëherë, në Fakultetin Filozofik në Sarajevë, para profesorit Sulejman Grozdanić, ai e kaloi shkëlqyeshëm provimin e gjuhës arabe.

Prof. dr. Fikret Karçiq u diplomua me notat më të larta nga studimet për drejtësi në universitetet e Sarajevës dhe të Beogradit, nga studimet universitare deri në studimet postdiplomike të magjistraturës dhe të doktoratës. Përveç në Fakultetin Teologjik Islam, Fakultetin e Shkencave Islame dhe Fakultetin Juridik të Universitetit të Sarajevës, prof. dr. Fikret Karçiq ka dhënë mësim në disa universitete nga Malajzia deri në Evropë e Amerikë, është pritur me kënaqësi dhe është mirëpritur si profesor universitar i drejtësisë dhe si poliglot, i ka mbajtur rrjedhshëm ligjëratat në anglisht, arabisht dhe turqisht. Ka marrë pjesë në simpoziume eminente botërore për të Drejtën e shariatit dhe reformën e saj në shoqëritë moderne gati pesëdhjetë herë. Disa institucione të larta qeveritare në Evropë kanë kërkuar ndihmën shkencore të prof. dr. Fikret Karčić-it në aspektin e qasjeve moderne në studimin e të Drejtës së shariatit.

Fakulteti i Teologjisë Islame, përkatësisht Fakulteti i Shkencave Islame në Sarajevë, do t’i mbetet në borxh të përhershëm prof. dr. Fikret Karçiqit për themelet moderne të studimeve fetare-juridike. Gjithashtu, nuk duhet haruar asnjëherë se nëpërmjet reputacionit të prof. dr. Fikret Karçiqit Fakulteti i Shkencave Islame është bërë i njohur gjerësisht në Evropë dhe në botë.

Na vjen keq për largimin e parakohshëm të prof. dr. Fikret Karçiqit. Dhjetëra libra, studime, diskutime shkencore dhe ese të tij mbeten në boshnjakisht, anglisht, turqisht, gjermanisht, arabisht... - të gjitha për t’i studiuar të rinjtë. Mëshirë pastë shpirti i tij i bukur”, ka shkruar akademik Enes Kariq, përkthyer nga Azmir A. Jusufi.

(16.03.2022)

PËRJETËSISHT, MADELEINE ALBRIGHT

Me dhembje e pikëllim dëgjuam se mikja e madhe e vendit dhe e popullit tonë, zonja Madeleine Albright, ish-Sekretare e Shtetit e SHBA-ve, paska ndërruar jetë, thuhet në letrën e Myftiut Naim ef. Tërnavë, Kryetar i Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës.

Në periudhën e okupimit, Sekretarja Albright (Ollbrajt) për ne ishte simbol i shpresës, i drejtësisë, i lirisë dhe i demokracisë.

Sekretarja Albright ka qenë ndër më të vendosurat për ta larguar pushtetin e Millosheviqit nga vendi ynë. Kjo, edhe për faktin se ajo kishte përjetuar që në fëmijëri persekutimin dhe përndjekjen dhe nuk bëri asnjë kompromis me zullumqarin e shekullit.

Për ne, Sekretarja Albright do të kujtohet përjetësisht si Zonja e Fortë e drejtësisë, e lirisë dhe e humanizmit.

U kujtoftë përjetë! – ka shkruar Naim ef. Tërnavë, Kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës. (23.03.2022)



LUAN STAROVA, NDER PËR KOMBIN DHE PËR VENDIN

Më 24 shkurt, 2022, në Shkup, ka ndërruar jetë Luan Starova. Luan Arif Starova ka qenë i lindur në Pogradec, më 14 gusht 1941. Ka qenë akademik, shkrimtar dhe diplomat shqiptar. Veprat e tij i shkroi në gjuhën maqedonase dhe shqipe, si dhe është përkthyer dhe botuar në gjuhën frënge, gjermane, italiane, turke, rumune, kroate, bulgare dhe greke.

Me këtë rast, me një mesazh ngushëllimi ka dalë Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kreu i saj, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Në mesazh thuhet:

“Largimi në amshim i akademikut Luan Starova u prit si lajm i hidhur e i pikëllueshëm për Bashkësinë Fetare Islame të RMV dhe për tërë shoqërinë në përgjithësi, së cilës i dhuroi një krijimtari mahnitëse si shkrimtar, si përkthyes dhe si shkencëtar.

I dekoruar me çmimet më të larta si në vend, ashtu dhe jashtë, z. Starova ishte nder për kombin dhe për vendin, të cilat ai i përfaqësoi

më së miri si anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të RMV, i Akademisë Mediterane të Napolit, i Akademisë Evropiane të Shkencave në Salzburg dhe i Shoqatës Shkencore Lajbnic në Berlin.

Veprat që la pas janë përkthyer në mbi 30 gjuhë të botës.

Bashkësia Fetare Islame e RMV dhe Kryetari i saj, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, u shprehin ngushëllime të sinqerta familjes dhe miqve të afërm të z. Luan Starova. Allahu Fuqplotë e shpërbleftë me Xhenet.”

Siç bëhet e ditur, Luan Starova ka botuar shtatë romane, dy vëllime me tregime, një me poezi, disa vëllime me ese dhe studime, ndërsa ka përkthyer dhe poetë të njohur francezë në shqip dhe maqedonisht. Ka shkruar paralelisht shqip dhe maqedonisht. Është autor i romaneve “Librat e babait”. “Koha e dhive”. “Muzeu i ateizmit”, “Bregu i ekzilit” etj.

Luan Starova renditet ndër shkrimtarët shqiptarë më të përkthyer në botë.



SIRI: ËSHTË NDARË NGA JETA ABDULATIF ARNAUTI

Përkthyesi më i mirë i letërsisë shqipe në gjuhën arabe, Abdulatif Arnauti, ndërroi jetë në mbrëmjen e ditës së enjte, më 3 mars 2022 dhe u varros në Dahdah të Damaskut më 4.03.2022, ka shkruar prof. ass. dr. Ramiz Zekaj, Drejtor i Institutit të Edukimit, Trashëgimisë dhe Turizmit (IETT Albania).

Abdulatif Husejin Arnauti ka lindur në Damask më 1931. Ai i kreu studimet e larta dhe pasuniversitare në Fakultetin e Gjuhës dhe të Letërsisë Arabe në Universitetin e Damaskut.

Jetën e tij letrare e ka filluar në fund të viteve dyzet. Ai nisi të shkruajë poezi qysh në moshën 16-vjeçare, ndërsa në moshën 18-vjeçare shkroi romanin e tij të parë me titull “Aroma e Hyrit”. Botimi i veprimtarisë së tij letrare – tregim dhe poezi – ka qenë në gazeta dhe revista të ndryshme në Damask. Abdulatifi është i njohur si shkrimtar, poet, studiues i gjuhës dhe i letërsisë arabe, publicist dhe mbi të gjitha ai mban meritat si përkthyesi i parë i letërsisë shqiptare në gjuhën arabe.

A. Arnauti e nisi përkthimin e veprave shqipe në gjuhën arabe rreth viteve '50. Ndër veprat kryesore të përkthyer vlen të përmenden “Përse mendohen këto male”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kështjella”, “Dasma”, “Dosja H” nga Ismail Kadare; “Njeriu me top”, “Burri dhe pushka” nga Dritëro Agolli; “Ato male” dhe “Dasma e Sakos” nga Vath Koreshi, “Toka jonë” nga Kolë Jakova, “Familja e peshkatarit” nga Sulejman Pitarka etj.

Gjithashtu, ai ka përkthyer një numër të madh të antologjisë arabe (pjesë të zgjedhura) në gjuhën shqipe. Ka kontribuar në botimin e letërsisë arabe në qarqet letrare shqiptare. Ai shkroi poezi, tregime, romane dhe hulumtime letrare në gjuhën shqipe. Ka kontribuar në redaktimin e revistës së trashëgimisë arabe të botuar nga Bashkimi i Shkrimtarëve Arabë në mes të vitit 1997. Ka qenë gjithashtu anëtar i Shoqërisë së Përkthimit. Firmën e tij të prurjeve artistike e studimore e mbajnë 61 vepra të llojeve të ndryshme të krijimtarisë.

Mirënjohje përjetë ndaj veprës së vyer dhe kontributit shkencor e intelektual të të ndjerit Abdulatif, për gjithçka

që ka bërë me dashuri dhe pasion për promovimin e kombit tonë, të vlerave tona më të mira kulturore, historike, për zhvillimin e letërsisë, të trashëgimisë shqiptare në botë! Allahu e pastë marrë atë nën kujdesin, bujarinë dhe mëshirën e Vet! – ka shkruar prof. ass. dr. Ramiz Zekaj.

Lamtumirë, Abdulatif Arnauti (1931 - 2022), ka shkruar dr. Ardian Muhaj, Drejtor i Institutit Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam, Tiranë (AIITC).

Mësuesi, shkrimtari dhe përkthyesi finisnik shqiptar Abdulatif Arnauti ishte ndër bashkëpunëtorët e vyer të AIITC, si dhe anëtar i bordit këshillimor të revistës shkencore-kulturore “Univers”, ku dha kontributin e tij me idetë dhe eksperiencën profesionale për vite me radhë.

AIITC u shpreh ngushëllimet e sinqerta familjes dhe të gjithë shqiptarëve për këtë humbje, duke vlerësuar figurën e profesor Abdulatif Arnautit si një personalitet i shquar, njeri i dashur dhe bashkëpunëtor shembullor.

Zoti e pastë marrë nën kujdesin dhe Mëshirën e Tij që nuk mbaron asnjëherë! – ka shkruar dr. Ardian Muhaj.

Damasku, Siria dhe të gjithë shqiptarët humbën një nga personalitetet më të duhura nga diaspora arnaut-shqiptare. Lum si ai që la vepra dhe sjellje të mira te njerëzit në këtë botë.

Allahu e mëshiroftë dhe veprat e tij jetofshin gjatë, ka shkruar Ermal Bega, drejtor ekzekutiv i Qendrës Shqiptare për Studime Orientale (Acfos Albania).

Qeveritë shqiptare do të ishte mirë të organizonin ndonjë aktivitet për nder të veprave të tij në dobi të kauzës shqiptare, ka thënë Ermal Bega. Shënimin ai e ka shoqëruar edhe me disa fotografi, ku spikatin Bendis Hoxha, dr. Abdulatif Arnauti, Ermal Bega dhe Mahir Arnauti - djali i të ndjerit (Damask, 2004).

U shua edhe një zë shqiptar në botën arabe, ka shkruar poeti dhe publicisti Faruk Tasholli nga Prishtina (aktualisht me qëndrim në Gjermani).

Me Abdulatitin u njoha në Seminarin për Gjuhë, Letërsi dhe Kulturë Shqiptare në Prishtinë në vitin 1982. Që nga ajo kohë e më vonë komunikuam me letra, ndërsa pas vitit 1983 nuk u takuam më kurrë. Arsyeja ishte se ai ndërkohë shkoi



në Tiranë, ku vizita e tij bëri bujë në qarqet kulturore shqiptare dhe autoritetet shtetërore jugosllave nuk e lejuan më të vinte në Kosovë.

Vdekja e tij, kur viteve të fundit kishim humbur kontaktet, më pikëlloi shumë. Në vend nderimi po e sjell një fragment të një interviste të gjatë që bëra me të, të botuar më 15 shtator 1982 në gazetën „Bota e Re“ të Prishtinës, ka thënë Faruk Tasholli: “Po, unë jam i lindur në Damask, në një familje shqiptare e cila nga Kosova është shpërngulur rreth vitit 1913. Fëmijërinë e kam kaluar me familjen time, e cila nuk e dinte gjuhën arabe. Gjyshi i babait tim ishte prej Dobërlukës së Vushtrrisë, ndërsa gjyshja e sime ëmë prej Ferizajit, nga familja e Shlishaneve, e cila edhe sot ekziston në atë qytet. Ky stërgjyshi im i dytë, që emrin e kishte Sabit, ka qenë njeri i arsimuar. Me profesion ishte hoxhë. Prej tij, të tërë pasurinë kulturore e ka trashëguar edhe nëna ime, e cila më vonë mua m'i hapi shtigjet e dritës dhe të dijes. Nana ime, Halimja, më 1938 hapi një shkollë vullnetare dhe aty mësonin fëmijët shqiptarë shqip. Ajo na mësoi edhe ta lexonim Kurandin arabisht.”



Agjencia për Hallall Standard
Агенција за Халал Стандард
Helal Standard Ajansı
Agency for Halal Standard
مكتب شهادة للمنتجات الحلال



Bashkësia Fetare Islame e R.M.V.

Add: Cairska 52.1000 Skopje, North Macedonia.
Tel: + +389(0)2 3117410; 3117 412.
Fax: + +389 (0)23117 883

websait: www.bfi.mk
email: halal.bfi@gmail.com